



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:049797

Datë: 06.04.2023

Numri i dokumentit: 04168745

PS.nr.36/2020

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prishtinë- Departamenti Special - trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: Lutfi Shala kryetar, Suzana Çerkini dhe Kujtim Krasniqi anëtarë, me pjesëmarrjen bashkëpunëtores profesionale Luljeta Gashi Metaj, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit H.P i akuzuar për shkak të veprave penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, Mashtrimit në vazhdimësi nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK- së, dhe veprën penale Shpëlarja e parave nga neni 308 të KPRK-së, lidhur me nenin 56 par.1 pika 1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.59/2019 të datës 12.09.2020, të precizuar në fjalën përfundimtare nga PSRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të datës .., ku prezentë ishin, nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës prokurorja Merita Bina Rugova, i akuzuari H.P dhe mbrojtësit e tij, av.F. A. dhe av D.O.gjykata me datë 10.01.2023, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarin:

H.P me nofkën "B." nga i ati B.dhe nënës M. e vajzërisë H., i lindur me ... në fshatin D. e V. Komuna e L. me vendbanim në P. rruga "J. e R." pa nr. , me numër personal .., i martuar, i ati i 6 fëmijëve, ka te kryer shkollën e lartë të komunikacionit R.shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

I.Nga data 15 qershor 2005 ka regjistruar biznesin e tij privat O "B", me aktivitet primar "aktivitetet tjera të shëndetit të njeriut" me seli në rrugën "J.e R", në P., dhe deri më datën 26 korrik 2019, me qëllim dhe me dashje, pa kualifikime profesionale dhe pa licencë përkatëse me pretendim se shëron sëmundje të rënda fizike dhe psikike si: *paraliza, distrofinia, epilepsia, gratë sterile etj dhe ndihmon në zgjidhjen e problemeve të ndryshme familjare*, në vazhdimësi ka kryer trajtime mjekësore, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Shëndetësi Ligji nr. 04/L-125 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin për shëndetësi nr. 08/L-043, në atë mënyrë që i njëjti ka reklamuar veprimtarin e tije përmes shtypit ka shtypur vizitë- karta me adresë dhe telefonin e vet, në derën e hyrjes në zyrën e tij mban mbishkrimin "M." me pretendim se shëron të sëmurit me barna popullore, dhe udhëzon personat të ndryshëm, shtyp hajmali, ndez qirinjtë, merr qime të flokëve, lëngë të ngjashëm me ujin, dhe te varrezave, dhe letra me vizatime të pakuptueshme, edhe pse me vendimin e inspektoratit shëndetësor me nr.. i është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë për shkak të mos posedimit të licencës, duke i nxitur dhe duke kërkuar nga personat e

ndryshëm të paguajnë shuma të ndryshme të parave dhe me këtë ka arritur që përmes këtij aktiviteti të kundërligjshëm të krijoj të hyra të jashtë ligjshme.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

II. Në kohë dhe vendin e cekur si në dispozitivin **I** të këtij aktgjykimi me qëllim të përfitimit të pasurisë në mënyrë të kundërligjshme dhe më qëllim të përfitimit të dobis pasurore me anë të paraqitjes së rreme të fakteve se kinse posedon aftësi të jashtëzakonshme ashtu që shëron edhe sëmundjet më të rënda fizike dhe psikike, në vazhdimësi ka vënë në lajthim të dëmtuarit të cilët kanë kërkuar ndihmë prej tij mes tyre edhe Z.M, H.Sh,F.S, B.K, B,M.B,B.K,dhe R.L duke i nxitur dhe kërkuar që për shërbimet e tij ti paguajnë shumat të ndryshme të parave nga 20 euro e deri në shumën prej 3000 euro duke përfituar shumën e parave në vlerë të përgjithshme prej mbi 10.000 euro.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale të Mashtrimit në vazhdimësi nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

III. Në shtëpinë e tije e cila gjendet në rrugën “J. e R” në P. pa autorizim përkatës ka mbajtur në pronësi dhe posedim armët dhe atë një pistolet të tipit “G.” të kalibrit 9mm me numër serik, me dy karikator si dhe 166 fishek të të njëjtit kalibër, si dhe një pushkë gjuetie të tipit “S.C.” me numër serik . dhe 55 fishek në kundërshtim me ligjin për armët nr. 03/L-143 të cilat armë janë konfiskuar me rastin e kontrollit nga ana e policisë së Kosovës me dt;.....

-Me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK- së.

IV. Duke e ditur se pasuria e fituar me anë të veprës penale e përshkruar si në dispozitivin **I** të këtij aktgjykimi, me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, U, nga data ..., në vazhdimësi deri më datën ..., parat e fituara nga ky aktivitet kriminal i ka futur në sistemin bankar përmes deponimit të të hollave të gatshme kryesisht me arsyetimin se ashtu i paguan këstet e kredis, e më pastaj e kryen shtresimin-fshehjen e origjinës së tyre përmes transfereve bankare, si dhe përmes pagesave në kesh për asetet e blera, duke i konvertuar në asete të luajtshme dhe të paluajtshme mjetet financiare të fituara përmes aktivitetit kriminal si në pikën **I** të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë:

Vetura e tipit “M.”, ngjyrë hiri me targa ..., me numër të shasisë ...,viti i prodhimit 2019, i regjistruar në emër të Auto S. P..

Vetura e tipit “S”, me ngjyrë të zezë me tarme numër të shasisiti i prodhimit 2014, e regjistruara në emër të U.P.

Vetura e tipit “V., ngjyrë e zezë me targa ..., me numër të shasisë ..., viti i prodhimit 2015 e regjistruar në emër të M. M.

Vetura e tipit “A., ngjyrë e bardhë me targa ..., me numër të shasisë ... viti i prodhimit 2018, në pronësi të H.P.

Vetura e tipit “L.R. ”, me targa ... ngjyrë të kaltër, me numër të shasisë, .. viti i prodhimit 2018 e regjistruar në emër të F. P..

Vetura e tipit “R. M.”, ngjyrë të bardhë me targa ... me numër të shasisë ..., viti i prodhimit 2018 e regjistruar në emër të U. P.

Vetura e tipit "V. T.", ngjyrë e kaltër me targa....me numër të shasisë .., viti i prodhimit 2016 e regjistruar në emër të H.P.

Vetura e tipit "V., ngjyrë e zezë metalike me targa ... me numër shasisë ..viti i prodhimit 2009, i regjistruar në emër të H.P.

Ngastra kadastrale me numër ... me sipërfaqe të përgjithshme prej 530 m², në zonën kadastrale L.Komuna P., në të cilën janë ndërtuar objekte afariste me sipërfaqe prej 1072 m², të regjistruara në emër të H.P.

Ngastra Kadastrale e evidentuar me numër të njësisë kadastrale .. në sipërfaqe prej 263 m² ZK P. përkatësisht 153 m² oborr dhe 104 m² shtëpi.

Ngastrën kadastrale me nr... me sipërfaqe të përgjithshme prej 95 m², në zonën kadastrale P. e regjistruar në emër të H.P.

Ngastrën kadastrale me nr... me sipërfaqe të përgjithshme prej 3256 m², e cila gjendet në zonën kadastrale P e regjistruar në emër të A. (B.) Sh..

Dy lokale në ngastrën kadastrale .. në sipërfaqe prej 174 m², dhe 92 m², zona kadastrale në P. në lagjen A.rruga T. tek "L. -BP" të regjistruar në emër të H.P,

-Me këtë ka kryer veprën penale shpëlarja e parave nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 pika 1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 17, 41,42, 43, 45,46, 73,74,81,83, të KPRK-së, (Kodi Nr.04/L-082) si dhe neni 360, 361 dhe neni 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të akuzuarit H.P për veprën penale si në dispozitivin të këtij aktgjykimi i :

Përcakton

Të akuzuarin **H.P** për veprën penale si në pikën **I** të dispozitivit të këtij aktgjykimi e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej **10,000 (dhjetëmijë) euro**.

Për veprën penale në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej **5,000 (pesëmijë) euro si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve**.

Për veprën penale në pikën **III** të dispozitivit të këtij aktgjykimi e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej **2,000 (dymijë) euro**.

Për veprën penale në pikën **IV** të dispozitivit të këtij aktgjykimi e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej **25,000 (njëzetepesë mijë) euro si dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite**.

Konform dispozitës së nenit 80 par.1 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit **H.P** i shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje **prej 4 viteve e 6 gjashtë muajsh** si dhe dënimin unik me gjobë në lartësi prej **42.000 (katër dhjet e dy mijë) euro** të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform neni 43 par.3 të KPRK-së, të njëjtin gjykata do ta zëvendësoj me dënim me burgim, **duke llogaritur për çdo 20 (njëzet) euro, me 1 (një) ditë burgim**.

Koha e kaluar nën masën e paraburgimit dhe atë nga dt:... e deri më dt:..., si dhe nga dt:26.07.2019 e deri më dt:..., i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së, amët dhe atë një pistolet të tipit "G." të kalibrit 9mm me numër serik ..., me dy karikator si dhe 166 fishek të të njëjtit kalibër, si dhe një pushkë gjuetie të tipit "S.C." me numër serik ... dhe 55 fishek, **konfiskohen**.

Në bazë të nenit 62 par. 1 dhe 2 nënpar 2,6 të KPRK-së, krahas dënimit kryesor gjykata të njëjtit i shqipton:

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskimin e pasuris së fituar me vepër penale dhe atë:

Pasuria e luajtshme:

Vetura e tipit "M.", ngjyrë hiri me targa ..., me numër të shasisë ...,viti i prodhimit 2019, i regjistruar në emër të Auto S. P.. Vetura e tipit "S", me ngjyrë të zezë me targa ..., me numër të shasisë .., viti i prodhimit 2014, e regjistruara në emër të U. P.. Vetura e tipit "V.", ngjyrë e zezë me targa ..., me numër të shasisë .., viti i prodhimit 2015 e regjistruar në emër të M.M.. Vetura e tipit "A., ngjyrë e bardhë me targa ..., me numër të shasisë ..., viti i prodhimit 2018, në pronësi të H.P. Vetura e tipit "L.R. ", me targa ... ngjyrë të kaltër, me numër të shasisë, .., viti i prodhimit 2018 e regjistruar në emër të F.P.. Vetura e tipit "R.M.", ngjyrë të bardhë me targa . me numër të shasisë .., viti i prodhimit 2018 e regjistruar në emër të U. P.. Vetura e tipit "V. T.", ngjyrë e kaltër me targa ..., me numër të shasisë .., viti i prodhimit 2016 e regjistruar në emër të H.P.Vetura e tipit "V G.", ngjyrë e zezë metalike me targa .. me numër shasisë ..viti i prodhimit 2009, i regjistruar në emër të H.P, **konfiskohen**

Pasuria e paluajtshme:

-Ngastra kadastrale me numër .. me sipërfaqe të përgjithshme prej 530 m², në zonën kadastrale L.Komuna P., në të cilën janë ndërtuar objekte afariste me sipërfaqe prej 1072 m², të regjistruara në emër të H.P. Ngastra Kadastrale e evidentuar me numër të njësisë kadastrale ... në sipërfaqe prej 263 m² ZK P. përkatësisht 153 m² oborr dhe 104 m² shtëpi. Ngastrën kadastrale me nr... me sipërfaqe të përgjithshme prej 95 m², në zonën kadastrale Pejë e regjistruar në emër të H.P. Ngastrën kadastrale me nr.... me sipërfaqe të përgjithshme prej 3256 m², e cila gjendet në zonën kadastrale P.. e regjistruar në emër të A. (B.) Sh.. Dy lokale në ngastrën kadastrale .. në sipërfaqe prej 174 m², dhe 92 m², zona kadastrale në P. në lagjen A. rruga T.tek "L. -BP" të regjistruar në emër të H.P, **konfiskohen**.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi Agjencia për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë, obligohet që t'i marr nën administrim dhe menaxhim pasurit e paluajtshme dhe të luajtshme që ti administroi në përputhje me ligjin mbi Agjencinë.

Në kuptim të nenin 116 të KPRK-së, sendet e sekuestruara përkohësisht dhe atë Ngastra kadastrale me nr..., me sipërfaqe të përgjithshme prej 3256 m² në vendin e quajtur A.ZK P. e regjistruar në emër të tij me pronësi prej 5/8, ndërsa në emër të B. (B.) Sh. me pjesë të pronësisë prej 3/8, **lirohet**.

Palët e dëmtuara B.K, B.K,F.S,M.B,H.Sh,B,Z.M, R.L lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

OBLIGOHET i akuzuari, që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës të ia kompensoi shumën prej **500 euro**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **100 euro**, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave shumën prej **100 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka parashtruar Aktakuzën PPS.nr. 59/2019 të datës 15.09.2020, të precizuar në fjalën përfundimtare, kundër të akuzuarit H.për shkak të veprave penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, Mashtrimi në vazhdimësi nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK- së, Shpëlarja e parave nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 pika 1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Specila ka caktuar dhe vazhduar shqyrtimin gjyqësor ndaj të akuzuarit H.P, gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari në bazë të nenit 323 të KPPK-së, është udhëzuar me të drejtat e tij ligjore dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, i njëjti është udhëzuar në bazë të nenit 326 par.1 të KPPK-së, mbi të drejtat për deklarimin e pranimit apo mos pranimit të fajësisë, në këtë drejtim i akuzuari është njoftuar nga gjykata për pasojat që rezultojnë nga pranimi i fajësisë dhe kushtet e përcaktuara me nenin 248 par.1 pika 1.1 deri 1.3 të KPPK-së, që pranimi nga ana e tij të konsiderohet i vlefshëm.

I akuzuari H.P në shqyrtimin gjyqësor të dt...., ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor për veprat penale për të cilat akuzohet.

Prokurori i Prokurorisë Speciale gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës ..., si dhe në fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se, fillimisht ka bërë precizimin e dispozitivit të parë të aktakuzës, të cilin e ndanë në dy dispozitiva pasi që dispozitivi i parë ka qenë i bashkuar me dy veprat penale dhe veprimet kanë qenë të përshkruara në një dispozitiv. Ndërsa e ka bërë vetëm ndarjen e veprimeve pa e prekur substancën e aktakuzës. Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka theksuar se gjatë shqyrtimit kryesor janë administruar prova me të cilat pa asnjë dyshim është vërtetuar se i akuzuari H.P i ka kryer të gjitha veprat penale për të cilat akuzohet. Në fakt, është dëshmuar se i njëjti të paktën që nga viti 2005, (e me shumë mundësi tërë jetën e tij) me të gjitha veprimet totalisht e ka injoruar ligjin. Kjo vërtetohet me shkallën e vetëbesimit dhe lehtësisë me të cilën ka vazhduar të punoj pasi i është ndaluar veprimtaria në vitin 2007, madje edhe pas daljes nga paraburgimi. I njëjti ka vazhduar edhe të reklamohet si i suksesshëm në trajtimin edhe të sëmundjeve më të rënda që janë problem edhe për mjekësinë - “SHËROJMË paralizën, distrofinë, epilepsinë, gratë sterile... Me tutje PPSR ka shtuar se mbrojtja pretendon se i akuzuari është marrë me aktivitetet spirituale, e jo mjekësore! Kjo nuk është e vërtetë! Lokali i quajtur “O“, pretendimi se shëron edhe **sëmundjet më të rënda**, dhënia e lëngjeve të dyshimta të sëmurëve... definitivisht nuk mund të konsiderohet **veprimtari spiritual**, e aq më pak të lejueshme. Vetëm një person plotësisht pa ndërgjegje është në gjendje të marrë para dhe të lënë në borxh njerëz të dëshpëruar, të cilët në të e shohin shpresën e fundit për shërim. Po ashtu nga transkriptat e bisedave telefonike është vërtetuar se plotësisht ka injoruar ankesat se trajtimi i tij nuk ka qenë i suksesshëm, madje ka kërkuar më shumë para. Natyrisht se personi i tillë ka pas edhe kërcënime dhe kjo vërtetohet me provat e mbrojtjes. Me paratë e njerëzve fatkeq, të cilët me mija euro kanë paguar paraqitjen e rrejshme të të akuzuarit, i njëjti e ka fituar pasurinë milionëshe nga e cila vetëm 8.84 % është fituar në mënyrë legale. Kjo është konstatimi i ekspertit financiar të angazhuar nga ana e trupit gjykues. Tutje ka theksuar se i vetëdijshëm që pasuria e tillë është në disproporcion me aktivitetet e tij të ligjshme, i akuzuari e ka kryer një shembull shkollor të veprës penale të pastrimit të parave. I njëjti rregullisht, me vite, përmes personave të ndryshme ka bërë deponimin e parave të gatshme, të fituara me veprën penale të mashtrimit dhe Ushtrimit të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore. Këtë e ka bërë kinse për pagimin e kësteve të kredive, të cilat i ka marrë nga bankat e ndryshme edhe pse nuk ka pas kurrfarë nevojë për të. Prandaj në atë mënyrë e ka kryer fazën e shpërlarjes së parave të quajtur “shtresimi”

- krijimi i depozitave të shumta dhe transaksione financiare të shumta si ndarje e fitimit nga bU, i tij. Në fund, pasurinë e ka integruar duke e konvertuar në asete të luajtshme dhe të paluajtshme. I akuzuari, në fakt, kurrë nuk ka pas as një aktivitet të ligjshëm, dhe e gjithë pasuria e tij buron nga veprat e lartpërmendura penale! Bizneset, në shiqim të parë të ligjshme si qebaptorja “U”, lokale të cilat i ka lëshuar me qira, parat nga shitja e veturave të shtrenjtanë të vërtetë janë produkte të fazës së fundit të Shpëlarjes së parave, ku pas shumë transfereve bankare, në tregun financiar pasuria shfaqet si mjet legjitim. Kjo është edhe i tërë qëllimi i shpërlarjes parave! E njëjta ka shtuar se për ilustrim, do t’i përmendim vetëm disa aktivitete financiare: me dt. ..., katër persona të ndryshme në B. K.T.kanë bërë deponime për të akuzuarin, në vlerë të përgjithshme prej 42.500 € - vetëm për një ditë, ndërsa me dt.... R. E. ka bërë 2 deponime prej gati 6 mijë euro (5835 €), meM.Q. ka bërë 4 deponime, në vlerë prej gati 9 mijë euro (8974 €)....e shumë tjera Po ashtu gjatë këtij gjykimit janë administruar edhe shumë prova me të cilat në detaje është sqaruar mënyra e blerjes për secilin aset të konfiskuar. Pra është dëshmuar se i akuzuari ka mbajtur mjetet në lëvizje të vazhdueshme, nëpërmjet shitblerjes së palujtshmërive dhe veturave të shtrenjta, ka bërë nga disa kontrata me përmbajtje të ndryshme për të njëjtin aset, ka marrë kredi për prona të cilat kanë qenë të paguara me kesh....Të gjitha këto veprime kanë pas vetëm një qëllim – që të **fshehet origjina e kundërligjshme e parave**. Tutje e njëjta ka theksuar se pas lirimit nga paraburgimi, i akuzuari nuk ka vazhduar vetëm me kryerjen e veprave bazë - ka vazhduar edhe me Shpërlarjen e parave ! I ka blerë 2 vetura - Mercedes, nga Autosalloni Prishtina dhe “ V. G. ”, të cilët i ka lënë në emra të pronarëve të mëhershëm, i mësuar nga përvoja e konfiskimeve të kryera disa muaj më parë. Të gjitha provat e siguruara dëshmojnë se këto dy vetura i akuzuari i ka blerë, edhe pse ka tentuar që t’i paraqes si të huazuara. E si përfundim ka theksuar se në tërësi mbetem pranë aktakuzës, i ka kërkuar gjykatës që i akuzuari të shpallët fajtor për të gjitha veprat penale për të cilat akuzohet, gjithashtu ka kërkuar që të bëhet konfiskimi i përhershëm i të gjitha aseteve të konfiskuara përkohësisht. Po ashtu borxhet eventuale të të akuzuarit, për blerjen e automjeteve, të cilat janë përmendur gjatë procedurës, nuk guxojnë të jenë pengesë për konfiskim. Pagimin e këtyre borxheve, nëse ekzistojnë, kreditorët duhet të kërkojnë në një procedurë tjetër, me padi civile.

Mbrojtësit e të akuzuarit H.P, Av.D.O. dhe av. F. A. gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës ..., si dhe në fjalën përfundimtare të parashtuar me shkrim e të elaboruar edhe në shqyrtimin gjyqësor kanë deklaruar se, Prokuroria pretendon që të vërtetojë një gjendje të kundërligjshme se paku 15 vite nga veprimet e të mbrojturit të tij, madje gjithë jetën H.P ka mashtruar një numër të pacaktuar të njerëzve, pra akuzë jo vetëm që është e padrejtë dhe e pa vërtetë por e njëjta edhe po të ishte e vërtetë është e pamundur të vërtetohet, është e pamundur të gjykohet e gjithë jeta e njeriut. Po ashtu pikëpamja e mbrojtjes për rrethana ligjore dhe faktike për të gjitha pikat e aktakuzës për secilën veç e veç si dhe ka arsyetuar kërkesën për lirimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme për mos sekuestrimin e përhershëm të tyre nga ana e gjykatës. Me tej të njëjtin kanë theksuar se lidhur për veprën penale Ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike sipas nenit 262 par.1 të KPRK, pra ga kjo rezulton se vetem regjistrimi i aktivitetit mjekësor në aktivitetin biznesor nuk inkriminohet por **inkriminohet kryerja e aktiviteteve të trajnimeve mjekësore**. Në rastin konkret është vetëtuar se H.P në certifikatën e biznesit O.B nr... ka pasur të regjistruar aktivitetin biznesor në lëmin e shëndetit. Mirëpo qëllimi i këtij regjistrimi të këtij aktiviteti siç vërtetohet në bazë të provave nuk ka qenë venja në lajthim të personave dhe as qëllimi për ushtrimin e aktivitetit mjekësor. Pra nga rastet e dyshuara penale, dëshmitaret dhe të dëmtuarit nuk kanë dëshmuar se H.P ka kryer në të vërtetë aktivitetet mjekësore ashtu siç përcaktohet sipas ligjeve të veçanta. Tutje të njëjtit kanë shtuar se sipas nenit 262 par.1 të KPRK, është definuar vepra penale Ushtrimi i kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore përcakton sanksionin penal elementet subjektive dhe objektive të kësaj vepre penale por nuk përcakton se çka paraqet “V. M.”. Veprimtari mjekësor definohet sipas nenit 12 të Ligjit për Shëndetësi, dhe kanë për qëllim marrjen ndërmarrjen e masave dhe veprimeve që ndërmerren nga organizatat institucionet dhe profesionistët shëndetësor që për qëllim kanë përmirësimin e shëndetit të qytetarëve. Andaj në rastin konkret nuk është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarëve se H.P ka kryer veprimtari mjekësore ashtu siç definohet në ligj dhe akte nënligjore. Prandaj nga dëgjimi i dëshmitares H.Sh në shqyrtimin gjyqësor të datës ka deklaruar në pyetjen H.P, ju ka

dhënë ndonjë intervenim mjekësor? E njëjta është përgjigjur “jo”, ndërsa në pyetjen, Se a ju ka dhënë ndonjë syqyerim për ndonjë dietë? E njëjta është përgjigjur “jo”. Ndërsa nga deklarata e dëshmitarit M. B. të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë ... i njëjti ka deklaruar “me ka stërpik me do ujna...”, po ashtu e njëjta gjendje faktike vërtetohet edhe në bazë të dëgjimit të dëshmitarit F. S. në shqyrtim gjyqësor të datës ... i cili ka deklaruar “mas një jave kam shkaur e kam marrë një hajmali..”, “prap me jepke ujë me u pastru me to”, nga dëgjimi i dëshmitarit R.L në shqyrtimin gjyqësor të datës ... i njëjti ka deklaruar “jo s’me ka dhënë barna” si dhe nga pyetja e parashtruar, A mund ta konfirmoni se nuk keni marrë këshilla dietikë apo këshilla mjekësore? I njëjti ka deklaruar “... jo skam marrë asnjë këshillë tjetër”, po ashtu e njëjta gjendje faktike vërtetohet edhe në bazë të dëgjimit të dëshmitares Z.M e cila në seancën e shqyrtimi gjyqësor të datës ..ka deklaruar se gjatë vizitës të B a ke bo ndonjë analizë e njëjta është përgjigjur “jo”, ne dëshminë e dëshmitarit D.Z vërtetohet te njëjtat fakte, pasi qe njëjti ka deklaruar se “me veprimtari kuptojmë faktin se i njëjtit lutet, jep hajmali dhe procedurat qe nuk i di...”. Tuje kanë theksuar se të gjithë dëshmitarit e lartcekur një nder arsytet e shkuarjes tek H.P i kanë pasur problemet e ndryshme mjekësore apo sociale si dhe mungese se fatit ne jete dhe te gjithë pa dallim kane deklaruar se H.P nuk ju ka dhëne barna, këshilla mjekësore dhe dietike, trajtime kirurgjike apo trajtime te cilat konsiderohen si veprimtari mjekësore sipas ligjit, palët e dëmtuara dhe dëshmitaret qe kane dëshmuar për problemet familjare, sociale apo te fatit te keq te gjithë po ashtu pa dallim nuk ka vërtetuar faktin se H.P ju ka bere trajtime mjekësore. Andaj ne përshkrim te diapoziivit te par te aktakuzës rezulton nuk janë të përshkruara as për së afërmi veprimet të te dyshuarit sa i përket “veprimtarisë mjekësore pa licencë”. Shënimi i hajmalive, lutjet (dovtë) nuk paraqesin veprimtari mjekësore, nëse analizohen provat materiale, nuk rezulton se është vërtetuar përgjegjësia penale se H.P ka kryer veprën penale sipas nenit 262 të KPK – së. Po ashtu pretendimi i Prokurorisë se në bazë të Raport inspektionit specialistik me njësinë për krime ekonomike dhe korrupsion, nr SPSH B P., te datës ..., nr. ..., procesverbali i datës ... si dhe vendimit te Ministrise se Shendetesise te datës, nr., vërtetohet përgjegjësia penale apo ndonjë fakte ne lidhje me përgjegjësinë penale për veprën penale nga neni 262 te KPK -së, nuk vërtetojnë faktin se H.P ka kryer veprën penale ushtrim i veprimtarisë mjekësore sipas nenit 262 te KPK -së, ngase, këto dokumente vërtetojnë faktin se H.P ka përdore ne certifikatën e biznesit fjalën “O”, përdorimi i këtij termi dhe shkelje te tjera paraqesin vepra kundërvajtjes dhe shkelje administrative qe gjobiten ne kuptim te nenin 89 te Ligjit për Shëndetësi dhe akteve te tjera ligjore, ne anën tjetër vepra penale nga neni 262 te KPK – së kërkon qe te kryhet veprimtaria mjekësore nga i dyshuari, është e kjart se ne rastin konkret H.Pnuk ka kryer veprimtari mjekësore. Ndërsa në bazë të raportit inspektionit specifik me njësinë per krime ekonomike dhe korrupsion, nr SPSH B P., te datës ..., nr...., procesverbali i datës ..., ne faqen 3 konstatohet se “gjetëm dy kutia te tab lexilium 1.5ml, omaproazol, solidamon 100 mg, aspirin 100 mg dhe daleron 500 mg. Këto barna jane barna per përdorim personal të H.P e qe vërtetohet ne baze te Raporti Specialistik per pacientin H.P, i datës ..., dr. A. S. dhe Raporti specialistik “M. S.”, dr. I.A., i datës ..., te cilat vërtetojnë se i se këto barana i ka përdor per shkak te problemeve personale shëndetësore. Tutje kanë shtuar se arsyeja e regjistrimit te biznesit “**B**” me fjalën **O** nuk ka qen me qellim te ushtrimit te veprimtarise mjekesore, ashtu sic definohet sipas ligjit per shendetesi, por, **qe besimi fetar i H.P qe perfshine dhe sherimin shpirtëror alternativ** dhe qe e njej Ligji i Shndetesise sipas nenit 3.1.41, sipas nenit 3 paragrafi 1 nenparagrafi 1.41 te L SH eshte percaktuar se Trajtimi para-mjekësor dhe alternativ - metodat e trajtimit që janë të regjistruara nga shoqatat profesionale; dhe që duke qenë se nuk janë në pajtim me doktrinën aktuale mjekësore nuk përfshihen në shërbimet zyrtare shëndetësore, ne kete drejtim H.P ne vitin..., i eshte drejtuar Ministrise se Shendetesise perms kerkese nr., te zgjerimit te numeklatures se veprimtarise se mjekesise popullore alternative me qellim qe te ushtrroj veprimtarin time, i njejti ne kete shkres te vjeter me shume se 12 vite me tej ka shrkuar, citoj “..... veprimtarine tani e kame te regjistruar nen shifren ... si veprimtari te tjera te mjekesise sociale si dhe shifren ..te veprimtarise time se sherbimeve sociale te organizmave drejtues qe merren me shendetin, arsimin, kulturen etj... mirepo, edhe pse e kam te regjistruar biznesin tim ne shifrat e permendura te veprimtarise theksoj se shifrat e lartshenuara nuk I pergjigjen veprimtarise time te cilen e ushtrroj, perkatesisht, nuk i pergjigjen mjekesise popullore alternative..”, me tej i njejti ne kete shkres ka theksuar,citoj ”..... kerkea e parashtroj me qellim qe veprimtaria mjekesise popullore alternative te kete kodin e vecante te veprimtarise per licencimn e saj ne menyre qe veprimtaria ime te mos perzihet me ate te mjekesise se rregullte shendetesore, por, vetem mjekesise popullore alternative shpireterre....”, me tej i njejti ka shkruar, citoj”.... Njerezit shpirtërisht I kame sheruar”. Pra ne baze te provave te lartcekura pa dyshim vërtetohet fakti se H.P nuk ka ushtruar veprimtari mjekesore, ne menyre te vecante ne drejtim te palëve deshmitare dhe te dëmtuara, regjistrimin

e biznesit O B. nuk e ka bere me qellim te ushtrimit te veprimtaris mjekesore apo per te i ngatruar personat e trete per veprimtarinë e tij, ka kërkuar qe veprimtaria e tij e lejuar sipas ligjit te rregullohet ne menyre me specifike qe te regjistroj veprimtarinë ekonomike qe i pergjigjet aktivitetit te tij, mirëpo, ne baze te fakteve te lartcekura ne asnjë forme nuk vërtetohet se i mbrojturi im ka kryer ndonjë element te figurës se veprës penale Ushtrim i Kunderligjshem i Veprimtarise Mjekesore sipas nenit 262 par 1 te KPK -së. Tuje kanë theksuar se ne rastin konkret nuk kemi te bëjmë me vepra penale qe janë kryer ne vazhdimësi, ne kuptim te nenit 81 , ngase, vepra penale ushtrimit te kundërligjshëm te veprimtarisë mjekësore nuk supozohet se është kryer ndaj personi te njejte, por personave te ndryshëm siç janë : B.Z.M H.Sh,F.S,R.L,B.K,B.K,I.N,M.B,ne ate forme qe kushtet procedurale per te u konsideruar kjo vepër penale se eshte kryer ne vazhdimësi nuk jane plotësuar, gjegjesisht, nuk eshte plotësuar paragrafi 2 i nenit 81 te Kodit te Procedures Penale te Kosoves, i cili përcakton, citoj “ Veprat penale të kryera kundër personit mund të konsiderohen si vepër penale në vazhdim vetëm nëse janë kryer kundër të njëjtit person..... “. Per me teper bashkimi i veprave penale ne nje veper penale ne “vazhdimesi”, behet per ato vepra penale per te cilat ka kushte te ndjekjes penale, gjegjesisht, nuk eshte arritur afati i parashkrimit, ngase, parashrkimi rrjedhe per te gjitha veprat penale vec e vec, pervec, veprave penale “Permanente”, respektivisht, deri sa gjendja e kunderligjshmerise te perfundoj, ne anen tjeter, vepra penale e ushtirmit te kunderligjshem e veprimtarise mjekesore nuk eshte veper penale permanente, respektivisht, pasoja e veprës penale nuk eshte pjese e kunderligjshmerise dhe figures se veprës penale, po ashtu, vepra penale ne vazhdimesi eshte nje mekanizem procedural i cili ka per qellim zevendseimin e procedures apo shqiptimit te denimit unik per personat qe jane denuar per shume vepra penale dhe jo me qellim te veshtiresimit te pozites procedural te te pandehurit ne procedure, ne ate forme qe te mos kete rrjedhje te parashkrimit vec e vec, prandaj gjykatës i rikutojtoj me respekt, se ne rastin konkret sa i perket veprës penale te ushtirmit te kunderligjshem te veprimtarise mjekesore ka arritur afati relative dhe absolut i parashkrimit, per me teper vepra penale ne vazhdimesi nuk e ndrron cilesine dhe natyren e veprës penale dhe rrjedhimisht te kohes se rrjedhejes se afatit te parashkrimit, por, ndryshon aspektet procedural penale te shqiptimi te denimit ne nje procedure penale te vetme. Sipas aktakuzes H.P sa I perket veprës penale ushtrim I kunderligjshem i veprimtarise mjekesore dyshohet se nga data e lirit nga paraburgimit, deri me date ... ka kryer veprën penale ushtrim i kunderligjshem i veprimtarise mjekesore, mirëpo, nese analizohet arsyetimi i akuzes sa i perket pjese te dispozitivit (shih faqen 11 te arsyetimit te akuzes) ne komunikimet me telefon permes mesazhave ne mes te mbrojturim P dhe personave N.N nuk eshte e kjart kush eshte pala e dëmtuar, kur jane marr paret, sa pare jane marr, keto para per cfar sherbimi jane marr etj, pra nuk kuptohet ne mënyrë thelbesore faktet e nje figure te nje vepre penale sipas kodit penale e aq me pak se keto elemente a jane te bazuara ne dyshim te bazuar apo te arsyeshem, prandaj kjo periudhe kohore e cekur ne dispozitiv te aktakuzes fare nuk mund te sherbej si date per vleresimin e afatit te parashkrimit, sepse ketu llogaritet afati i parashkrimit te paleve te demtuara dhe jo persoanve N.N qe jane te pa njohur, nese, llogaritet afati i parashkrimit per palet e demtuara dhe te degjuar ne gjykate dhe prokurori rezulton se kemi te bejme me afat te parashkirimt sa i perket veprës penae nga neni 262 te KPK - së. **Me tej ka theksuar se Figura e Vepres penale e mashtrimit nga neni 335 te KPK –së**, përmban disa elemente objektive dhe subjektive, vënien ne ne lajthim te personit, lajthimi te jete ne fakte te caktuara, me qellim te perfimit materiale, vepra penale kryhet ne forme te dashjes direkte. Dallimi sipas figurës se veprës penale mashtrimit sipas kodit penal te vjetër (neni 335 te KPK -së) dhe kodit penal te ri (neni 323 te KPK -së) ka te beje ne faktin se kodi i vjetër penal e inkriminon si element te veprës penale te mashtrimit “vënien ne lajthim te personave ne fakteve”, ne anën tjeter, sipas kodit penal te ri inkriminohen dhe “veprimet e tjera mashtruese”, se çka nënkuptohet me veprime te tjera mashtruse do ta definoj praktikka gjyqesore, mirëpo, nje gje eshte e kjart veprime te tjera mashtruese kane kuptim me te gjere se vetëm vënie ne lahtim te personave ne fakte. Ne rastin konkret H.P eshte akuzuar sipas kodit te vjetër penale, per shkak se ne kohen e kryerjes se veprës penale ka qen ne fuqi kjo vepër penale (neni 335 te KPK –së viti 2012). Pra nga dëgjimi i te gjithë deshmitareve, leximit te te gjithë provave materiale a ka vene ne lajthim H. P ne “fake te caktuara” apo rrethanat e dëshmuara nga deshmitaret jane “besime”, ne “ndodhi abstrakte”, “krijesa abstrake”, “hajmali per shërim shpirtëror dhe social” dhe “rituale abstrate“ te cilat nuk i takojnë botes fizike ne menyre qe te cilësohen “fakte”, gjegjesisht, ne kuptim te kodit penal ku eshte dallimi ne mes te fakteve dhe besimeve dhe a kane ndikim ne plotësimin e kushteve te veprës penale Mashtrimi nga neni 335 paragrafi 5 te Kodit Penal te Kosoves. Sic shihet me lart ka dallim substancial ne mes te fakteve dhe besimeve ne dogme dhe besimeve fetare, faktet jane ngjarjet e verteta qe ndodhin jasht mendjes tone, ndersa, besimet jane ngjarjet qe ndodhin ne mendjet tone, te cilat mund te mos jen te verteta, ose, ne nuk e dim me siguri, te cilat kane

rendesi ne definimin tone si njeri, ne japjen kuptim te jetes, jane te mbrojtura me Kushtetuten e Kosoves, Konventen Europiane per te drejtat e njeriut dhe ligjit ne fuqi dhe te zbatueshme. Dallim tjetër substancial ne mes te fakteve dhe besimeve konsiston ne rrethanen se per faktet mund te vertetohet e kunderta e ekzistimit te tyre, ndersa, per besimet nuk mund te vertetohet e kunderta ekzistimit te tyre. I njejti shton se ne asnje nga rastet e supozuara penale, nuk eshte vërtetuar se H.P i vene ne lajthim ne fakte palet e demtuara, gjegjesisht, bisedat e zhvilluar ne P kane qenë te natyres spiritual, fetare te cilat nuk jane fakte ne te vertete, ky vertetohet ne baze te degjimit te deshmitareve, p.sh nga degjimi i deshmitarit I.N, me date .. pran gjykatës i njejti ne pyetjen e mbrojtjes se a nenkupton se F.ka besu ne sherim permes magjieve fetare, i njejti eshte deklaruar, citon “.... U deklarova me lart, se ai ka besu, per kete shkak ka insist me shku...”, ngjashem ka deklaruar edhe deshmitarja H.Sh pran gjykatës me date ..., e cila ne pyetjen e mbrojtjes se ne baze te ritualeve mund ti i zgjidhni problemet, e njejta eshte deklaruar, citon ”.... Po ne baze te asaj kemi besuar dhe kemi shkruar”. Ne baze te degjimi te deshmitarit M.B me date , I njejti ka deklaruar, citoj “.... Kam mendu se me kane ba serhire...”, vlen te shtohet se pavarsisht deshmise se tij, ky deshmitar nuk e ka idetifikuar H.P n ne sallen e gjykimit ne kete kuptim deshmia e tij nuk paraqet baze te besueshme qe te i falet besimi dhe te sherbej si prove fajesuese, ne kete drejtim i njejti ka deklaruar “..jo nuk e njoh kerkon... ”. Sa i perket faktit se te gjitha deshmitart kane pasur besime na natyres fetare, ne ritualet e H.P vertetohet edhe ne baze te deshmise se deshmitarit, F.S,i cili ne pyetjen e mbrojtjes se a mujna me konstatu qe momentin kur keni shkuar te B qe permes ritualeve keni me u sheru, I njejti ka deklaruar, citoj ”.... Po ashtu kam besuar ...”, ky deshmitar rituale ngjashme ka bere edhe tek sherues popoullor te tjere, i njejti ka deklaruar, cito “.... Po kame qen edhe te do falltore qe shkrin plumb....”. Po ashtu ne baze te deshmitarit B.K, vertetohen fakte te ngjashme te lartcekurat, p.sh I njejti ne pyetjen se e mbrojtjes se a mujna me konstatu se arsyeja qe keni shkuar ka qen qe permes ritualeve t tija mundt me ndiku ne jeten tende, i njejti ka deklaruar “po”. Me tej thekson se aktiviteti i H.P me deshmitaret ka pasur te beje me rituale fetare vertetohet edhe ne baze te deshmise se deshmitarit R. L., te dhene me date .., I cili ka deklaruar , citoj ”.... Ky me ka thene se ti do te mbase nje dry me cels, 3 copa veze dhe 4 ose 6 qrijnete bardhe... “, po ashtu edhe ne baze te deshmise se deshmitares Z.M te dhene ne gjykate me date..., vertetohet e njejta gjendje faktike, e cila ne pyetjen se a keni besuar qe permes aftesive dhe ritualeve do te i zgjidhe problemet familjare, e njejta eshte pergjigjeur, citoj “..... pasi qe kame hyre Brenda jame bindur qe ka me u ndreq nusja me djalin...”, ngjashem, ka deklaruar edhe deshmitari D.Z pran gjykatës me date .., citoj “.... Me veprimtari kuptojme faktin se i njejti lutet, jep hajmali dhe procedurat qe nuk i di...”. Andaj në baze te deshmive te lartcekurat behet e kuart se nuk qendron teza e akuzes se H.P i ka vene ne lajthim palet e demtuar ne fakte te caktuar, por, nderveprimi ka pasur te beje me rutale te natyres fetare, po ashtu, nuk qendron fakti se te njejtit kane besuar ne aftesint “mbinatyrore te mbrojturit im”, por, ne cilesit e caktuar te ritualeve dhe ndikimin e ketyre ritualve ne jeten sociale dhe gjendjen shpirtore te paleve, po ashtu nuk eshte vërtetuar se H.P ka realizuar perfitim materiale ne lartesi prej 1,000.000.00 €. Tutje shton se fakti se H.P ka kryer ritual te natyres fetare dhe se rezultatin e ketyre ritualeve ne problemet shpirtore dhe sociale te paleve ja ka atribuar zotit, verteohet ne baza te fotove nga faltorja, e cila i eshte dorezuar gjykatës me date ..., ne baze te ketyre fotove fakte reale brenda faltorjes ku shihen paralajmërimet për palët e treta me emërtimin citoj “me garnacion nga zoti-allahu i merr përsipër çdo lutje, zoti ju pranofitë lutjet e mija”, një shënim tjetër shkruhet “ata që nuk besojnë nuk lejohen të hyjnë, dhe mosbesimi është i pa shpresë” si dhe pasqyrohet orenditë e kësaj faltore që nuk është në formë të ordinancës por është në formë të një vendi për lutje. Andaj nese analizohen te gjitha deshmite dhe keto prova materiale vertetohet fakti se H.P nuk ka bere mashtrim, nuk ka vene ne lajthim per fakte personat e trete, por, ka ushtruar ritual fetare, te besimeve popullore ne Kosove, qe perfshine nje mori ritual qe besohet qe ndikojne ne shendetin, jeten e njeriut. Po ashtu fakti H.P ka kryer ritual te natyres shpirtore vertetohet edhe ne baze te **Resenje nr., dt,i**”, ne baze te kësaj prove vertetohet qe nga viti ”viti” ka ushtruar aktivitete shpirtore ne organizanten “organizta”, I cili vendim krijon efekte juridike edhe tani sipas rregulores se unmikut nr. 1. Po ashtu nese analizohet deshmia e te gjitha paleve te demtuar, vlera e supozuar e perfitimit materiale arrin Shumen prej 10,640.00 €, sa i perket veprës penale mashtrimi, nese llogariten ato veprime te supozuara qe nuk ka arritur afati i parashkrimit vlera e perfitimit eshte 10,640.00 €, ne anen tjetër pretendimi i prokurorisë konsiston ne faktin se H ka realizuar perfitim ne lartesi prej 1,000.000.00 €, ky pretendim i ekzagjeruar nuk eshte i mbeshtetur ne asnje prove, tek vepra penale e mashtrimit apo e ushtrimit te kunderligjshem te veprimtarise mjekesore pala e demtuar nuk eshte nje numer, por, eshte nje person me emer dhe mbiemer i cili duhet te deshmoje rrethanat konkret te perfitimit materiale nga i pandehuri dhe faktin ne te cilin eshte vene ne lajthim. Andaj deshmia e paleve

te dëmtuar nuk është e besueshme dhe nuk duhe të i falet besimi fare, disa deshmia janë teresisht jo reacionale sic është deshmia e M.B,i cili nuk e ka identifikuar të mbrojturin tim në sallën e gjykatës, disa janë të parregullta, sic është deshmia e R.Li cili deshmimë e tij e ka dhënë në Prokurorinë Themelore në P në fakt e ka dhënë në Facebook tek prokurori P.K mbi të gjitha të gjitha këto deshmia janë vetanake, gjegjesisht, nuk kanë prova apo deshmia mbështetese për rrethanat e takimit me të mbrojturin tim, në atë formë që aktgjykimi dënuet me e një deshmitari për një rrethanë të caktuar është i vështirë të bëhet, pavarësisht, kësaj edhe nëse i falet besimi deshmitareve të lartcekur, rezultoi se në këto rrethana nuk vërtetohen elementet e veprës penale Mashtrimi, gjegjesisht, elementi objektiv i veprës penale mashtrimi “lajthim në fakt”. Po ashtu nga Prokuroria pretendohet se H.P ka marrë nga 20 euro personave të panjohur për “vizitën” që e kanë bërë e i njëjti, fillimisht, kjo pjesë e akuzës është e pa vërtetuar, me saktë e pamundur të vërtetohet, p.sh kush janë këta persona ?, po ashtu, edhe në personat e tretë kanë paguar 20 euro për vizitë tek i njëjti, kjo nuk nënkupton se ky veprim e konsumon asnjë element të veprës penale mashtrimit, respektivisht, para kësaj pagese nuk ka lajthim në ndonjë faktë, gjegjesisht, nuk ka kurrfarë kontakti me palët e tretë, bisede apo dickë të ngjashme, nuk ka premtim. Vepra penale e mashtrimit kërkon që vepra penale e mashtrimit të kryhet me lajthimin në fakt me qëllim të përfitimit, marrja e parave për vizitë nuk paraqet lajthim në fakt, pagesat prej 20 euro supozohet se janë bërë pa pasur bisede me H.P nga personat e tretë, gjegjesisht, për të aranzhuar vizitën tek i njëjti, respektivisht, për Kohën e kaluar në vizitë. Me tej ka shtuar se ngritja e Aktakuzës ndaj H.P dhe ndjekja penale në përgjithësi, paraqet veprimtari të organit administrativ – organi të ndjekjes / Prokurorisë Speciale e cila shkel të drejtat dhe lirinë themelore e njeriut të garantuar me kushtetutë dhe konventën evropiane për të drejtat e njeriut, ngase, ndjekja penale dhe ngritja e aktakuzës është cenim arbitrarë i lirisë së ndërgjegjes dhe fesë të përcaktuar me nenin 9 të Konventës dhe nenin 38 të Kushtetues së Kosovës. Andaj nëse analizohet tre dispozitivët e aktakuzës, organi i aktakuzës në mënyrë të pa drejtë pretendohet se nga viti 2005 deri në vitin 2019 H.P ka bërë mashtrim, ushtrim të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore dhe pastrim të parave për aktivitete të cilat janë aktivitete që mund të cilësohen si rite fetare, nëse merret si i mirëqenë “logjika juridike” e organit të aktakuzës së H.P se ka kryer mashtrim për besimet e veta dhe praktikumin e besimeve të veta, në fenomene paranormale, fuqi mbi natyrore dhe forca mbi natyrore si dhe fuqi e Perëndisë, a i bie që edhe bashkësitë të “regjistruara” të tjera në Republikën e Kosovës duhet të vërtetojnë “ekzistencën e zotit”, vërtetojnë “vërtetësinë e librave të shenjtë” dhe nëse nuk vërtetohen a i bie që edhe këto bashkësi fetare të regjistruara janë duke kryer dhe kryejnë veprën penale të mashtrimit për çdo pagesë anëtarësisë të anëtarëve të saj ose për çdo trajtim “para mjekësor” ritual sipas rregullave të besimeve dhe feve të tyre. Teza e aktakuzës së Prokurorisë Speciale qëndron në faktin se rritet fetare me qëllim të shërimit shpirtërorë apo fizik, zgjidhjes së problemeve familjare dhe sociale të kryera në vitin 2005 deri në vitin 2019 ndaj personave N.N janë mashtrime të kryera nga H.P, duke u bazuar në faktin se nuk mund të vërtetohet ekzistenca e forcave, entiteteve hyjnore dhe perëndisë në formën dhe rregullat që beson H.P dhe besimtar të tjerë. Me tej ka shtuar se në rastin konkret si H.P apo ashtu edhe “palët e dëmtuara” kanë besuar në “forcë të mbi natyrshëm” dhe “entitet të mbi natyrshëm”, mos vërtetimi i ekzistencës së “forcës së mbi natyrshme”, “entitetit të mbi natyrshëm” apo “aftësive shëruese dhe zgjidhësi të problemeve sociale të këtij entiteti” nuk paraqet mashtrim apo çfarëdo veprimi tjetër të kundërligjshëm, ngase, besimi nuk mund të vërtetohet. Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat mbrojtja gjën se në rastin konkret dispozitivi i aktakuzës sa i përket veprës penale Mashtrimi nuk është vërtetuar se është kryer nga H.P, nuk është vërtetuar se i njëjti i ka vënë në lajthim në faktë palët e dëmtuar, është vërtetuar se aktiviteti i tij ka pasur natyrë të besimit popullor, i cili nuk mund të vërtetohet e kundërta e besimit popullor, në mënyrë që të vërtetohet se a ka lajthim apo jo, nuk është vërtetuar se shumica e përfitimit nga ky aktiviteti arrijnë shumën në lartësi prej 1,000.000.00 €, ky aktivitet përveç që nuk paraqet veprë penale, i njëjti, është i mbrojtur sipas konventës evropiane për të drejtat e njeriut dhe kushtetues së Kosovës. I ka propozuar gjykatës sa i përket veprës penale mashtrimit të nxjerr Aktgjykim Lirues apo Refuzues, për shkak se nuk është vërtetuar se është kryer vepra penale e mashtrimit ose ka arritur afati relativ i ndjekjes penale të mashtrimit. Po ashtu vërtetohet se qëllimi i H.P përmes regjistrimit të biznesit të tij si “O” nuk ka qenë që të ushtroj veprimtari mjekësore të rregullt ashtu sic pretendohet nga ana e akuzës dhe as nuk ka pasur qëllim që të ushtroj veprimtari të veprimtarisë të mjekësive alternative popullore të shërimit shpirtëror ashtu sic përcaktohet me ligjin për shëndetësi, por, që nuk është rregulluar me tej, në mënyrë specifike, i mbrojturi përmes shkresave të drejtuara Ministrisë së Shëndetësisë ka kërkuar rregullimin me akte nenligjore të mjekësisë alterantive në mënyrë që të mos ngatrohët veprimtaria e tij me veprimtarinë e rregullt mjekësore. **Me tej ka theksuar se vepra penale armbjtte pa leje sipas nenit 374 par.1 të KPK-së,**

kryhet me dashje direkte, ne baze te nenit 21 te KPK –së, eshte percaktuar se personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj, gjegjesisht, poseduesi i armës e din që arma nuk leje dhe e posedon edhe me tutje si të tillë, ne rastin konkret, dashje nuk është vertetuar se ekziston, ngase, i mbrojturi im për të dy armet ka pasur leje nga organet kompetente, gjegjesisht, “leje të vecant” për perodrimin e pistoletës, nr .. dhe leje për arme të shenjtarisë nr ..., këto dokumente leshohen nga organet kompetente dhe janë leshuar sipas ligjeve në fuqi, në anën tjetër posedimin e këtyre armëve i mbrojturi im e ka bërë sipas të njëjtave dokumente, në kuptim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit për Armet. I njëjti i ka propozuar gjykatës lidhur me vepën penale nga neni 374 të KPK–së, të nxjerr Aktgjykim Lirues. Pasi që aktakuza përkitazi për të mbrojturin tim është e paqëndrueshme, e pakuptueshme, e pa artikulueshme, e përgjithësuar, kundërthënës, jo realiste, e paarsyetuar. **I njëjti me tej ka theksuar se Vepra penale Pastrim i Parave - neni 302 të KPRK lidhur me nenin 32 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.1. të Ligjit nr. 03/L- 96 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit**, Prokuroria pretendon se H.P duke e ditur se pasuria e tijë buron nga aktivitetet kriminale të përshkruara në Aktvendimin mbi fillimin e hetimeve PP/II nr. .. të dt...dhe Aktvendimin për zgjerimin e hetimeve PP/II nr. .. të dt. ..., të Prokurorisë Themelore në P Departamenti i Përgjithshëm, dhe është e fituar me kryerjen e veprave penale, me qëllim të fshehjes së këtyre aktiviteteve dhe bU,t të vërtet të pasurisë, të njëjtën e ka konvertuar në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe atë : Ngastra kadastrale me nr. ..., në sipërfaqe prej 4906 m², e cila gjendet në zonën kadastrale P, Komuna Kadastrale P, e cila evidentohet në emër të L.R. dhe K. Y. ..., dhe atë 153 m² oborr dhe 104 m² shtëpi; Ngastra kadastrale me nr. P..., me sipërfaqe të përgjithshme prej 530 m², e cila gjendet në zonën kadastrale L., Komuna Kadastrale P, e cila evidentohet në emër të H. (B.) P (në këtë parcel është i ndërtuar nga personi i njëjët objekti prej 530 m²), Ngastra kadastrale me nr. P-..., me sipërfaqe të përgjithshme prej 95 m², e cila gjendet në zonën kadastrale P.Komuna Kadastrale P., e cila evidentohet në emër të H.(B.) P, Ngastra kadastrale me nr. P-..., me sipërfaqe të përgjithshme prej 3270 m², e cila gjendet në zonën kadastrale P, Komuna Kadastrale P, e cila evidentohet në emër të H (B.P me pjesë të pronësisë prej 5/8, kurse B. (R.) Sh., me pjesë të pronësisë prej 3/8, Ngastra kadastrale me nr. P-..., me sipërfaqe të përgjithshme prej 3256 m², e cila gjendet në zonën kadastrale P, Komuna Kadastrale P, e cila evidentohet në emër të A. (B.) Sh., Lokali në sipërfaqe prej 174 m² i evidentuar sipas njësisë kadastrale O-.. Zona Kadastrale në P, (Lokali tek "L.-BP"), të blerë nga H (B.) P, Lokali në sipërfaqe prej 92 m² i evidentuar sipas njësisë kadastrale O., Zona Kadastrale në P, (Lokali tek "L."), të blerë nga H (B.) P, Ngastra kadastrale me nr. P-..., me sipërfaqe të përgjithshme prej 2341 m², e cila gjendet në zonën kadastrale P, e cila evidentohet në emër të: E.R., B.RE.P,K.R,E.K,A.Pdhe Sh.K në të cilën parcel sipërfaqen prej 1733 m², e ka blerë i pandehuri H.Pi cili edhe është në pushtetin faktik në këtë pjesë, ku dhe e ka të rrethuar dhe të rregulluar, Vetura e tipit "M..", ngjyrë e hirit, me targa .., me numër të shasisë:..., viti i prodhimit 2019, në pronësi të Auto Salloni P. SH.P.K, Vetura e tipit "S..", ngjyrë e zezë, me targa, me numër të shasisë:, viti i prodhimit 2014, në pronësi të U P (djali i të pandehurit H.P), Vetura e tipit "Ë. -G ", ngjyrë të zezë, me targa .., me numër të shasisë:, viti i prodhimit 2015, në pronësi të M. M., Vetura e tipit "A.", ngjyrë e bardhë, me targa .., me numër të shasisë: .., viti i prodhimit 2018, në pronësi të H.P, Vetura e tipit "L. R.", me targa .., ngjyrë të kaltër, me numër të shasisë: .., viti i prodhimit 2018, në pronësi të F.P (djali i të pandehurit H.P), Vetura e tipit "R. M.", ngjyrë të bardhë, me targa .., me numër të shasisë: .., viti i prodhimit 2018, në pronësi të U P (djali i të pandehurit H.P), Vetura e tipit ".T.", ngjyrë e kaltër, me targa .., me numër të shasisë:..., viti i prodhimit 2016, në pronësi të H.P, Vetura e tipit ". G.", me targa .., ngjyrë të zezë metalike, me numër të shasisë: .., viti i prodhimit 2009, në pronësi të H.P, 8 (tetë) kuti të bizhuterisë Sëarovski dhe atë: bylyzik dore LUM/PDS nr.5255112, bylyzik dore LUM/MIX nr..., vathë CRY/RHS nr..., rryp i dorës JET HEU/PDS nr..., zingjirë qafe LMUL/RHS nr..., vathë GREY/STS nr..., aksesorë dore CRY/RHS nr.5277942, si dhe qafore LMUL/MIX nr...së bashku me një bylyzik dore me mbishkrimin "Cartier", Të hollat në xhirollogarinë bankare nr. ..., pranë bankës BKT, në emër të tijë, 2 (dy) kartëmonedha në vlerë 10 (dhjetë) Euro me nr. serik: .., .., 1 (një)kartëmonedhë në vlerë 20 (njëzet) Euro me nr. serik: ... 3 (tre) kartëmonedha në vlerë 50 (pesëdhjetë) Euro, me nr. serik: .., .., .., 1 (një) monedhë në vlerë 10 (dhjet) cent, 9 (nëntë) monedha në vlerë nga 20 (njëzet) cent, 3 (tre) monedha në vlerë nga 50(pesdhjet) cent, 2 (dy) monedha në vlerë nga 2 (dy) Euro, 3 (tre) monedha me vlerë nga 1 (një) Euro dhe se me këtë, kishte për të kryer veprën **penale Shpërlarja e parave nga neni 302 të KPRK lidhur me nenin 32 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.1. të Ligjit nr. 03/L- 96**. Me tej ka shtuar se Vepra penale e Shpërlarjes së parave kryhet kushdo që, duke e ditur ose që ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila

në të vërtetë fitohet me vepër penale apo kushdo që, duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin XXIX të Kodit të procedurës penale të Kosovës. Andaj në rastin konkret nuk është vërtetuar, në mënyrë thelbësore se nga cila “veprimtari e kundërligjshme apo vepër penale” janë rrjedhe dhe përfitim i veprës penale, shuma prej 1,000,000.00 euro, e cila është e deponuar nga H.P, përkundrazi pasurin e pershkruar në atakuzë e ka fituar me punën e tij të ligjshme, përmes vjeljes së frutave të pasurisë së tij si qirat, aktivitete e tjera shërbyese, si shitjen e mishit, picerit, restorantet dhe shitjen e kamerave dhe pjesëve të kamerave. Pra organi i akuzës nuk ka vërtetuar fazat e kryerjes së veprës penale shpëlarje të parave atë të **depozitimit, transferimi dhe integrimi me parat e pastra** (elemente të tjera përveç përfitimit nga vepra penale), në rastin konkret qartazi vërehet se edhe sipas përshkrimit të veprës penale nuk përfshinë këto elemente pa të cilat nuk ka vepër penale të shpëlarjes së parave, të përcaktuar nga neni 32 i Ligjit për shpëlarjen e parave. Paragrafi 2.6 i neni 32 të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave përcaktuar se kushdo që fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, në rastin konkret, deponimi i parave nuk paraqet veprim që fsheh natyrën e vërtetë, për tu konsideruar që janë kryer elementet e tërësishme të kësaj veprë penale, duhet të vërtetohet se këto para pas deponimit janë transferuar në një llogari tjetër bankare si rezultat i një pune juridike fiktive dhe pasuria e blere paraqet shtresimin e pasurisë e cila vërtete e fsheh origjinën fillestare të parave të deponuara, për me tepër në rastin konkret nuk është vërtetuar se këto para/pasuri janë rezultat i përfitimit të një vepër penale tjetër, në mënyrë të veçantë supozimi i prokurorisë se këto para në lartësi prej 1,000.000.00 € është rezultat i veprës penale Mashtrimi dhe Ushtrim i Kunderligjshëm i Veprimtarisë Mjekesore, ky pretendim është paragjykes, i pa bazuar. Edhe nëse gjykata e vlerëson se i mbrojturi im ka kryer veprën penale Mashtrimi dhe Ushtrim i Kunderligjshëm i Veprimtarisë Mjekesore, në rastet e paraqitura para gjykatës, madje, nëse llogaritet rastet që janë parashkruar, vlera e supozuar e perfimit nuk arrin shumen prej 10,640.00 €, p.sh sipas deshmisë së paleve të dëmtuar të dhena me seancën e datës 17.09.2021, 01.06.2021, 05.08.2021, të njëjtit kane deklaruar se kane paguar keto shuma, M.B20 €, F. S. 1500.00€, B.K,2550.00 €, R.L1,000.00 €, Z.M 2020.00€, D.Z1,000.00 €. Në rastin konkret, Prokuroria nuk ka vërtetuar se ekziston dyshimi i bazuar mirë se i mbrojturi P ka kryer veprën penale pastrim i parave, nuk ka vërtetuar të gjitha elementet e veprës penale të pastrimit të parave, siç janë : vërtetimi i faktit se parat janë rezultat i një veprë penale në mënyrë të artikuluar, me saktë e gjithë shuma prej 1,000.000.00 €, se ka ndodhur transferimi dhe shtresimi i pasurisë, gjegjësisht, fshehja e **origjinës së vërtetë të parave**. Po ashtu organi i akuzës konsiston në faktin se kinse i mbrojturi im ka përmes pagesë së kësteve të kredisë dhe deponimit të parave nga punonjësit e H Peqnait është fshehur natyrë e vërtetë të parave, kjo pjesë e vërtetimit është tërësisht, e pa vërtetuar, e pa bazuar dhe bazohet në supozimet dhe paragjykime, në mënyrë të vecantë nëse analizohen provat materiale, p.sh dëshmitari M. Q. ka deklaruar pran gjykatës me datë 08.11.2021, në faqen 6 rreshti i fundit i cili ka deklaruar se ka qenë kjo, por në atë kohë ka qenë i kërcënuar, “i referohet H.Pt” dhe nuk ka pas arsye tjera për mos me shku me bo pagesë, kjo pjesë e deshmisë vërtetohet në baze të **Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në P me nr.P.nr.2005/16 të dt.14.06.2018, në baze të ketyre provave vërtetohet fakti se nga viti 2013-2017 H.Pka bere pagesa permes punetoreve te vete, per shkak te angazhimeve te tjera te tij, per shkak se ka qen pale e dëmtuar nga viti 2013 deri ne vitin 2018 si dhe pagesa nga punetoret e tij jane bere per pagesen e kesit te kredis, Se keto deponime jane bere per pagesen e kesit te kredise vërtetohet edhe në baze të deshmitarit Rr.Ene deshmime e tij të dhene me datë 19.09.2021 pran gjykatës I njëjti ka deklaruar, citoj “... po per kest te kredise....”, ndersa, ne pyetjen se pse pagesat nuk i ka bere H.P, I njëjti ka deklaruar, citoj ”.... Ndonjehere nuk ka pas kthe, çdo here ka pas aryeje.....’.Ndërsa sipas sqarimeve të bëra nga dëshmia e dëshmuarit D.Hpran gjykatës me datë 08.11.2021, i njëjtit, ka deklaruar se, citoj “... a është e vërtete me date 04.11.2014 është bere transferimi nga ndërmarrja U, në llogarinë tuaj në lartësi prej 248,750.00 euro, i njëjti ka deklaruar, me qellim që të behet regjistrimi i pronës, sepse, pa kalim të mjeteve në llogari nuk ka qene e mundur të behet regjistrimi i pasurisë së blere....”. E si përfundim ka theksuar se duke marr parasysh të lartcekurat dhe provat që i ka dorëzuar mbrojtja sa i përket biznesve të tjera që H.P ka zhvilluar në jetën e tij, vërtetohet fakti se parat për blerjen e pasurisë janë fituar në mënyrë të ligjshme, përmes qirave, me biznese të ndryshme, në anën tjetër pretendimi i prokurorisë se këto para janë fituar përmes mashtrimit janë tërësisht të pa bazuar. I njëjti i ka propozuar gjykates sa i përket pikës IV të aktakuzës të nxjerr Aktgjykim Lirues. Tutje ka theksuar, se prokurori ka propozuar **Konfiskimin e Perhershëm të Sendeve të pershkruar si në dispozitivi të Aktakuzes**, Pasuria sipas aktakuzës paraqet: pasurin : Ngastra kadastrale me nr. ..., në sipërfaqe prej 4906 m², e cila gjendet në zonën kadastrale P, Komuna Kadastrale P, e cila evidentohet në emër të L. R. .. dhe K. Y.**

10/239, dhe atë 153 m² oborr dhe 104 m² shtëpi; Ngastra kadastrale me nr. P-..., me sipërfaqe të përgjithshme prej 530 m², e cila gjendet në zonën kadastrale L., Komuna Kadastrale P, e cila evidentohet në emër të H (Basri) P (në këtë parcel është i ndërtuar nga personi i njejët objekti prej 530 m²), Ngastra kadastrale me nr. P-71611071-04376-23, me sipërfaqe të përgjithshme prej 95 m², e cila gjendet në zonën kadastrale P., Komuna Kadastrale P., e cila evidentohet në emër të H (B.) P, Ngastra kadastrale me nr. P-71813068-06970-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 3270 m², e cila gjendet në zonën kadastrale P, Komuna Kadastrale P, e cila evidentohet në emër të H (B.) P me pjesë të pronësisë prej 5/8, kurse B. (R.) Sh., me pjesë të pronësisë prej 3/8, Ngastra kadastrale me nr. P-..., me sipërfaqe të përgjithshme prej 3256 m², e cila gjendet në zonën kadastrale P, Komuna Kadastrale P, e cila evidentohet në emër të A.(B.) Sh., Lokali në sipërfaqe prej 174 m² i evidentuar sipas njësisë kadastrale ..0, Zona Kadastrale në P, (Lokali tek "L."), të blerë nga H (B.) P, Lokali në sipërfaqe prej 92 m² i evidentuar sipas njësisë kadastrale O-..., Zona Kadastrale në P, (Lokali tek "L."), të blerë nga H (B.) P, Ngastra kadastrale me nr. P...., me sipërfaqe të përgjithshme prej 2341 m², e cila gjendet në zonën kadastrale P, e cila evidentohet në emër të: E.R., E.R, E.P,K.R,E.K,A.P dhe Sh.K në të cilën parcel sipërfaqen prej 1733 m², e ka blerë i pandehuri H.P i cili edhe është në pushtetin faktik në këtë pjesë, ku dhe e ka të rrethuar dhe të rregulluar, Vetura e tipit "M", ngjyrë e hirit, me targa .., me numër të shasisë: .., viti i prodhimit 2019, në pronësi të Auto S. P. SH.P.K, Vetura e tipit "S.", ngjyrë e zezë, me targa ..., me numër të shasisë: ..., viti i prodhimit 2014, në pronësi të U. P (djali i të pandehurit H.P), Vetura e tipit "Ë. -V G", ngjyrë të zezë, me targa ..., me numër të shasisë: .., viti i prodhimit 2015, në pronësi të M. M., Vetura e tipit "A.", ngjyrë e bardhë, me targa .., me numër të shasisë: .., viti i prodhimit 2018, në pronësi të H.P, Vetura e tipit "L. R.", me targa ..., ngjyrë të kaltër, me numër të shasisë: .., viti i prodhimit 2018, në pronësi të F. P (djali i të pandehurit H.P), Vetura e tipit "R. M.", ngjyrë të bardhë, me targa .., me numër të shasisë: .., viti i prodhimit 2018, në pronësi të U.P (djali i të pandehurit H.P), Vetura e tipit "V T.", ngjyrë e kaltër, me targa ..., me numër të shasisë:..., viti i prodhimit 2016, në pronësi të H.P, Vetura e tipit "V. G", me targa .., ngjyrë të zezë metalike, me numër të shasisë:..., viti i prodhimit 2009, në pronësi të H.P, 8 (tetë) kuti të bizhuterisë Sëarovski dhe atë: bylyzik dore LUM/PDS nr..., bylyzik dore LUM/MIX nr..., vathë CRY/RHS nr.5277941, rryp i dorës JET HEU/PDS nr..., zingjirë qafe LMUL/RHS nr...., vathë GREY/STS nr...., aksesorë dore CRY/RHS nr...., si dhe qafore LMUL/MIX nr... së bashku me një bylyzik dore me mbishkrimin "C.", Të hollat në xhirollogarinë bankare nr. ..., pranë bankës B., në emër të tijë, 2 (dy) kartëmonedha në vlerë 10 (dhjetë) Euro me nr. serik: ..., UD...., 1 (një)kartëmonedhë në vlerë 20 (njëzet) Euro me nr. serik: .., 3 (tre) kartëmonedha në vlerë 50 (pesëdhjetë) Euro, me nr. serik: ..,, 1 (një) monedhë në vlerë 10 (dhjet) cent, 9 (nëntë) monedha në vlerë nga 20 (njëzet) cent, 3 (tre) monedha në vlerë nga 50(pesdhjet) cent, 2 (dy) monedha në vlerë nga 2 (dy) Euro, 3 (tre) monedha me vlerë nga 1 (një) Euro dhe se me këtë.Vlera e kësaj pasuria sipas ekspertiza financiare arrin vleren nga nga 1,333.710.00 deri 1,647,000.00 €, varesisht, cilën ekspertize e mere per baze, ne anen tjeter nese merrret per baze deklarata e paleve te demtuara rezulton se perfitimit i supozuar nga vepra penale sipas pikes 1 ne mënyrë konkrete arrijne Shumen prej 10,640.00 € p.sh sipas deshmise se paleve te demtuar te dhena me seancen e dates ..., te njejtit kane deklaruar se kane paguar keto shuma, M.B 20 €, F. S. 1500.00€, B.K,2550.00 €, R.L1,000.00 €, Z.M 2020.00€, D.Z1,000.00 €. Andaj në rastin konkret, propozimi per konfiskim te perherhshem te parsurise eshte **I pa bazuar**, I mbeshtetur ne supozime dhe nuk perfille vleren e perafert te perfitimit te supozuar nga pasuria, dallimi i shumes se prave qe supozohet se jane fituar ne lartesi prej 10,640.00 €, me vleren 1,333.710.00 € (ose 1,647.000.00€) te pasurise se propozuar per konfiskim paraqet cenim te rende te sigurise juridik edhe eshte i pa drejt. I ka propozuar gjykatës te refuzoj propozimin e organit te akuzes per konfiskimin e perherhshem te pasurise. Tuje ka shtuar se nuk ekzsitojne rrethana qe gjykata te nxjerr Aktgjykim per asnjërën veprer penale si ne dispozitiv te atakuzes, mirëpo, nëse gjykata vlerëson se ndonjë vepër penale H.Pka përgjegjësi penale, gjykata si rrethanat lehteuse te i marr parasysh gjate matjes se llojit dhe lartësisë se dënimit ose sanksionit penal, dhe ate, moshën e te mbrojturit tim, e cila eshte relativisht e shtyer, faktin se i njejtë nuk gëzon nje shëndet jo te mir, eshte prind i 5 femijeve, mbajtës i familjes, bashkëshort, nuk ka kryer ne te kaluarën vepër penale. Andaj nga të gjitha provat materiale vërtetohet bindshme dhe pa asnjë dyshim se H.Pnuk ka ndërmarr veprimet inkriminuese në drejtim të kryerjes ë veprave penale të përshkruar në aktakuzë.

I akuzuari H.P në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, si dhe fjalën përfundimtare të parashtruar me shkrim e të elaboruara edhe në shqyrtim gjyqësor, i njëjti ka theksuar se në jetën time më është berë e pa drejt ku një person më ka akuzue që vitin 2014 pa

argumete pa bazë . Edhe pse jemi si komunitet pakic të Kosovës, jemi rritë një familje me edukat dhe sjellje nga gjyshi e baba i ynë që naj kan mësuar cdo herë të jemi të qetë dhe tolerant ndaj miqve ndaj fisit, ndaj kombit,ndaj adheut qdo herë kemi qenë atdhetar kombetar ma shum se shqiptarija në vendit tonë dhe kontributin tonë, ndaj shtetit dhe vendit tonë . Asnjëherë nuk na ka ndodhë që jemi kunder, Races njerzore feve ,apo ngjyrave ishim tolerant ndaj gjithëve popullit mbar botës . Në jetën time asnjë herë se besoj që kam trathëtuar apo Mashtruar popullin tim vendin tim edhe pse kemi vuajt dekada para luftës nga Rregjimin sllavë . Mu personalisht mu ka ba një padrejtsësi që vitin 2018 , pse vetum që, isha Korrekt,e flisja të verteten, çdo kund.dhe u bera person FIGUR PUBLIKE. Dhe ndoshta shumë kujt i ka pengue skena dhe dalja ime në emisjone ku isha i ftuar, Ne emisjone tv.DHE U BERA VIKTIMË E POLITIKES. Më është berë e pa drejt ku më Burgosën, me datë Besoj dhe medoj që gjithka ishte e kurdisur ,e manipuluar, E gatuar pa Bazë pa fakte. POLITIKISHT të Ndikuar si nga ana e hetuesis, si prokurerisë Pit. Unë H.PB më mirë tisha i vdekur Se të isha ktu perball opinjonit,mediatik,para gjykates, fakt një herë isha i vdekje që në parabU të Pit gjatë muajit shkurt . Po fati e zoti e ka dorë jetën.u RINGJALLA. Të nderuar drejtësi si shtetë ligjorë të kosovës a veq per mua vlen ligji i ndalimit punës sime a vetum pse jam komunitet dhe është shfrytzue casti koha, që tmë akuzoni per punën time ku në Kosovë veprojn ,punoj,shkrujn, hajmalija ,frynë e ben Rukje kuranit e shum tjerë që as skan pagu azgje dhe janë medija të gjith kta veprojn punojn dhe askush smirret me ta pse, A vetum që janë shqiptar. Kosideroj të gjithë jemi barabart para ligjit ,po MEDIAT ABUZUAN ME LAJME. Dhe i vetmi un si komunitet pakic të më ndaloni të më akunzoni KINSE MJEKSI FARMACUETIKE,E SHUM VEPRATJERA , kjo nuk është e drejt kjo ka qenë per mua një DISKRIMINIM RACOR . dhe politik ndaj komunitetit tim dhe besimtarve të mi SHAMAN. Tutje I njëjti ka theksuasr se ushtrij besimeve popullore, rajonale, ne Kosove, ketij besimi I takojne dhe shume qytetar ne Kosove dhe rajon, ky besim nuk besim nuk perjashton besimet e tjera tradicionale, por, ektziston se bashku me to, ma sakt mundesh me qen P.sh Musliman edhe me besu ne keto ritual dhe besime, permes ketij besmi besojme ne nje zot, ne ekzisencen e gjineve, krijesave e pa dukshme, qe jane te mira dhe e keqija, qe keto krijesa dhe fati , peraktimi I te ardhmes, ndikojne ne gjendjen shpirtore dhe jeten e tyre e perditshme dhe jeten ne pergjithesi, besojme se ekziston jeta e pertejme, ka gjenet dhe gjejnem, besojme qe veprimet ton ate mira apo te keqija percaktojne fatin tone ne jeten pas vdekjes, por, edhe ne fatin ton ne kete jete deri sa te vdesim, p.sh nese personi kryen nje veper te keqe ose mekat, do t kete ne ket jete jete te keqe me vuajtje ne forma te ndryshme dhe vetem pendimi dhe krerja e ritaleve te caktuara mund me ndihmen e zotit dhe hyjnive te tjera do te mund te permisohet jeta dhe pastrohet shpirti nga mekatet. Andaj ky besim ekziston edhe para se te lindi une, ekziston dhe edhe treva te Kosoves dhe ne Ballkan si dhe Europe dhe ka persona si ne qe I kryejn keto ritale dhe te cilet kane tempuj per kryerjen e ritaleve dhe lutjeve si dhe ka vende te shenjta, ky besim nuk eshte shpikje e imja, por, ekziston dhe eshte fakt notore qe ka ekzistuar edhe para lindje se babbes tim, gjyshit, stergjyshit etj. P oashtu une besoj se ky besim fetar ka ekzistuar edhe para lindjes se feve abrahamike, si salami dhe kristianizmi. Pra ky besim tradiconale ekzsiton edhe ne bot, ne formen me te paster tek popujt aborigjen, nomad qe nuk jane civilizuar mjaftueshem. Disa nga ritualet jane dhezja e qirnjëve, lutja nga besimtarët dhe gjuhen shqipe ne falltove, lutja nga prijesi fetar, ndezja dhe leximi I flakes, sperkatja e besimari me uje, sperkatja me uje dhe flak ose gjethe te bimeve te besimtarit, shkrimi I talismaneve, lidhja dhe zgjidhja e nyjeve. Qellimi I ketyre ritualeve e kane largimin e besimari nga mekatet, shlirimin e shpiritit nga formcat demonike te liga, ruajtjen e individit dhe familjes nga keto forca te liga, me dhezjen e qiriut ka per qellim ndemjetesimin e lutjeve te besimtareve me shpritrat, dhezja e flakes ka per qellim interpretimin te ngjarjeve te fshehta qe I kan ndodhr beimtarit dhe I cili eshte njoftuar apo nuk eshte I njoftuar, po ashtu, perms flakes shihen edhe figurat e krijesave te mira apo te keqija, qellimi I sperkatje eshte me qellim te pastrimit te mekateve, largimin e te keqes nga trupi, shkrimi I talismaneve ka per qellim mbrojtjen e njeriut qe te mos I futet ne trup apo shtepi ndonje force e keqe, qoft shpirt I te vdekurit, egjine apo demon, lidhja dhe zgjidhja e nyjeve ka per qellim zgjidhjen e fatit te njeriut dhe zgjidhjen e problemit e njeriut, keto ritual mund te ken sukses vetem nese zoti I ndihmon besimtarit dhe jo nga formca mbinatyrore e imj apo prijeseve te tjere fetar te ketij besimi, por, per dallim nga besimtari I thjesht une I kuptoj keto ritual, I interpretoj shenjat me mir, e kuptoj gjuhen e vecant te ketij besimi, e cila eshte gjuhe e vdekur, I kuptoj lutjet ne kete gjuhe dhe perms riutaleve dhe besimit ne zot, zot mund

te I ndihmoj besimtareve. Tutje ka shtuar se ketij besimi ka shum besimtar, po thujse shumica e popullit te kosoves besojn ende keto rituale, dhe kurdo qe kane probleme jetesore menjhere mendojne te vizizojne ndonje bablok, vend te shenjt apo prijes fetar te ketij besimi, ky besim eshte i njejte dhe I perhapur ne githe ballkanin, por, edhe ne Europe dhe ne bot, natzrisht besimi fetar tradicional ballkanik ka ngjashmeri te medha si I pershkruve me lart. Andaj te gjithë personat qe vijne tek une apo ne faltoren time, nuk vijne pse I thirri apo pse paraprakisht I bindi per kete besim, por, te njejtit e kane te krijuar ne kete besim dhe keto ritale, para se te flas ndonje fjale me ta.

Në shqyrtimin gjyqësor publik gjykata konform nenit 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plot vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimale profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarve si dhe ato në favor të tyre duke i mundësuar të akuzuarve shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Pas procedimit të provave personale dhe materiale në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht me njëra-tjetrën, në kuptim të nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së, kjo gjykatë ka vërtetuar se ka prova se i akuzuari H.Pka kryer veprat penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor me administrimin e provave personale si: dëgjimi e të dëmtuarit - dëshmitarit **R.L** të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës .. dëgjimin e të dëmtuares - dëshmitares **Z.M** të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës .., dëgjimin e të dëmtuarit-dëshmitarit **D.Z** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e të dëmtuarës - dëshmitares **H.Sht** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e të dëmtuarit - dëshmitarit **M.B** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e të dëmtuarit – dëshmitarit **F.S** të dhënë shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e të dëmtuarit - dëshmitarit **B.K**, të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e ekspertit financiar **R.F** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e dëshmitarit **Rr.E** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e dëshmitarit **B.K** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e dëshmitarit **E.B** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e dëshmitarit, **R.T** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e dëshmitarit **J.M** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e dëshmitarit **Sh.L** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e dëshmitares **L.K** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e dëshmitarit **M.Ç** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e dëshmitarit **D.H** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., dëgjimin e dëshmitarit **F.Sht** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .., si prova personale janë lexuar deklarata e dëmturit dëshmitarit **B.K** të dhënë në prokurori me datë ..., deklarata e dëshmitarit **M.K** të dhënë në polici me datë ..., deklarata e dëshmitarit **F.C** të dhënë në polici me datë

Si dhe me provat materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor siç janë: Certifikatën e ARBK-së mbi regjistrimin e biznesit O “B”, nr ... e dt.; Vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë nr. ... i dt.; Raport inspektimi i Inspektoratit Shëndetësor të Kosovës Ref ... të dt. .. me fotografi; Procesverbali mbi inspektimin e bërë i Inspektoratit Shëndetësor të Kosovës nr. ... i dt. ..; 4 Libra të evidencës të cilat ka mbajtur vet i pandehuri për vitin ..., Procesverbale mbi kontrollin të dt. .. dhe .. me Vërtetime mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dhe me fotoalbume, fletoret me shënime, armë, veturat, pajisje elektronike, CD dhe USB me inqizime, të hollat, telefonat, Ekspertiza financiare e dt. ... nga “G.” SHPK L. nga eksperti Dr. Sc. V. I., Ekspertiza financiare e ekspertit të angazhuar nga ana e të pandehurit, Sh. B. ecc i dipl. e dt. ..; CD me inqizime të paautorizuara, të sekuestruara nga paisjet elektronike të të pandehurit; Transkriptat e përgjimeve; Ngastra ..., me sipërfaqe prej 3270 m², Kontrata mbi shitëblerjen e patundshmërisë e dt..... - ngastrës kadastrale nr. ..., me sipërfaqe prej 3270 m², e cila gjendet në vendin e quajtur A..., mes të akuzuarit dhe E. Sh.t, *Kopja e planit nga Drejtoria për Gjeodezi, Vërtetimi i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa i dt. .. se E. Sh. e ka paguar tatimin ashtu që nuk ka pengesa për bartjen e pronësisë, Aktvendimi i dt. .. i Zyrës së Kadastrit në P për bartjen e pronësisë në emër të të akuzuarit, Qertifikata e dt. .. e Agjencisë kadastrale në emër të të akuzuarit, shenimet e të akuzuarit, të shkruara*

me dorë- dt. ... sot me këtë ditë e shtune e kemi ble nga E.Sh.i , blerësi H.P....kapar të jepen 20 mijë euro , nënshkrimet ... pastaj do data të ndryshme dhe shifra të ndryshme, Deklarata e E. Sh. e dt. ... e dhënë te avokati B. K.; Ngastra kadastrale fqinje me nr. ..., e blerë në 5 pjesë; Kontrata mbi shitëblerjen e sipërfaqës prej 3 ari e përpiluar te avokati A. J., me ..., mes blerësit të pandehurit H.P dhe shitësit S. K., me qmimin prej 40 mijë euro, Shenimi i të akuzuarit i shkruar me dorë, i dt. ... : e kemi ble tokën nga S. K. nga Pi , blerësi B. P.... Kaparë janë dhënë sot 10 mijë euro... Shenime tjera me dorë, me dt. ... i pandehuri i ka paguar shitësit të lartcekur shumë prej 2500 €, e pastaj me dt. ... edhe 7500 €; Kontrata mbi shitëblerjen e paluajtshmërisë e dt. ... mes të akuzuarit dhe A.Sh.. , për sipërfaqen prej 761 m2, me qmimin prej 70 mijë euro, A. Sh..e ka përfaqësuar bashkëshortja e tij N.Sh., Shenime me dorë : “ Sot me dt. viti i paqartë apo) A. i murr paret e fundit 45 mijë ... ” Këtë shitëblerje e ka vërtetuar edhe dëshmitari F.Sh; Kontrata e dt. e përpiluar te avokati A. J.mes të akuzuarit dhe shitëses L.K për blerjen e shtëpisë dhe tokës në vendin e quajtur “B.” , në sipërfaqe prej rreth 195 m2. Qmimi sipas kontratës ka qenë 40 mijë euro. Shenime me dorë : datat dhe shumat e ndryshme të të hollave të cilat i akuzuari ka paguar për këtë paluajtshmëri. L.K në cilësi të dëshmitarës ka deklaruar se të gjitha të hollat i ka marrë në dorë; Në maj të vitit ..., sipas deklaratës së dëshmitarit M.K(deklarata e dt. ..., e cila është lexuar në seancën e kaluar), sipërfaqën prej 3 ari në ngastrën 6971 , rr. B. , dëshmitari ia ka shitur të akuzuarit, Marrëveshja e shkruar me dorë e dt. ... mes të akuzuarit dhe shitësit E. Sh. për blerjen e shtëpisë në rrugën J. e R. në P , në vlerë prej 72 mijë euro, Deklarata e shitësit E. Sh. e dhënë te avokati S. M., me të cilën ai e vërteton faktin se shtëpinë me oborr në sipërfaqe prej 485 m2 ia ka shitur të akuzuarit , ndërsa qmimin prej 42.500 euro e ka pranuar me dt 22.07.2015 përmes xhirollogarisë pranë bankës B., Autorizimi i H. Sh. në emër të E. Sh. për shitjen e paluajtshmërisë e cila në librat kadastrale ka qenë ende në emër të tij; 3 Fatura të tatimit në pronë për këtë lokacion – rr. J.e R. , të dt. , të triat për objekte “për banim” , për sipërfaqe prej 148 m2 40 m2 dhe 174 m2. Ngastra kadastrale ... , në vendin e quajtur Lubizhdë, në sipërfaqe prej 530 m2, Parakontrata e dt... për shitëblerjen e patundshmërisë në ngastrën kadastrale ... , në vendin e quajtur L., në sipërfaqe prej 530 m2, me një objekt ndërtimor në të , mes të akuzuarit dhe shitësit E.K,e përpiluar te av. B.K.. Qmimi sipas parakontratës është 138 mijë euro, Kontrata për shitëblerjen e patundshmërisë së njejtë, e përpiluar ditën e njejtë ..., te avokati i njejtë, sipas së cilës qmimi është 100 mijë euro. Këtë shumë - 100 mijë i akuzuari e ka paguar atë të njejtën ditë përmes B.E. nga llogaria e tij rrjedhëse ... në P – ekstrakti i bankës, Marrëveshja për Kredi- P. C. B.datë .. vlera = 10,000.00 €, Qertifikata nr. 18-25542 e Agjensisë Kadastrale për Komunën e P, e lëshuar me dt. ...; Kopja e planit e dt., Ekstrakti nga librat afariste të KEDS-it, Marrëveshja e huasë –F. datë ... vlera = 30,000.00 €. Marrëveshja kreditore për kredi biznesi nr. ...B.E. datë .. vlera = 20,000.00 €; Lokalet nga “L.” në sipërfaqe prej 266 m2, Kontrata e dt ... mes të akuzuarit dhe pronarit të biznesit “L.” BP , dëshmitarin D.H për blerjen e lokaleve në sipërfaqe prej 266 m2 për qmimin prej 162. 690 euro njëni dhe 86 mijë euro tjetri; Marrëveshja kreditore në B. E. të dt.... vlera = 100,000.00 €. Ekstrakti nga B.E. - me dt. ... nga xhirollogaria e biznesit – kafiterisë “U “ i akuzuari e ka transferuar shumë prej 100 mijë euro në llogari të biznesit “L.”, me dedikim “transfer për blerjen e lokaleve”. Shenime me dorë - data(viti nuk është shënuar, supozohet se është 2012, dy ditë pas pagesës përmes bankës) “janë dhënë 100 mijë dhe është dorëzuar A.në vlerë 35 mijë €, dmth vlera totale kaparë është dhënë 135 mijë €....marrëveshja është bërë që metri katror ka vlerën 2600 €....kaparë i është dhënë 135 mijë , krediti 400 mijë, dmth 48 muaj nga 10.500 € fillon nga 1 Tetor . Pagesa tjetër e mbetur deri në 31 Dhjetor 2012. “ (Nënshkrimet e D.H., të akuzuarit dhe 4 personave tjerë), Shenimet me dorë në një fletore – janë të shënuara shumat prej 10,500 euro të cilat ia ka paguar D.H.rregullisht, çdo ditë të parë të muajit, (secila pagesë e vërtetuar me nënshkrimet e tyre) duke filluar nga dt. ..., (rreth një muaj pas lidhjes së marrëveshjes) deri me Dy javë më vonë, me dëshmitarin D.H ia ka dhënë edhe 5000 euro.Shenimi me dorë - “sot me dt. D.H ka marrë përmes B. E.100 mijë €, pastaj “sot me dt. ... janë marrë 10 mijë €, janë mbetë 31 mijë “ dhe në fund “ sot me ... 20 mijë €, janë mbetë edhe 11 mijë deri fund të 260 mijë “;Deklarata e dt. ... e D.H., te av E.G , Marrëveshja për kredi e dt. ... në vlerë prej 250 mijë € (në dy pjesë , pjesa e parë vlera = 100,000.00 € dhe pjesa e dytë 150,000.00 € B. K. T., Ekstrakti nga B.K. Tr. - Transaksioni i datës ... nga llogaria bankare e DPH “U.” është transferuar shuma prej 248,750.00 € në llogarinë bankare me nr. të D. H. me përshkrimin “Bartja e mjeteve sipas deklaratës për shitëblerje të datës ..., Marrëveshje e shkruar me dorë ,

me dt. ... në 11:30 h , “ në mes D.H.dhe H.Pt – sot pasi morrem kreditin në B.BKT, 248 mijë € dhe i morrëm paret , i murr D.H, pas tërheqjes D.mi dha paret e pagesave qe kemi bo pagesat kesh fatura dhe paret i pranova krejt në rregull dhe jemi barazu me borxh, krejt jemi rregull me pagesë...” Kjo është dëshim se iakuzuari e ka marr kredin vetëm me qëllim te shpërlarjes së parave të cilat në të vërtet kanë qenë të paguara në tërësi; Kontrata e dt. ... mbi shitjen e lokalit afarist nga 152 m2 – qmimi 182.400 € Shenimi i shkruar me dorë me dt., i nënshkruar nga i akuzuari dhe nga përfaqesuesi i biznesit L.D. H., “H.Pka ble lokal afarist në objektin afarist banesor L. në lagjen A. , blerja është gjithsej 260 m2, lokal afarist, në fillim të ndërtimit janë ble 100 m2 lokal – viti 2012 , vlera blerëse aty re ishte 100 mijë , pjesa tjetër është ble në vitin 2015 , pjesa për 8 m2 është kontestuese, në total janë ble 252 m2”; Kontrata e shitëblerjes mes të akuzuarit dhe biznesit “L.” të cilin e përfaqson D.H,e përpiluar dhe vërtetuar te noteri A. B , me dt. për blerjen e lokaleve në sipërfaqe prej 266 m2 me qmimin prej 248,750.00 € , të paguar 3 vite më parë përmes transferit bankar, Lokalin prej 92 m2 i akuzuari ia ka falë N. P sipas kontratës të dt ... të përpiluar te noterja A. M. , Lokalet i lëshon me qira, Marrëveshja për kredi B.K. T. datë vlera = 70,000.00 €, Marrëveshja për kredi në dy pjesë B. K. T. (pjesa e parë 77,500.00 € dhe pjesa e dytë 77,500.00 €. Ekstrakte nga gjithsej 11 xhirollogarve bankare të akuzuarit dhe bizneseve – U. dhe B: B.K.T– I akuzuari dhe 2 xhirollogari të biznesit U., P.C.B- U., O.B, H.P, B. E. - U. , 2 xhirollogari të H.P (rrjedhëse dhe e kursimeve), R.B– O B, NLB B. – O B. Kontrata për shitëblerjen e automjeteve nga A. M., me dt ... në emër të U.P, “R. M”, viti i prodhimit ..., të cilën djali i të pandehurit U. P e ka blere me dt.... për 22,500 mijë €, Libreza e qarkullimit në emër të tij, Kontrata për sig U,n K.; Kontrata mbi shitëblerjen e automjetit “A., viti i prodhimit 2018 nga Auto S. A., me dt në emër të H.P, qmimi 116 mijë €, Libreza e qarkullimit për “A.”, me targa ... i regjistruar në emër të të akuzuarit,Fatura e Autosallonit për shumën prej 21 mijë të cilën e ka paguar menjëherë , ndërsa për shumën prej 95 mijë ka pasur afatin deri në shtator; Libreza e qarkullimit për veturën “L. R”, me targa , ngjyrë të kaltërt, i vitit 2018, i regjistruar në emër të djalit tjetër të të pandehurit, F. P, Libreza e qarkullimit për veturën G,T , me targa ..., viti i prodhimit vitit 2016 i regjistruar në emër të të akuzuarit, Libreza e qarkullimit për veturën G , me targa..., i vitit 2009 i regjistruar në emër të të akuzuarit, Autorizime te noterja A.M për këtë veturë, në emër të U P, dhe punëtorëve të të akuzuarit - M.Q, E.B, R.T, Libreza e qarkullimit për veturën Mercedes me targa, viti i prodhimit 2019 , i regjistruar në emër të A. P., Libreza e qarkullimit për veturën “G”, ngjyrë të zezë, me targa ... viti i prodhimit 2015, në emër të M.M,Autorizimi i dt. ...me të cilin M. M ia jep U. P të gjitha drejtat pronësore në lidhje me veturën -ta vozisë në Kosovë dhe jasht vendit, ta bëj regjistrimin, “transferin” dhe qllajmërimin Fatura për këtë veturë nga “E.automobilat “ nr. .. e dt. ... në emër të M. M., Libreza e qarkullimit për veturën e tipit “S”, me ngjyrë të zezë, me targa ... viti i prodhimit 2014, e regjistruar në emër të djalit të të pandehurit , U. P; Parashtrësata e dt.... dhe dt... nga mbrojtësit e të akuzuarit H.P, Vendimi me nr..... dhe Dosja nr..... - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në P me nr.P.nr.2005/16 të dt.14.06.2018; Raportit Specialistik të dt.... nga Dr.H.S.; Fotot nga Faltorja; R.. (vendimi) nr.... i dt.... dhe Përgjigja e dhënë nga Inspektorati Policor me nr.të dt....; Espertiza e ekspertit financiar R.Fe dt....

Provat e parashtruara nga mbrojtësit e të pandehurit të parashtruara përmes parashtrësës e datës 21.10 2022 dhe 28.10.2022 siç janë: Certifikatë e regjistrimit dt. ... nr. biznesi ... O B, Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës datë ..., veprimtaritë primarë (rregullimi i aktiviteteve të subjekteve, qe ofrojnë shërbime shëndetësore, arsimore dhe kulturore), Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës informata mbi biznesin të datë ..., Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore-Çertifikatë dt. ... nr. personal biznesi ..., njësi kadastrale P-... P (Hipotekë),Provë e shkruar me dore e dt. .. “ju shërojmë paralizën, distrofijen, epilepsinë, gratë sterile, bashkim, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore-Çertifikatë dt. ... nr. personal biznesi ..., njësi kadastrale P-.. P (Hipotekë) (vërejtje: prova nr.5 është e njëjte me provën nr.8, vetëm data ndryshon), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore-Çertifikatë dt. .. nr. personal biznesi .., njësi kadastrale P-... P (Hipotekë), Marrëveshje hipotekare mbi pasurinë e paluajtshme në mes te B. E. dhe DPH “U,” e dt. ..., Marrëveshje mbi pengun ne mes te B. E. dhe DPH U, e dt. ..., NLB P. P flete deponim e dt. ..vlera 20.000.00 euro (lidhur me token e M.dhe K. R.), NLB P. P flete deponim e dt.. vlera 25.000.00 euro(lidhur me token e M. dhe K. R.), BKT DPH U, – bartja e mjeteve sipas deklaratës per shitblerje e dt. . vlera 248.750.00 euro, Kopja e planit – kuvendi

komunal drejtoria per gjeodezi dhe kadastër me nr... e dt. .. P nr. ngastrës ..., Aneks kontrate mbi qiranë, qiradhënësi H.P qiramarrës R. R. e dt. .. për lokalin 117m2, shuma 1.000 euro, Para kontratë mbi shitblerjen e paluajtshmerise te dt. .. P shitës R. K., S. K.dhe Sh. K., blerësi H. P, BKT kthim borxhi i dt. .. nga H.P tek S. K., Kopja e planit – kuvendi komunal drejtoria për gjeodezi dhe kadastër me nr. ..e dt. ..P nr. ngastrës .., Kopja e planit – kuvendi komunal drejtoria per gjeodezi dhe kadastër me nr. .. e dt. .. P nr. ngastrës .., Kontrate per qiranë e hapësirës afariste e dt..., ne mes te H.Pt qiradhënës dhe NTPSH.SAN – Trade Kompani – P qiramarrës ne vlerën 1,500.00 euro, Aneks kontrate mbi qiranë, qiradhënësi H.Pqiramarrës R. R. e dt. .. për lokalin 117m2, shtohen edhe 60m2 siperfaqe dhe rritet çmimi ne shume 2,800.00 euro, Aktvendim me nr. te lendes/ protokollit .. i dt. .. për bartjen e pronësisë nga pronari E. Sh. tek H.P, Aktvendim me nr te lendes/ protokollit .. i dt. .. për bartjen e pronësisë nga pronari M. M.tek H.P, Deklarate e shkruar me dore e dt..., Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore-Çertifikatë dt. .. nr. personal biznesi, pronë e paluajtshme .., Deklarate e shkruar me dore me dt. ... për shumat 10.000 euro, 45.000 euro dhe 5.000 euro, Deklarate e shkruar me dore me dt. ...ne mes te blerësit H.P dhe shitësit E. Sh., Deklaratë e shkruar me dore me dt... H.P ka huazuar para ne shumen prej 11.000 euro nga E. M., Deklaratë e shkruar me dore me dt. ... H.P ka huazuar para ne shumen prej 9.000 euro nga M.Q Kontrate mbi qiranë i dt... ne mes te qiradhënësit H.P dhe qiramarrës R. R. ne shumen prej 2200 euro, Deklarate nga E.Sh. shitës dhe blerësi H.P, per shtëpinë me oborr me sipërfaqe 485m2 ne shume prej 42.500 euro, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore-Çertifikatë dt. .. nr. personal biznesi ... Çertifikate e dt. ..., komuna P. njësia kadastrale P-... komuna peje vendi i quajtur K. (hipoteke), njësia kadastrale P-... komuna P vendi i quajtur A.(hipoteke), njësia kadastrale O-... vendi i quajtur P, Çertifikate e dt. .. komuna Prishtine, njesa kadastrale P-... vendi i quajtur K.- V.(hipoteke), Gjendja e llogarisë rrjedhëse ne r.bank per periudhën ... O B, Kontrate e datës ..., shitës ‘‘Auto M.’’ SH.P.K dhe blerës U.P (djali i Ht), Kontrate mbi hipotekë te datës ... ne mes te bankës BKT-Kredidhënëse dhe D.P.H U, kredimarrësi për paluajtshmerine e evidentuar me nr. te ngastrës kadastrale P-..., shuma e kredisë 250.000.00 euro, Kontrate mbi hipotekën te dt.. ne mes te B. për B. Sh.a kredidhënësi dhe H.P kredimarrës për paluejtshmerine e evidentuar me nr te ngastrës kadastrale P-..., shuma e kredisë 319.800.00 euro, Kontrate mbi hipoteke te dt. .. ne mes te BKT dega ne P. kredidhenesi dhe D.P.H ‘‘U,’’ kredimarrës, për paluajtshmerine e evidentuar me nr. te ngastrës kadastrale P-... shuma e kredisë 250.000.00 euro, Pasqyre bankare ne P.C.B per periudhën .. e H.P, Kontrate për shitblerjen e automjetit e dt. .. veturën R. M. me nr. të shasisë .., shuma totale 22.500.00 euro në mes te shitësit auto ‘‘M.’’ Sh.P.K dhe blerës U P, Urdhërpagesë – urdhërtransfere nga V.t A. ndërmarrja ndërtimore, përfitues .. euro, i dt. ..., Përgjigje e dt... nga BKT ne urdhëresën e gjykatës lidhur me kreditë e marra nga biznesi D.P.H ‘‘U’’, NLB Bank, qarkullim për llogari ne periudhën ne llogarinë bankare O ‘‘B’’, NLB Bank, qarkullim për llogari ne periudhën ne llogarinë bankare O ‘‘B’’, Deklarate-marrëveshje me shkrim e dt. .. lidhur me shumen e parave te huazuara ne vlere prej 95.000.00 euro, Deklarate marreveshje me shkrim e dt. ..., H.Pi ka marre hua mirsad Q.shumen prej 9.000.euro, Deklarate marreveshje me shkrim e dt. .., H.P i ka marre hua E. M. shumen prej 11.000 euro, Qarkullim i padeklaruar nga viti 2013 deri me 2018 Departamenti i Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës.

Të gjitha këto prova gjykata i ka vlerësuar si prova të pranueshme dhe se i ka administruar si të tilla.

Provat personale: I dëmtuari-dëshmitari R.L në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës .. ka deklaruar se: në Sh. doli fjala se H.P shëron të sëmurit nga magjia dhe epilepsia, për të cilin ka dëgjuar prej njerëzve, Face Bookut dhe në emisionin Z. e L., të A. Ç., pasi që vetë është i sëmur me epilepsi nervore, kur ka ardh tek H me dt..., ka qenë i sëmurë i cili i ka thënë se ti do të mbash një dry me çelës, 3 copa vezë, dhe 4 ose 6 qirinj të bardhë. Ka shkuar direkt në P tek shtëpia ku e kishte, ka parë shumë njerëz duke pritur, edhe kishte badigardat e vetë, brenda ka hyrë vetë me vëllain dhe motrën V., e njëjta ka qenë me ta sepse ka qenë i sëmurë dhe kam pas nevojë për asistencë. Tutje i njëjti ka theksuar se B i ka pyetur për çfarë arsye keni ardhur, të njëjtit janë përgjigjur, se kanë shkuar për problemin e vëllait, për sëmundjen e epilepsisë nervore, dhe H ju ka thënë se unë do të shëroje edhe më ka shkruar terapinë, ia ka dhënë kartën që sa herë të shkoj te ai të shkoj me atë kartën. Pastaj ka ardhur edhe 2 herë tjera, por ne momentin e parë që kam qenë me vëllain dhe motrën, i njëjtit vetë atij ia ka kërkuar 1000 euro, e vetë ai nuk i kishte fare, por i ka gjetur borxh tek farefisi i tij, tash është i sëmur, nuk mundë të punojë, sepse e kap epilepsia

nervore. Me tej thekson se ia ka dhënë një kopje të kuranit, dhe një kartëvizite me terapinë si më lartë, të cilën i ka thënë se si ta përdor, se do të mbash një dry me çelës, 3 copa vezë, dhe 4 ose 6 qirinj të bardhë, dhe i ka thënë me i marr këto me veti sa herë të shkoj. Ditën e parë kur ka shkuar vetëm ka dëgjuar çka ka thënë, sepse ka qenë i sëmurë, vetëm 5 minuta ka qenë brenda dhe ia ka shënuar te cekurat si me lartë dhe për 1 vite ose 2 vite i ka premtuar që ketë sëmundje do ta largoj, vetë ai prapë është në atë gjendje siç ka qenë, dhe nuk është shëruar. Tutje i njëjti ka shtuar se e ndjej vetën të mashtruar, dhe nuk ka pasur asnjë përmirësim prej atëhershmit. Me tej i njëjti shton se nuk ka qenë në Prokuroi Themelore në P, mirëpo ka biseduar me prokurorin P.K. përmes internetit, të njëjtit i ka treguar që H.P e ka mashtruar. Në pyetje të parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit. Ju deklaruat se keni qenë te B, a e ka kënduar naj dovë? I njëjti është përgjigjur se asgjë nuk ka përmend, veç ma ka qit terapinë që e ceka më lartë. Po ashtu në vizitën e bërë nuk më ka dhënë barna, nuk kam marrë asnjë këshillë mjekësore, por vetëm këto që i përmenda si me lartë, dhe se 1.000 euro mi ka kërkuar. Me tej ka theksuar se ka besuar te B deri në momentin kur ia ka mbyll telefonin, se mund të shërohem nga ato gjëra, pastaj është bindur te emisioni Z. e L., që është mashtrues, dhe arsyeja se ka besuar ka qenë edhe si mjekë, edhe si besuës në zotë. Pas premtimit se brenda 1 vit e gjysmë 2 vite se do te shërohem e kam pritë 2 vite fikse dhe gjendja ime ka qenë edhe me keq. Pra si përfundim ka qenë 3 herë te B, herën e parë ka qenë në ... personalisht bashkë me vëllain dhe motrën, hera e dytë që ka qenë në fund të .., herën e 3 kur ka qenë në Janar të 2019, dhe s'ka shkuar më asnjëherë, sepse kur ka shkuar ka qenë i bindur që është shërues, dhe i ka premtuar që do ta heqi këtë sëmundje, dhe në fund deklaroi se parashtron kërkesë pasurore juridike.

E dëmtuara-dëshmitarja Z.M në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës ... ka deklaruar se: ka pasur kontakte me H.P pas një ndodhie në familje, të djalit dhe nuses të cilët pas 3 viteve nuk shkonin mirë, dhe donin me u nda jam mundu me bo çdo gjë që mos me u nda ai qift. Pasi që e kisha vetëm një djalë të hasretit, kam parë në televizionet shqiptare, e kam kërkuar nga rrethi se nëse e njef dikën se ku muj me shku , rrethi me ka propozuar me shku te H mundet mem ndihmu, e kam bindur edhe burrin që duhet me shku që mso të na ndahen, kam shkuar, kam pritur gjatë, sa e mbaj mend ka qenë .., paradite, pas një pritje të gjatë kam hyrë brenda, më ka pritur B. Me tej e njëjta thekson para se me hy e kam dorzu letërnjoftimin e Z.dhe ata më kanë marr letërnjoftimin dhe e kanë mbajit derisa kam dalë jashtë, pastaj na kanë thirr sipas radhës me hy brenda. Kur ka hyrë brenda H e ka pyetur për çka keni ardhë, ia ka treguar hallin pse është shkuar, i ka treguar, për me qelë dosjen tënde më ka thënë se duhet me pagur dikun rreth 30-40 euro, dhe me ja dha shënimet personale, kush jam, prej nga vi, ku punoj, jetoi, a jam e martuar, masanej i ka thënë se kur e ka qelë dosjen i ka thënë se kjo kushton shtrejtë por puna ka me u rregullu, dhe i ka thënë pse ju të jashtit që vini prej Z. është marre me ardhë pa 20 mijë euro këtu, dhe i ka thënë se duhet me i paguar 2.000 euro, nëse don që djali dhe nusja me qenë bashke gjithmonë, dhe tash një vite do të vin me bebe të tyre pas një viti. Me vete kishte marr vetëm 100 euro, dhe e kisha burrin jashtë tu më prit, më ka thënë se qoftëse s'ke me veti ka banka ku mundesh me i nxjerr, para se me dal te burri përjashta më ka thënë ktheve te do televizione të vogla me kqyrë ato gjërat, dhe pas atij momenti edhe me mijra franga me pas ja kisha dhanë se ashtu jam ndjerë. Ne ato ekrane ka pa njerëz si unë që kanë shkuar me kërkuar ndihmë. Me tej e njëjta thekson arsyeja ka qenë se vetë nuk e di pse është ndjerë ashtu, që me pas pare krejt ja kisha dhon, në ato ekrane kam parë një vajzë të sëmur me të meta, por nuk është fokusuar shumë me kqyr, dhe njerëz tjerë, nuk është koncentruar shumë me këqyr sepse ka humbur në ato momente. Masa ndej ka dalë jashtë me fol me burrin, sepse z. P i ka thanë se nuk muj me shkru hajmalinë pa me i dhanë paret. Është dalë te burri dhe ka insistu me mi dha paret burri sepse skam deshtë me mu nda djali prej nuses, është kthyer brenda ia ka dhanë 1.000 euro, dhe me i ka thënë me shkuar pas 2 ditësh me i marr Hajmaliat e gatshme dhe disa rituale tjera, me dryna, me qiri, me vezë, me dal me i ble dhe me i pru tek H. Vetë ajo kështu ka vepruar, pas 2 ditësh është kthyer me i marr, ka hyrë brenda me procedurat e radhës, edhe ia ka paguar edhe 1000 euro të tjera, ia ka dhënë Hajmalit, e ka pyetur me kanë është, i ka thënë jam me burrin, tha le te vije edhe burri brenda, ka ardhë edhe burri brenda, H tha se paski edhe ju probleme do të ja shkruj edhe një hajmali edhe juve pa pagesë. Janë përshëndetur, ka qenë shumë e lumtur që ato dy kanë me qenë mirë. Ka shkuar drejt në P. dhe ia ka dhënë nuses Hajmalit, pasi që ka pasur me udhëtuat për Zvicrën. Mirëpo kur janë kthyer në Z. djali edhe nusja janë ndarë. Ka qenë një zhgënjim i madhe për mua, dhe në atë kohë ka qenë në trajtim me kancer, dhe e ka përjetuar rëndë. Më herët tha z.P se nuk ka pas ankesa prej njerëzve që kanë qenë tek unë. Vetë ajo disa herë ka telefonuar H. por djali i tij është përgjigjur, mos thirr në ketë numër, dhe mos me pengo më, dhe ma s'ka tentuar me thirr. Kur kam ardhur në pushim ka shkuar me bo padinë dhe tash e pres drejtësinë e Kosovës. Me tej e njëjta thekson se pasi

që kam hyrë brenda, H i ka premtuar me jetë se ky problem ka me u zgjidhë, të njëjtën e ka bind që ka me kry punë, se ka me u ndreq nusja me djalin. E njëjta ka shtuar se B në prezencë te saj nuk ka bërë lutje, ndërsa fshehtë saj nuk e di se nuk e ka pa pas shpinës, nuk e di çfarë ka bërë mbrapa, ndërsa këshilla sociale dhe analiza nuk i ka kërkuar. E njëjta ka pritur 3-4 ore, sepse kapasur shumë njerëz-vizitor, në një oborr dhe një sallë para hyrjes, ajo sallë ka qenë me kamera ka pasur shumë ekrane, dhe e ka pa një rast, por ka qenë e shqetësuar. E si përfundim e njëjta ka theksuar se ka shkuar në P pas zhgënjimit që e ka pasur, ka insistuar me dha këtë deklaratë, se është ndier e dëmtuar moralisht dhe materialisht. Sepse kur i ka thënë mos u kthe mbrapa, nuk e ka parë se i ka thanë përnjëherë kthehu përpara, vetë ajo s'ka vërejtë që ka bërë naj veprim në raport me vetë atë, që e ka bindur me i dhanë shumë të madhe të parave, por e njëjta dyshon që e ka hipnotizuar dhe në fund deklaroi se parashtroi kërkesë pasurore juridike.

I dëmtuari-dëshmitari D.Z në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës ... ka deklaruar se: ka pas kontakt me hyseriun kur është shkuar për tu vizituar për herë ta parë në shtëpinë e tij, para 7 vite, vetë ai ka shkuar sepse ka dëgjuar si të gjithë tjerët. Nëse dikush ka ndonjë problem në familje, ka menduar se do te gjej një zgjidhje për problemin që kishin por fatkeqësisht kanë gjetur zhgënjimi dhe mashtrim. Tutje i njëjti thekson se ka qenë veti ai me bashkëshorten e tij, dhe dy persona tjerë burrë e grua, e të cilët kishin qëllimin e njëjtë për të njëjtin problem. Problemi ka qenë se djali i tij ishte në lidhje me një vajzë, dhe papritmas mes vajzës ndryshon mendimi, dhe refuzon djalin e tij. Si familje, bashke me familjen e vajzës ishin të pajtimit se ata dy persona ta bashkoheshin, kanë dëgjuar se B mundet me ju ndihmu dhe ju kanë drejtuar të njëjtit. Terminin e kanë caktuar përmes telefonit, ka biseduar, me një djalë që ka qenë në shtëpinë e tij, pastaj kanë shkuar në shtëpinë e tij në bazë të terminit kanë pritë 2 orë, ka pas shumë njerëz para tyre dhe pas tyre, para se me hy brenda ka qenë edhe një djalë që ju ka marr letërnjoftimit, me të hyrë brenda i kanë treguar problemin që e kanë. Pasi që kanë hy brenda ia ka marr emrat e personave i ka shënuar, nuk ju ka kërkuar të dhënat personale, vetëm të peronave që ishin të involvuar në rast. Gjënë e parë që ju ka kërkuar ka qenë pagesa prej 1.000 euro, ka vazhduar me ritet e tij, na ka thanë që ta blejmë një dry që të hedhim në ujë, edhe me i dhezë qira për me u lutë për ata persona që të bashkohen, kjo pagesa prej 1.000 euro ka qenë e përbashkët mes neve dhe familjes së vajzës, ju ka caktuar që të shkojmë prapë, është dashtë prapë me thirr në telefon me bo termin, pasi që ka qenë 7 herë, çdo vizitë i kanë paguar 20 euro, për familje, 40 euro i kemi paguar bashke me familjen e vajzës. Me tej i njëjti thekson se vizitat kanë qenë brenda periudhës prej 6 muajve, na ka kërkuar që vajzën ta sjellim nga Zvicra për vizitë tek ky dhe vajza e ka vizituar, na ka kërkuar edhe djali ta vizitoj H, e ka vizituar edhe djalin, çdo vizitë pas shumës prej 1.000 euro, ka qenë në shumë prej 20 euro, për secilën familje, arsyeja pse kanë shkuar si familje, dëshira ka qenë që ti bashkojmë ata të ri, dhe zgjidhjen momentale e kanë menduar te B, në bazë të premtimeve që ky ju ka jep, që do të behën mirë do të bashkohen, prandaj janë detyruar me shku, na ka shtyrë me shku sepse kemi dëgjuar nga njerëzit, e pastaj pasi që janë shkuar premtimet e tij i kanë bindë, që ky problem do të zgjidhet, por sot e asaj dite nuk ndodhi ajo që ata kanë dashtë. Tutje i njëjti shton se në hyrje të objektit ku B punojkë ka qenë një vend me pritë në radhë, ka qenë një TV gjatë gjithë kohës ka pas video, incizimet të tij me çdo lloj njeri e ka pa aty, u përsëritshin disa herë, ka parë gjera duke i ndihmuar, tu u bashku persona, për persona që kanë qenë në depresion, e i cili i ka shëruar ata, aty kanë qenë të paraqitura sukseset e tij. Vetë ai e ka kuptuar që nuk mundet me ju ndihmu, brenda javës e ka kuptuar, por nuk ishin as që tërhiqeshin, mirëpo kanë vendos me vazhduar. Prej B nuk kanë pas garancionë me shkrim, por kanë pas premtim me fjalë se do të rregullohet kjo punë, sa herë që janë shkuar. Nder tjera i njëjti ka shtuar se ju ka shkuar mendja se vajza ka magji dhe kjo është arsye pse ju kanë drejtuar këtij personi, pra ne si familje kurrë asnjëherë në asnjë rast nuk kemi qenë tek te asnjë hoxhë, as priftë, rasti i parë dhe i fundit ka qenë te B, dhe vetë ai si kryefamiljar, pa pare nuk është asnjë herë në gjep, dhe atë ditë i kanë qelluar paret në xhep, dhe prandaj ia ka jap, jo që e ka ditë që i njëjti ka me i lyp ato pare, në shumën prej 1.000 euro, por B mi ka lyp, për çka ka qenë i gatshëm me dha edhe me shumë, nëse do të ju kishte rregulluar punën, por jo me i dhanë para pa kërkuar ky. I njëjti shton se para se me shku nuk i kanë besuar sepse nuk kanë ditë se çka do të ndodhë, vetëm kanë dëgjuar se kryen këtë veprimtari, të cilën sipas njerëzve edhe ndoshta i ndihmon dikujt, pra me veprimtari kuptojmë faktin se i njëjti lutet, jep hajmali, dhe procedurat të cilat nuk i di. Arsyeja pse kanë shkuar te B se kanë besuar dhe premtimi ka qenë se do të rregullohet kjo punë, si orator i suksesshëm me premtimet dhe bindjet e tij gjithmonë i ka bindë që do të bëhet mirë, dhe nuk u rregullu, dhe ka thënë se kam x raste të tilla që kam pas sukses, dhe për ata i kemi besuar, në momentin kur jemi zhgënjyer ka qenë kur ne kemi vepruar në bazë të udhëzimeve të tina dhe pas atyre muajve nuk po shkon kurrëgjë ka përmirësimi, dhe ata dy persona

nuk janë bashkuar kurrë, dhe kurrë se kanë thirr në telefon me ju kthy të holla, ndoshta është mundu me u lute, ama premtimin që e ka dhënë nuk e ka realizuar, dhe në fund deklaroi se parashtron kërkesë pasurore juridike.

E dëmtuara –dëshmitarja H.Sh në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës .. ka deklaruar se: me H.P ka pasur kontakte pasi ka shkuar te shtëpia e tij në P, ka qenë viti 2011-12, ka kërkuar ndihmë nga ai, vetë ajo nuk e ka ditur se kush është ky person, ndërsa motra e kish pa ne një televizion, e ka thirrë në telefon, dhe i ka thënë se filan personi po iu jepte ndihmë njerëzve që kanë probleme në jetë. Vetë ajo i ka thënë se nuk po e njeh po mundem me pyet kush është. Tutje e njëjta shton se me një taxi ka shkuar te shpija e H, ishin disa djem që e kanë orientuar ka me hy, të cilët ne një libër e kanë shënuar emrin, mbiemrin, për caktimin e terminit se kur duhet me shkuar tek B. E njëjta ka shkuar për probleme të motrës dhe për probleme të veta. Motra ka pas problem rreth djalit atëherë, e vetë ajo ka pas probleme me burrë, gjatë asaj kohe. Në kohën kur ka shkuar te H për vetë dhe për motrën saj, për te bërë termin i ka caktuar një shumë prej 20 euro, madje kur ka shkuar në datën e terminit, H e ka pyetur se jetoni këtu apo jetoni jashtë, i ka treguar që motra jeton jashtë. Për motrën i ka caktuar shumën 1000 euro, kinse e shëndoshi djalin, dhe për herën e dytë i njëjti i ka kërkuar 1000 euro, për motrën, e njëjta ia ka dërguar këto pare, motra e ka shit arin për t'ia dërguar H . Ndërsa për vetë atë ia ka caktuar shumën 500 euro, herën e dytë ia ka kërkuar 500 euro. Tutje shton se herën e parë kur kanë shkuar iu ka dhanë ujë, një qiri me dhez. E njëjta nuk e di çfarë uji ka qenë, qiriun e kemi lënë aty, ndërsa ujin ia ka dhënë me veti me marr, në atë ujë nuk e din se çfarë ka pas, i është dukur si i sahrës. Atë ujë e kanë pi, e ka qitë në gjellë, i kanë la sytë, ndërsa për shije ne ujit nuk din se ka kaluar kohë e gjate kurse kur e kanë qite ne gjellë nuk është vërejtur shija, kanë vepruar ashtu siç i ka udhëzuar B. Tutje shton se aty kanë pritë 200-300 vetë dhe ky ka qenë një mashtrim shumë i madhe. Tutje njëjta ka theksuar gjatë vitit 2011-12, saktë nuk i kujtohet në atë periudhë nuk e ka lajmëruar rastin në polici ndërsa me vonë e ka lajmëruar, pas kësaj ngjarje nuk është shkuar asnjëherë te B me i kërkuar parët. Tutje ka theksuar se në bazë të sugjerimeve të motrës kanë kërkuar ndihmë dhe në bazë të ritualeve që kanë besuar e për këtë kanë shkuar. Por tani nuk beson që në bazë të ritualeve të zgjidhen problemet. E njëjta si përfundim ka treguar që nuk ka përmirësim, H ju ka thënë hajdeni prapë dhe bini edhe 500 euro tjera, por ka biseduar me motrën dhe kanë vendos më mos me shku. Tutje shton se ka menduar që po shkon tek një person fetar, i cili përmes hajmalive të shëron, e lidhur me shumën e kërkuara nuk iu ka dhënë fatura-letër, ndërsa në dhomën që ia ka dhen parat nuk e din nëse i ka shënuar najkund. E njëjta thekson se fillimisht 20 euro, iu ka dhanë të ata djemtë jashtë, kurse shumën e madhe i ka dha brenda te B, një herë ka qenë bashkë me motrën, ndërsa herën tjetër ka qenë vetëm. Kur është hy te B i njëjti ju ka premtuar se do të ju ndihmoj dhe do të bëhet mirë për ty dhe motrën, dhe ato kanë shpresuar që po i ndihmon, që djali ka me u shëruar dhe punët kanë mu ndreq. E gjitha kjo ka ndodhë duke besuar që me n' dojë maxhi do ti ndihmon. Ato nuk e kanë ditë se a është mjek apo çka është, por nuk është mirë me i mashtruar njerëzit, dhe ndjehet e mashtruar, dhe në fund deklaroi se parashtron kërkesë pasurore juridike.

I dëmtuari –dëshmitari M.B në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës ... ka deklaruar se: ka qenë te B se ka qenë paqejf diçka dhe ka shkuar me fëmijë te shpija e tij në P, vetë ai nuk e njeh B, përveç aty kur është shkuar, se ka pas dhimbje të kokës, ka menduar që i kanë bërë sehire. Tutje thekson se kur ka shkuar të B e ka stërpik me do ujëra. Aty kur është shkuar ia ka dhanë 300-400 euro, dhe ka qenë veç një herë, dhe nuk i ka ndihmuar kurrëgjë. E për këtë e ka lajmëruar rastin në Prokurori. Kjo ngjarje ka ndodhur 3-4 vjet nuk e din saktë, ndërsa lidhur me vesveset H i ka thënë që e ki prej sehireve. I njëjti ka shtuar se i ka shkaktuar dëm në shumë prej 5000-6000 euro, se është sëmur edhe me shumë pas këtij rasti dhe kërkon që ti kthehet dëmi i shkaktuar, dhe në fund deklaroi se parashtron kërkesë pasurore juridike.

I dëmtuari –dëshmitari F.S në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës ... ka deklaruar se: ka qenë te B në vitin .. dhe arsyeja pse ka shkuar ka qenë me kërkuar ndihmë, për shëndet, nuk i ka propozuar askush për te shkuar, mirëpo vet ai ka shkuar, e ka gjetë në internet. Te H në P, është shkuar me një dhëndër, iu kanë dhanë numra me prit në rend, aty i ka paguar 20 euro në fillim, pastaj kanë hy brenda te B, ia ka bo një kontroll, me do ujë, me njëfarë flake, më ka premtuar që mundet me ndihmuar, dhe i ka thënë mos shko tjetër kund, masë një (1) jave ka shkuar e ka marr një Hajmali, e cila i ka kushtuar 300 euro. Pas një kohe prapë se ka ndi veten mirë, është shkuar prapë, i ka thënë se duhet një hajmali e madhe për krejt shtëpinë, ajo i ka kushtuar 1.200 euro. Tutje shton se ia ka dha do dryna, do ujë mu pastru, do vezë me i

shti në zjermë, dhe do letra mi gju nëpër rrugëkryqe. I njëjti ka qenë prapë edhe 3-4 herë, dhe i ka thënë se nuk ka përmirësim, me pastaj ka vazhduar te mejku se gjendja i është keqësuar. Herën e fundit në vitin 2017, B. i ka treguar që nuk është mirë, dhe prapë i ka dhënë ujë me u pastruar, ndërsa pare më nuk i ka marr. Me tej i njëjti shton se ka qenë edhe të disa falltore që shkrin plumb, ndërsa për B. ka menduar që ka me ndihmu më shumë, pasi që B. përmes ritualeve ka më e shëruar kështu ka besuar. E si përfundim ka theksuar se nuk e ka lajmëruar rastin në vitin 2017, sepse atëherë nuk ka qenë mirë. Lidhur për parat që nuk ia ka kërkuar është tut me shku se ka menduar që po i benë najë send po ashtu nuk i ka dhënë letër për paratë që ia ka dhënë, dhe në fund deklaroi se parashtron kërkesë pasurore juridike.

I dëmtuari –dëshmitari B.K., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës ..ka deklaruar se: te B ka shkuar sepse janë 7 vëllezër, 6 vëllezër i kishte në Gj., dhe vetë ai jeton në K., dëshire e tij ishte me dal jashtë shteti po ashtu kisha qejf me u feju, dhe me i hec biznesi mbarë. Ka shkuar te B në P, te shtëpia e tij, letërnjoftimin ia ka marrë punëtori i tij e ka njoftur se duhet me pritë në rend, ka qenë nr.... Ka pritë në radhë deri në ora 2, ka shkuar në ora 11, ka hyrë brenda, i'a ka kërkuar 20 euro për vizitë, i ka thënë s'ka problem. Më pastaj hini me do flaka, do qikiqa, me qira dhe me thojke mos livrit, dhe ki të bame prej grusë së axhës. E gruja axhës që 22 vjet është e vranë në luftë. Vetë ai e ka njoftuar se nuk ka grue tjetër të axhës, jo tha ke më afër, i tregova e kam një plakë kojshike, më ka pyete se a po gjen vezë nëpër oborr, i ka thanë po se po bajnë pulat e kojshive. I njëjti thekson se i ka thënë se je kopil, dhe nuk jeni vëllezër me ata në Gj., dhe baba t'ka marr tjetër kun, ndërsa i ka mbledhur vllazënin dhe i ka pyete se a është vërtet, pasi kjo i është bërë vesvese. B. ia ka kërkuar 2.500 euro, me i hec biznesi mare, dhe fejesa me ju bo, i ka rekomanduar me shku me marr do dhe të varreve, qaj njeri që të vdes i pari në X. Dhe vdiq në kry të javës njani dhe i tregova në telefon B. E mora dheun e varreve dhe 2.500 euro, 5 copa ka 500 euro dhe shkova te B, ma dha një dry të vogël me qel dhe me gju në ujë, tha dheun mbaje në firmë, derisa të vjen ëndrra, dhe andrra s'ka ardhë kurrë dhe vetë ai ka shkuar B dhe i ka tha se kjo punë s'po hecë hiq, i thash kthemi paret, ka thanë me zor nuk te kam shti me ardhë këtu. I njëjti ka shtuar se në vizitën e parë çmimi ka qenë 20 euro por vetë ai, ia ka dhanë 50 euro, me shpresë që po bahet mirë. Unë betohem para zotit se jam kam dhanë 2.500 euro. Ka deshtë me ia dhanë 3000 mijë. Ama ai më ka thanë se 2.500 euro, është çmimi. Në ditën e parë më ka tha se jam kopil, dhe unë e kam pyetur nënën. Me fjalët e tij ka pas problem me vëllain, më ka thënë se qysh të mashtroj ky njeri. Me tej i njëjti thekson se nuk i ka besuar por ka qenë insistim i shokut të tij, dhe i ka thënë se nëse na kryen punë do ti jap edhe 10 mijë euro, edhe pse nuk i ka besuar vetë ai e ka provuar fatin, se ndoshta bohet mirë. I njëjti nuk ka provuar te shkoj te ndonjë mjek tjetër popullor, ose hoxhë tjetër, është hera parë që ka qenë të B, arsya që ka shkuar ka qenë që përmes ritualëve të tija, mundet me ndiku në jetën tij, pasi që brenda 30 dite i ka thënë B se keni me marr vajzën me letra, me pasuri të pafundme. Me tej shton se kur i ka paguar shumën prej 2.550 euro, nuk i ka dhënë asgjë, dhe në fund deklaroi se parashtron kërkesë pasurore juridike.

Ekspertin financiar R.F në seancën shqyrtimit gjyqësor të datës dhe .. ka deklaruar se, Gjatë hartimit të ekspertizës kam dhënë konstatimin tim në bazë të fakteve dhe provave të kërkoj të dhëna shtesë nga disa institucione shtetërore, banka, si dhe institucione mikro-financiare në Kosovë të cilat i kam cekur në ekspertizën. Vetë ai ka vlerësuar se shkresat në lëndë janë të bollshme dhe se sa i përket rregullave dhe legjislacionit financiar nuk kam patur nevojë të konsultohem apo te kërkoj informacione shtesë as nga prokuroria, as nga gjykata dhe as nga pala e dëmtuar. Andaj i tërë pasuri të cilën e kam cekur në ekspertizë është nga i dorëzuar palëve me dt. dhe nuk mund ta ndryshohet sepse kështu theksohet në këtë Raport Hetues. Po ashtu NPH do të thotë Ndërmarrje Private Hoteliere. Në faqen 9 të ekspertizës, është përshkruar në detaje i tërë regjistrimi i këtij biznesi DPH "U," i cili sipas te dhënave zyrtare në ARBK figuron se përfaqësues i autorizuar dhe pronarë i këtij biznesi është H.P, ndërsa, në faqe 48 të ekspertizës me dt., H.Pnë Prokurorinë Themelore në P ka deklaruar se biznesi DPH "U," të cilin e ka regjistruar në vitin 2008 është një lokal i vogël i hapur në oborrin e shtëpisë i cili ka shërbyer vetëm për ti pritur klientët deri sa të ju vije radha dhe se përveç ndonjë qaj ose lëngë nuk ka pasur punë tjetër. Hartimi i ekspertizës të cilën e kam hartuar, nuk e ka për qellim që eksperti të konstatoj se H.P, a ka bërë shkelje tatimore apo jo, vetëm kam bërë një analizë Raportit Final Hetues të Departamentit të ATK-së, që domethënë qëllimi dhe objektivi nuk është që të nxirren të dhëna të tjera lidhur me afarizmin e këtij biznesi. Duke filluar që nga faqja 5 dhe 6 eksperti i ka nxjerrë të dhënat nga Raporti Final i Departamentit të Hetimit të ATK-së kurse të gjitha konstatimet që janë dhënë tek pika e parë te sqarimi i ekspertit janë të dhëna të cilat i ka theksuar Departamenti i Hetimeve i ATK-së në Raportin Final, kurse sa i përket

tarifave e theksoj edhe njëherë procesverbalin në marrjen në pyetje të pandehurin H.P në Prokurorinë Themelore në P me dt. ..., i cili deklaroi se tarifa e tij për klient ka qenë 10, 20 dhe 30 euro. Tutje ka theksuar te dhëna janë nxjerrë nga raporti final i DHTI të ATK-së dhe në vazhdim në faqen 6 dhe 7 të ekspertizës janë të sqaruara pra shkresat janë nga Regjistri i Bizneseve të regjistruara në ARBK. Me tej ka theksuar se fillimisht pse e ka shkruar patundshmëri- paluejshmëri, sepse kështu janë edhe disa kontrata dhe nuk e kam ndryshuar titullin e kontratës, diku ka qenë patundshmëri, diku paluejshmëri, kurse blerjet i kam nxjerrë unë, në fund në faqen 52 e kemi rekapitulacionin i cili tregon gjithçka mbi vlerën e të gjitha këtyre paluejshmëri dhe të tjerave, në rekapitulacion janë të gjitha shumat e të gjitha blerjeve të patundshmërive, blerjeve të automjeteve, lartësinë e kthimit të kredive, lartësinë e mjeteve të pranuar nga M.si dhe mjetet e pranuar nga W. U. Po ashtu janë dhënë sçarime për kontratë interne pra të gjitha sqarimet lidhur me këtë kontratë apo marrëveshje mbi ndarjen e pasurisë në mes të të ndjerit babës së B. P dhe të tjerëve, sqarim pika 8 në faqen 12, dhe 13, të ekspertizës. Po ashtu në shkresat e lëndës ekziston pasqyra e të gjitha transfereve të cilat i janë dërguar në W.. U. të H.P dhe familjareve të tjerë, duke filluar nga data .. e përfundimisht me dt. ..., në emër të H.P janë gjithsej 161 transaksione, në shumë prej 145.076.36 euro. Ndërsa për M. në faqen 51 të ekspertizës, këto të dhëna janë nxjerrë nga Raporti Final Hetues i Departamentit për Hetime Tatimore. Pra në faqen 5 të ekspertizës janë saktë të definuara pranimet nga M. të gjetura dhe të konstatuara në Raportin Final të DHTI-së të ATK-së, për periudhën 2013-2018, kjo ka shumë dallim sepse që në fillim të ekspertizës kam hartuar duke u bazuar në rregullat dhe legjislacionin financiar sepse transferet e pranuar nga W. U., DHTI-së të ATK-së, nuk i ka përfshirë si të hyra, i ka përfshirë vetëm të M. dhe kjo ka qenë arsyeja pse e kam vizituar W.U., e nuk e kam vizituar M.. Në faqen 7 të ekspertizës, e kam dhënë të qartë arsyetimin e transfereve nga Moneygram, se këto të hyra të cilat ekzistojnë në Raportin Final Hetues të DHTI-së të ATK-së, inspektorët e lartë përmendur këto të hyra i kanë nxjerrë nga një fletore të cilën e ka udhëhequr me dorë H.P. Ky raport ekziston në shkresat e lëndës mirëpo ekziston moneta që ju ka përgjigjur Gjykatës Themelore në P, andaj ia fali besimin raportit të DHTI-së të ATK-së, të cilët qartë e kanë sqaruar se gjatë vitit 2013-2018 në fletoren e udhëhequr me dorë nga H.P nga Moneygram ka pasur hyrje 60.913.00 për të cilat gjithnjë po flas sipas Raportit Hetues që H.P ka deklaruar se këto janë dhurata nga klientët. Tutje i njëjti ka shtuar se ky raport është raporti zyrtar i ATK-së mbi të cilin e kam mbështetur këtë konstatim në këtë Raport Final, H.P ka bërë ankesë në Divizionin e Ankesave të ATK-së dhe në shkresat e lëndës ekziston vendimi i Divizionit të Ankesave të ATK-së, me nr. rendor 93/2020, i dt. 24.07.2020, me të cilin vendim nuk janë ndryshuar konstatimet e Raportit Final nga DHTI-ja, me përjashtim të disa shumave mbi qiranë kurse sa i përket kësaj pike nuk ka ndryshime, atë libër që është udhëhequr me dorë dhe ai nuk ekziston në shkresat e lëndës, për arsye se mund të jetë konfidencial, i njëjti i ka marrë dhe ju kam falë besimin raportit të ATK-së. Pra për ta sqaruar deri në fund, në faqen 6 të ekspertizës ku ceket se pranimet nga M. për vitet 2013-2018 janë gjithsej 609.406.00 dhe këtë shumë me Raport Final Hetues e kanë konsideruar si e hyrë për të cilin DHTI-ja ka ardhur në përfundim duke e shfletuar një fletore e udhëhequr me dorë nga H.P, ky raport, kjo fletore nuk ekziston në shkresat e lëndës. Dhe unë ja kam dhënë besimin konstatimit të DHTI-së dhe vendimit të Komisionit të Ankesave të ATK-së. Në ekspertizë në rekapitulacionin përfundimtarë e kam përfshirë transferet nga M., ashtu siç i kam gjetur nga raporti final hetues i ATK-së. Tutje i njëjti ka shtuar se nuk deklarohet se a ka pasur institucion financiar i cili ka bërë deponimin i cili është marrë me këtë punë, krejt këto i kam nxjerrë nga një kontratë- marrëveshje të cilën me dt. ... i ndjeri B. P thotë: “se unë po ja jepi këto 700.000 marka djalit tim dhe veturën L. S., ndërsa kam dhënë sqarimet në faqen 12 dhe 13 të ekspertizës se nuk mund të pranoj si kapital i cili rrjedh nga familja P, i dhënë nga prindërit dhe vëllezërit e H.P. Tutje i njëjti ka theksuar se në faqen 29 të ekspertizës janë specifikacionet e këtij automjeti, ku figuron se çmimi i këtij automjeti është 116 mijë euro, kjo bazuar në kontratën është mbi shitblerje me nr. ..., nga data ..., në nenin 3 të kontratës është precizuar edhe mënyra e pagesës ku thuhet: blerësi obligohet që shumën prej 21 mijë euro t’ia paguaj shitësit në rastin e dorëzimit të automjetit, kurse shumën prej 95 mijë euro t’ia paguaj deri më dt. ..., kjo kontratë është e noterizuar tek Noteri i Republikës së Kosovës S. B. me dt. ..., në shkresat e lëndës ekziston fatura e bashkangjitur ku shkruan: para të gatshme 21 mijë euro, kartelë 95 mijë euro. Fakti se kjo qenka kundërshtuar apo se është dërguar në përmbarrim për mua nuk është relevante. Andaj kuponi fiskal është i bashkangjitur në faturë, me kartelë kuptoj kartelën e bankës që ka mundësi me pagu kesh dhe dëshmia që është bërë kjo pagesë është kuponi fiskal i bashkangjitur në faturë. Pra dëshmi për pagesë është kuptoni fiskal. Prandaj në faqen 30 të ekspertizës është kuponi fiskal i lëshuar nga auto salloni “A.” me të cilin dëshmohet se është kryer kjo pagesë në vlerë prej 95 mijë euro, se a ka ndodh ky transaksion a jo është

pune e ATK-së. Edhe pse nuk është në këtë pikë duhet ti përgjigjem, lejohet pagesa kesh e një biznesi në vlerën prej 500 euro dhe atë gjatë një viti po pse kjo ka ndodh kështu unë vetëm e kam përshkruar atë që e kam gjetur në shkresat e lëndës. Tutje i njëjti ka shtuar se ky automjet, sipas të dhënave të Regjistrimit Elektronik të Qendrës së Automjeteve – Agjencioni për Regjistrimin Civil – Drejtorati për Regjistrim të Automjeteve, i dorëzuar zyrtarisht me shkresë zyrtare me nr..., më dt... me të cilin njoftohen Sektori i Hetimeve të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion në P, se ky automjet është i regjistruar në emër të H.P. I njeji ka theksuar se të ngastëra kadastrale ..., e cila është në vlerën më të madhe dhe pos kësaj marrëveshje ekziston edhe një kontratë e dt. ..., në mes të Ndërmarrjes Ndërtimore “L.” dhe H. Penqanit. Kjo kontratë, këto lokale të blera nga “L” kanë vlerën me të madhe se sa është vlera e pagesës të cilën H.Pe ka kryer për kompaninë “L” B.P, SH.P.K gjithçka është e sqaruar decidivisht në faqen 18, 19, 20, dhe 21 të ekspertizës dhe gjithsej pagesat të cilat janë bërë disa me kesh, disa me transfer, gjithsej bëhet 626 mije euro. Andaj në titullin e rekapitulacionit, ku gjithsej vlera e blerjeve të patundshmërive-palujshmerive është **1 milion e 139, 000.00 euro** dhe kjo duke filluar nga faqja 13 e ekspertizës, sipas pikave 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 të gjitha këto blerje që janë bërë e bëjnë shumën totale të rekapitullar në faqen 52 të ekspertizës. Po ashtu ekzistojnë të gjitha deklaratat e D.Hnë shkresat e lëndës të cilat dëshmojnë se ai i ka pranuar të gjitha këto shuma nga H.P, lidhur me këtë, në faqen 20 të ekspertizës, në shkresat e lëndës gjendet se me dt., në mes të H.P dhe D.H është lidhur kjo marrëveshje, sot, pasi që morëm kredinë në BKT bankë në shumë prej 248 mije euro, i morëm paret, të cilat i mori D.H pas tërheqjes, D. mi kthej paret e pagesave që i kemi bërë, pagesat kesh, faturë dhe paret i pranova, krejt në rregull ne jemi barazuar me borxh që kemi pasur ndaj firmës L.. Ndërsa procesverbali i shkruar me dorë, me dt. ..., marrëveshje – pazar për token e M. dhe K. R., për blerjen e tokës në shumën prej 6.500 euro për ari, në të njëjtin procesverbal kaparin e ka marre M. dhe K. 15 mije euro, prezent në marrëveshje F. G., I.A., M. R., K. R., dhe H.P nënshkruet i kësaj marrëveshje. I njëjti ka theksuar se në faqen 28 të ekspertizës të automjetit, është një tabelë regjistër nga Agjencioni i Regjistrimit Civil - Drejtorati për Regjistrim të automjeteve të cilën me shkresë zyrtare me nr ..., nga data .. me cilën shkresë njoftohet sektori i Krimeve Ekonomike në P se duke u bazuar në regjistrin elektronik konfirmojnë se e keni nën 1. H.P cilat automjete i posedon dhe këto janë të dhëna zyrtare të regjistruara, eksperti për këto automjete i ka nxjerrë vlerat e automjeteve, për ato automjete për të cilat në shkresat e lëndës nuk ka pasur vlera dhe decidivisht në faqen 40 të ekspertizës e gjeni se çmimi i automjeteve të cilat eksperti i ka nxjerrë nga amortizimi sipas normave evropiane të shpenzimit të automjeteve sipas gjendjes ... Arsyeya pse e kam marrë 2019? Sepse që nga mesi i vitit 2020 çmimet e vlerës së automjetit janë rritur shumë, unë e kam marrë vlerën e mjeteve të vitit 2019 për të gjitha automjetet të cilat janë të specifikuar në faqen 39 të ekspertizës. Ndërsa thelbi i ekspertizës, në pikën e parë e kam sqaruar edhe pikën e dytë e kam sqaruar, kjo shumë zbritet për një gabim që e kam kalkuluar dy herë në vlerën prej 60 mije euro, në pikën 3. është marrë vetëm vlera e kredive të kthyera, sa ka kthyer kredi H. P jo sa ka marrë, p.sh vetëm sa për sqarim shikoni faqen 46 te ekspertizës bazuar në marrëveshjet kreditore dhe të dhënat zyrtare nga BQK edhe atë datë e klasifikimit të fundit 2022 vetëm tek BKT-ja i ka marrë kredi 465 mijë euro, dhe këtë shumë vetëm e kam ilustruar që të jem më i qartë, i kam marrë vetëm shumën sa ky i ka kthyer dhe gjithsej është fjala vetëm tek banka BKT, ka kthyer 389.715.00 euro, në këto tri llogari bankare të cilat janë të specifikuar në faqen 46 të ekspertizës. Andaj kjo shumë ka të bëjë për vlerën e automjetit tek auto salloni “A” në faqen 24, për vlerën e automjetit te auto sallonit “E”, nr.... Për vlerën e automjetit nga auto salloni “P.” i cili i është dhënë me autorizim pa kufi H.P, U P dhe F. P, dhe ky automjet figuron ende në emër të auto sallonit “P., vlerën e automjetit të U P në faqen 33 të ekspertizës dhe faqen 34, vlera e automjetit në faqen 35, automjeti në pronësi të M. M. i dhënë me autorizim vlera e automjetit në faqen e ekspertizës 36, dhe të gjitha kur të mblidhen këto japin shumën si në rekapitulacion që do të thotë se të gjitha këto automjete nuk janë blerë por disa ende figurojnë në emër të auto salloneve të tjera dhe i keni në faqen 39 të ekspertizës, këto vlera e paraqesin specifikacionin e fundit, tutje duke i analizuar të gjitha marrëveshjet për kredi askund nuk kam gjet se është marrë ndonjë kredi për blerjen e automjeteve, e keni që nga faqja 41 e ekspertizës e deri në faqen 51, i keni të gjitha marrëveshjet. Pra të gjitha vlerat janë paraqitura konform kontratave mbi shit-blerjen e automjeteve, kurse edhe njëherë e përsëris për ato automjete të cilat nuk kanë pasur vlera i kam nxjerrë nga amortizimi sipas normave evropiane për shfrytëzimin e automjeteve të vitit 2019. E si përfundim i njeiti ka theksuar se çka është përfshi në asnjë milimetër nuk ndryshoj në rekapitulacionin dhe shumë qartë është sqaruar se është fjala për të gjitha blerjet e palujshmerive- patundshmërive. Te gjitha këto automjete për të cilat kam dhënë vlera nuk ka dëshmi, se ka dëshmi se ky ka dhënë një kerr tjetër dhe për një kerr tjetër dhe kjo nuk ka dëshmi që ka ndodhur as te

pronat. Ka raste kur si kompensim është dhënë një automjet konkretisht në faqen 18 të ekspertizës, i jep 100 mijë euro kesh dhe automjetin A në vlerë prej 35 mijë euro dhe këtë vlerë të këtij automjeti unë nuk e kam përfshi në pagesa as në vlerë totale se s'kam pas as një shënim, asnjë të dhënë, ka raste të tjera si p.sh me dt. ... në një kontratë e cila shkruan "Ugovor" theksohet se për një ndërtim H.Pi ka dhënë tri automjete dhe e ka nënshkruar që i ka dhënë mirëpo nuk i kam evidentuar në ekspertizë. Andaj është shumë qartë e sqaruar në faqen 22 të ekspertizës, këtu nuk ka paguar M dhe K dhe gjithsej pagesat për këtë pronë bazuar në një procesverbal i shkruar me dorë si marrëveshje me dt. ..., dhe lidhur me këtë pronë nuk ka asnjë kompensim me automobil po ka pagesa në shumën prej 60 mijë euro, të specifikuar shumë qartë me detajisht në faqen 22 të ekspertizës. Tutje injejt ka shtuar se pranimet nga M. G. të cilat janë të specifikuar në faqen 5 dhe 6 të ekspertizës i kam nxjerrë nga Raporti Final Hetues i Departamentit Hetimorë dhe Inteligjencës së ATK-së, Raport i Hartuar nga data .. kjo është sa i përket pranimit nga M. G. kurse pranimet nga W. U. të cilat janë të specifikuar në faqen 51 të ekspertizës i kam marrë nga shkresat e lëndës dhe të njëjtat i kam vërtetuar në selinë qendrore të W U. me dt. Shuma e të hyrave nga M.G gjithsej sipas një fletore të cilën e ka ekzaminuar Administrata Tatimore, DHI është në vlerë prej 6,0913.00 në këtë raport shkruan decidivisht se sipas fletores e cila është udhëhequr nga H.P nuk ka të specifikuar ndonjë anëtarë tjetër të familjes. Pra arsyeja pse nuk kemi kërkuar nga M.G qëndron se ky raport i Departamentit të DHTI-së, është hartuar dhe përpiluar nga një organ shtetëror të cilit ia kam falur besimin si ekspert dhe për këtë shkak nuk e kam parë të arsyeshme që ti vizitohet zyrat e M.G.. Ndërsa hapja e bizneseve, është konstatuar në bazë të të dhënave zyrtare të ARBK-së si dhe të dhënave zyrtare të ATK-së të cilat janë dorëzuar Prokurorisë Themelore në P me dt. ... me nr. protokollin ... Po ashtu kam pasur në posedim certifikatat e regjistrimit të biznesit të cilat janë në shkresat e lëndës. Tutje i njëjti ka theksuar në origjinal janë të specifikuar në ekspertizë në faqen 8, të dhënat për biznesin 1 dhe në faqen 9, dhe 10, të dhënat mbi biznesin nr. 2. O "B" është regjistruar në ARBK me dt. ..., me aktivitetin primar të këtij biznesi ka qenë kodi ..-aktivitetet e tjera të shëndetit të njeriut. Andaj në shkresat e lëndës nuk ka asnjë fakt apo provë se H.P ka pasur biznese të tjera të regjistruara në ARBK dhe se në të dy bizneset person i autorizuar dhe pronarë – aksionarë ka qenë H.P. Meqenëse në shkresat e lëndës ekziston shkresa zyrtare e ARBK-së e dorëzuar në Prokurorinë Themelore në P nga data .. që H.P i ka të hapura dy biznese të cilat i keni në faqen 8 të ekspertizës. Pra këto dy biznese, biznesi "B" dhe "U," janë të inkuorporuar me një numër fiskal, kur është hapur biznesi i dytë me dt. .. i kanë inkuorporuar me një numër fiskal që do të thotë H.P Biznes Individual dhe MPH "U," e kanë një numër fiskal dhe nuk mund të ndahen, është i njëjti. Biznesi "B" dhe "U," veprimtaria dallon, kryesisht veprimtaria kryesore – primare nuk dallon e kanë të njëjtin kod .., aktivitetet e tjera të njeriut, por biznesi NPH "U," ka edhe aktivitetet e tjera sekondare të cilat i ka regjistruar, hoteleri, shitje, kafiteri, përpos kësaj shifre është i regjistruar tek veprimtarit sekondare dhe veprimtari të tjera. Te biznesi NPH "U," përpos aktivitetit primar është regjistruar edhe aktiviteti sekondar bëhet fjalë prej datës ... i njëjti ka shtuar se me rastin e hapjes së këtyre bizneseve as te biznesi i parë e as te biznesi i dytë nuk ka patur as një cent kapital fillestar. Ndërsa për pasurinë në pikën III të aktakuzës të gjitha përgjigjet janë dhënë nga faqja 13 e ekspertizës e deri në faqen 28. I njëjti tutje ka theksuar se për pikën III të aktakuzës këtu dua të sqarohem rrënjësisht, nuk e ndaj mendimin e njëjtë me raportin e DHTI-së të cilët si të hyra i kanë konsideruar edhe të hyrat nga ditaret të cilat janë gjetur dhe të hyrat e M.G të udhëhequra në një fletore arsye pse unë nuk i konsideroj këto të hyra është shumë thjeshtë, sipas Standardeve të Kontabilitetit në Kosovë, SKK standardi me nr. 6 të cilat standarde janë në fuqi që nga 1 janari 2002, ky lloj i të hyrave nuk pranohet, prandaj edhe në specifikacionin e fundit të cilin e keni në faqen 52, unë si të hyra i kam pranuar vetëm të hyrat të cilat sipas raportit të DHTI-së janë realizuar si të hyra nga kontratat, dy kontratat të cilat H. P i ka dhënë me qera dhe këto gjithsej bëjnë 228.956.00 në rekapitulacionin përfundimtarë në faqe 53, në fund e keni se të hyrat nga ky biznes, është fjala të hyra nga qiraja, në raport me blerjet, deponimet dhe transferet janë vetëm 9.05% dhe nuk qëndron ashtu siç është cek në ekspertizë për faktin se është bërë një përmirësim tek një veturë që e kemi sqaruar në seancën e kaluar. Vlera e të gjitha blerjeve, patundshmërive, lartësisë së mjeteve nga Ëëster Uninoni 2004-2018, në ekspertizë është vlera totale 2.588,715.34 euro pas një përmirësimi të cilin është bërë te një automjet tani kjo vlerë është 2.528.715.34 euro. Andaj të gjitha vlerat të cilat i kam specifikuar në rekapitulacionin e ekspertizës në faqen nr. 52 i kam nxjerrë nga shkresat e lëndës të cilat janë në lëndë dhe që janë të shumta, nëse për këto pika të cilat unë i kam specifikuar nuk ka qenë në shkresë të lëndës eventalisht ndonjë shkresë shtesë dhe të cilat materialisht e ndryshojnë këtë gjendje unë jam i gatshëm të bëjë përmirësimin e ekspertizës.

Dëshmitari I.N në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës .. ka deklaruar se, po kam pas kontakt H, sepse ku jetoj vetë ai në atë rreth të komunën e Skenderajit, bashkësia lokale e Runikut, e cila përbëhet prej 12 fshatrave është zonë e varfër, njerëzit jetojnë me 70 % me social, edhe aty linden çdo s'mundje, sene të pakëndshme për njerëz i ka rastisë që i ka dergu 3-4 herë njerëz me veturën e tij njerëz nevojtar tek B, gjatë udhëtimit të shkuarjes dhe kthyerjes krejt ka qenë i informuar çka ka ndodhë, çka i ka marr, çka i ka thënë, edhe ato kanë tregu lloj lloj senesh, fjalësh, sa kanë qëndruar tek ai. P.sh një familje që e ka dërguar, ma përpara e kanë pas një vajzë gjëja për shërim edhe për fillim iu ka marr 20 euro për me i tregu qysh shkon, pastaj i ka thënë se duhet me ja bo një hajmali të vogël e cila kushtojkë 300 euro, shumë prej tyre 3-4 palëve që i ka dërguar, nuk kanë pas sukses me atë, dhe janë detyruar me i dha ka 1.200 euro, tjera për një hajmali më të madhe, që të kenë sukses, rasti që e ka e ka cekur është se ku është ajo vajza, e kanë gjetur me emër dhe numër, dhe e kanë kërcënuar pse nuk keni pru bakshish, dhe i ka tha se nëse nuk e bjen bakshishin ka me ta smu prapë çiken. Me tej i njëjti ka shtuar se edhe një rast e di kur një familje ka pas me martu djalin, dhe janë shkuar për me shkru, për me vazhdu me shku puna e mirë, dhe mos me ju bo kurgjo, aty i kanë paguar 1.000 euro, për do shkronja, me i kall dhe i sjell do sene. Këto dy raste i kam mbajt në mend, ndërsa ato dy raste tjera nuk i mbaj në mend. Vetë ai personalisht ka qenë brenda te B kur e kanë pas rastin e tyre, ku në Janar të vitit 2017 ika vdekur vjehrra dhe ajo la shtek të madhe në familje, e la djalin, rejën, edhe dy fëmijë të djalit, çikat i kishte të martuar, dhe të gjithë janë merzitë, djali i saj u mërzitë shumë dhe gati kaloi në depresion prej mërzisë, ka vizituar mjekë, të cilët nuk i di, dhe ju ba marak djalit me shku në P te B, kështu kam dëgjuar, të njëjtin është mundu me ndalu se e ka ditur që i ka pa senet e kota aty, si rastet tjera. Por ati ju mbush mendja me dergu, fillimisht ja ka marr 20 euro për vizitë. Kur janë shkuar aty te B, në sallën ku presin edhe njerëz tjerë, i kanë dhënë letërnjoftimin dhe është regjistruar miku i tij, dhe ka hyrë brenda me të, pagesën e kanë bërë brenda te B. Të njëjtit i ka pyete kush jeni ju, çka ju mundon, çka punoni, ku jetoni, i ka shkruar do letra dhe ka tha duhet me ja bo një hajmali e cila kushton 300 euro. Të njëjtit i kanë thanë në rregull për puna mos ja prish djalit, se nashti shërohet, dhe ju ka thanë që kur të shkojmë tjetër herë, me i dërguar, vezë, drynin me çelës, qira. Ata ia kanë dërguar tjetër herë, ditët e punës i ka pas të Martën edhe të Premten ditë pune. Gjatë shkrimeve që i ka kryer ja ka dhanë edhe një shishe me ujë, dhe i ka tregu qysh me përdorë atë, por ka harru qysh i ka thënë me përdor. Ja ka maruar hajmalinë dhe këna shkuar prej shpie, drynin i ka thënë gjuajë me një rek. Pastaj janë kthyer në shtëpi, kanë pritë 10 ditë, dhe e kanë thirrë në telefon e kanë njoftuar se djali nuk ka sukses, për çka ju ka thanë B hajdeni se duhet tjetër sene me bo një hajmali më të madhe. Dhe ajo hajmali kushton 1.200 euro, ata si kanë pas ato pare, por djali dhe motra e tij kanë tha sa nashti bahet mirë, është deshtë me hy kredi për me i bo ato pare e të cilat ja kanë dërguar Bt, e për çka nuk ju ka lëshuar asnjë faturë, na ka pështjell hajmalinë dhe kemi shkuar në shpi. B i kanë treguar se kanë qenë te doktori, por ai ka thënë se unë jam këtu që i kry këto punë. Këta e ka tha edhe me një TV, që ka qenë me hoxhën B. M., dhe me një doktor, i cili ka deklaruar se unë jam baba, se shkojnë pacientet te hoxha te mjeku, por masrami vinë te unë dhe i shëroj. Me tej i njëjti ka theksuar se F.i ka marrë paret kredi me ia dërguar B, i njëjti ka besuar në shërim përmes magjive e për këtë arsye ka insistu me shku. E si përfundim i njëjti ka shtuar se vetë ai e ka thirr në telefon H të cilit i ka thënë nëse i kthen paret ne nuk i bashkohemi këtij gjykimi, derisa nuk na i kthen paret ne i bashkohem ndjekjes penale.

Dëshmitari Rr.E në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës ... ka deklaruar se, e njeh B pasi ka punuar te i njëjti i cili ka punuar si punëtor i thjeshtë ka mbajt rendin, ka regjistruar pacientet, ka pastruar parkingun, vendin, në shpi oborrit etj... i njëjti nuk ka punuar rregullisht, ka punuar të Martën të Premten dhe ku ka pas nevojë. Gjatë atyre dy ditëve kanë qenë diku 15-20 paciente, deri në 50 pacientë. Me tej shton se nuk ka pasur kontakt me te holla përveç kur ka pasur ndonjë pagesë të kredive apo obligim të B, kështu e kredive të cilat i ka pas H.P, kur ka pasur nevojë, B ia ka dhënë të hollat kesh me shku me bërë pagesë e të cilat shuma kanë qenë 1.000 ose 2.000 euro e për të cilat shërbime nuk është paguar përveç pagesës ditore, po ashtu përveç tij kanë shkuar edhe punëtore tjerë të bëjnë pagesa, me te shkuar në bankë arsyet e deponimit të hollave-kësht të kredisë, si dhe ka deponuar mjete në bankë edhe për qëllime të pagesës së një shtëpie, sepse B çdo herë ka pas një arsye. Ndërsa B ka pasur të hyra tjera nga objektet me qera, restorante dhe mishtore. Me tej i njëjti shton se të vetë ai pacientet nuk kanë paguar asgjë, por në fillim ka qenë vizita 10 euro, masanejë është bë 20 euro, pagesën e kanë bërë brenda te B. E si përfundim i njëjti thekson se ka shkuar ka marrë pare nga qirajave se shumica kanë qenë të lëshuara me qera ndërsa vetëm mishtorja ka qenë e Bt dhe nuk ka njohuri se a kanë qenë të regjistruara ato lokale

Dëshmitari B.K në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës ... ka deklaruar se, ka pas kontakte një herë me H.P dhe ka qenë se bashku me shoqen e tij. Arsyeja pse ka shkuar ka qenë se vëllai i tij ka një djalë me probleme shëndetësore-me të meta, dhe në pamundësi të ardhjes së tij, çdo 2-3 muaj me u lajmëruar. Një herë ka shkuar vetë vëllai një herë ka shkuar vetë ai. Aty ka qenë një pritore, që është dashur me shkuar në ora 6, ku ka paritë deri në ora 9-10, pastaj kanë hyrë brenda me nusen e tij, aty ka qenë një dhomë e errët vetëm ku kanë qenë 3-4 tv me video non stop duke dëgjuar raste të mëhershme, një mënyrë e mirë me na bind që po punon me i shëruar njerëzit, disa kartela të vogla ju ka dhanë me shkrim gjuhën që se kisha pa kurrë, dhe përmes prindërve i'a ka dërguar vëllait në Z.. Tutej thekson se vetë ai nuk ka paguar diçka por vëllai i tij herën e parë ka paguar 2.000 euro, pasi i ka premtuar se brenda 6 muajsh djali ka me ec dhe ka me fol, djali i tash i ka 12-13 vjet, dhe se është njëjtë pa asnjë ndryshim. Sa e din vetë ai një herë ka ardhur tek ky dhe e ka pa që s' do të ketë sukses, i ka thënë vëllait mos je tu gabuar se s' mundet me bo aj këtë, po ashtu vëllai i gruas edhe ai ka pas diçka kështu me herët i cili i ka treguar vëllait se ka qenë tek B se u dok qe i ka ndihmuar. Me tej shton se për emrin e Bt ka dëgjuar para 6-7 vite ku ka pasur një rast miku i tij i cili ka pasur djalin diçka me probleme më të vogla. Fillimisht vëllai ka shkuar në mëngjese herët me nusen djalin dhe nanën pasi ka biseduar me këta nuk e din sa pare saktë ka pas vëllai por e di që ka ardhur në shtëpi me marr tjera se i ka kërkuar më shumë se që ka pas vëllau vetë ai nuk ka qenë prezent kur vëllai i tij ka paguar paratë. Me tej shton se miku dhe vëllai i kanë besuar Bt, por vëllai i tij nuk ka pas sukses ndërsa vetë ai dhe babi i tij kanë qenë kundër kësaj por vëllai është arsyetuar se e ka djalin kështu dhe don me gjet qare. I njëjti i ka thënë vëllait me qenë ky aq i zoti e kishin marr Zvicra atje nuk e kishin lënë këtu. E si përfundim i njëjti ka theksuar se ka njohuri se 2.000 euro ia ka dhënë Bt se për këtë çështje kanë diskutuar në familje.

Dëshmitari E.B në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës ... ka deklaruar se, H.P e njuh se ka punuar afër aty në një fushë pranë shtëpisë se tij, i cili ka punuar te H ia ka mbajte kopshtin jo rregullisht të shtunën dhe te dielën si ka pasur nevojë, të cilin e ka paguar për pune e kryer 10-15 euro. Me tej i njëjti shton se e ka dërguar në bankë me ja paguar këstin e kredisë, përafërsisht 4-5-6 herë, në shumë 4.500-5.000 euro. Me tej thekson se shumë prej 5.5000 euro, nuk është bere përmes bankës, ajo ka qenë një dëshmi ku H e ka ble një shtëpi dhe vetë ai ka qëlluar pranë lokali dhe fushën e ka pas prapa shtëpisë ku e ka ble, dhe vetëm nënshkrim ka dhënë për me qenë dëshmitarë që ky e ka ble shtëpinë. Ndërsa për një kësht kredie ka deponuar e ka thirr në tel e ka pyet a mundësh se kam telashe nuk mundem me shku në guzhma i ka thënë po dhe ka shkuar i ka deponuar kur është kthyer e ka paguar për këtë punë. Ballafaqimi i dëshmitari me dëshminë e dhënë në prokurori " më dt 25.04.2019 në fq.3 në pyetjen në deponimin e dt 22.08.2015 keni dhënë një deponim në shumë 5.500 në arsyetimin për huazim për blerjen e shtëpisë në emër të Hysni P, përgjigja juaj ka qenë " këto para mi ka dhanë B më ka thanë shko dërgoi në bankë unë i kam dërgua.." i njëjti thekson se po kështu kam deklaruar ndërsa i ka thënë merri dërgoj në bankë si gjithmonë ka shkuar me paguar këstin qysh i ka thënë ashtu ka vepruar. Me tej shton se B e njuh 12-13 vite, dhe se i njëjti ka pasur besim te vetë ai përderisa ia ka dhënë paratë me shkuar me paguar këstin, po ashtu B ka pasur një restorante aty pranë rrethit një mishtore, një objekt që e ka lëshua me qira, kurse nga i ka marrë paret nuk dinë. I njëjti me tej thekson ka mund me qenë dhe 10 her qe ka shkaur me deponuar pare në bankë se nuk ka shkuaar çdo muaj vetëm më ka thirr i ka thanë shko, nuk ka shkuar çdo muaj, ka mujt 4-5 muaj si ka thënë hiq. Parat i ka nxjerr nga gjepi ia ka dhënë kesh. Ndërsa kur ka shkuar në bankë ka prit në rend, kur i ka ardh rendi ka hy aty e ka bo pagesën dhe fletëpagesën ja ka kthye B për pagesat ia ka dhënë letërnjoftimin dhe një letër banke që e paguan çdo muaj, kur është kthyer B i bojke me fllamaster me dit që e ka paguar. Po ashtu nuk i ka shkruar për çka duhet me i paguar ato para në bankë ia ka dhënë letrën ata e dinin pse po paguajë atë dhe në bankë nuk me kanë pyet absolut se për çfarë bëhet pagesa, ku e ka pa me të lirë aty e ka bërë pagesën. Si përfundim i njëjti shton se gjatë kohës sa ka punuar në oborrin e H nuk i ka ndodh shumë por ka parë 10,11 ose 12 myshteri.

Dëshmitari R.T në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës .. ka deklaruar se, nuk e njef H.P ndërsa B e njef se ka punuar te ai në restorant prej vitit 2017 kamarjer, shankist me kontratë në afat prej 3 muaj, s'ka pas punë e ka lan mandej ka punuar veç martë-premtë kur ka pas nevojë, për palët që vishin për me u shëruar tek B, vishin në restorante dhe i shërbejshim me kafe qaja. Në ballafaqimin me deklaratën e dhënë në prokurori " me datë .., në pyetjen çka keni punuar ju jeni përgjigj " aty kam punuar për ta mbajt rendin në ordinancë te B dhe kur kanë ardhur klient i kemi drejtuar tek B dhe jemi munduar ta mbajmë rendin " i njëjti thekson po kështu kam deklaruar kështu është. I njëjti ka shtuar se B kur kish naj pagës me kry

në bankë, naj kredi apo naj senë, kur i kemi vy na ka thirre dhe ka shkuar të martën – premtë i ka lajmëruar shkoni boni pagesë në bankë dhe vetë ai ka shkuar, i cili veç thojke kreditin me paguar. I njëjti ka shkuar ta paguaj kreditin me letërnjoftim të B, në shuma 2000-3000 euro, nuk i kujtohet mundet me qenë 3-4-5 ma tepër ndoshta. Në ballafaqim me deklaratën e dhënë në Prokurori në P ‘’ me datë .. ke shkuar me bo deponimin e shumës prej 648 euro e pastaj të njëjtën ditë ke shkua me bo deponimin në shumë prej 1.178 euro’’ i njëjti thekson se ndoshta kam shkuar por si datë nuk i kujtohet pasi qe figuron po kam qenë atëherë. I njëjti shton se ka punuar te B dhe ka pasur dy kafiteri ndërsa ku i ka marrë pret B nuk ka njohuri.

Dëshmitari J.M në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës .. ka deklaruar se, punon moler në ndërtimtari me mëditje. Shton se njihet me H.P pasi ka punuar në shtëpi meremetime po ashtu me ka thanë se don mi rregullu dy shtëpi apo tre nuk është i sigurtë por të shohim nëse muj me tërënjek kredi dhe kanë shkuar tek noteri kanë nënshkruar kontratë interne ku u cek J.M në shumën prej 13 mijë euro, të i kryej punët e shtëpive në momentin kur parat lëshohet në llogarinë e tij, paret nuk janë lëshuar, dhe ajo punë nuk është kryer prej tij ka mbet ashtu. I njëjti nuk ka dit se te noteri mundet mu prish kontrata nuk është ba ajo e lam ashtu pas një kohe ATK ka lyp me u ba pagesat e kësaj shume diku mos gabofsha 2.400 diçka 2.500 euro ka qenë kërkesa e ATK-së, të cilën shumë nuk ka pasur të cilën ia ka kërkuar, këto shuma ne emër të kontratës qe ka figuruar shuma 13 mijë euro. Për çmimin janë taku aty që me fillu punën me qato dhe tani të bëjm edhe njëherë llogarinë kur të dalin nuk është i sigurt a bëhet për fjalën për 3 shtëpi mirëpo për dy është i sigurt. Njëra ka qenë e përfunduar dhe dy të tjera nuk kanë qenë, për dy e di sigurt për tjetrën nuk më kujtohet njëra ka qenë kështu por ndërtimi ka pas me u përfundu brenda. Të cilat shtëpi gjenden në oborr ku është tash H.P ku gjithsej janë tani janë 4 shtëpi aty. Puna nuk ka vazhduar sipas marrëveshjes H i ka thënë se ma kanë refuzu kredin edhe ka dështuar kjo punë. I njëjti shton se nuk e kanë matë shtëpinë por njëra shtëpi ka qenë e nderuar, ndërsa para se me nënshkrua marrëveshjen e di se në çfarë gjendje është edhe sot. Marrëveshja ka qenë kur ke muhabeti qe tha po hi në bankë me i dhanë emrat te banka kush po e punon kemi ba kontratë e kemi hap xhirollogarinë në bankë kurrë nuk kemi marr kartelat e bankës kur jemi taku tha na e ka refuzua kredinë dhe ka mbet pa u krye.

Dëshmitari Sh.L në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës .. ka deklaruar se, me profesion është moler merret me ngjyrosje, të H.Pka punuar në shtëpi ia ka ngjyrosur dy dhoma. Dëshmitari përgjigjet se ishim duke punuar të H tha kam me marr një kredi me arsyen se nëse banka më pyet se për çka po të duhet kjo kredi me i than që kam me i pagua mjeshtërit, prej atyhit kemi shkuar tek noteri me berë kontratën, prej noteri në bankë me i nxjerr kartelat, kartelat nuk i kemi marrë, tani pas dy dite e pyeta tha me anuluan kreditin, dhe ma kur ka ardhur puna e bastisjes së H atëherë e kanë gjetur letrën që paret dhe ajo e noterit që firma jo e deklaruar dhe paret jo të deklaruar dhe kamatat tjera kanë hyp, diku gjoba në ATK ka qenë 3.180 euro, për mua, ndërsa B mi ka dhënë 2.500 euro, me shlye këtë borxh ia kam lyp ato tjerat mirëpo tha që nuk kam, u detyrova me i pagua dhe me i lyp neper miqësi dhe gjobën tjetër 680 euro, e kam paguar prej xhepit tim kjo është. I njëjti ka shtuar se marrëveshja ka qenë fiktive për arsyeje të bankës, që me nxjerr një kredi prej bankës B, qëllimi nuk u kanë për me u ndërtuar diçka vetëm për me i marr paret, se B më ka thënë qëllimi është vetëm të i nxjerri këto pare prej banke ndërsa nuk është qëllimi të ndërtohet diçka. Të njëjtit shumë mirë i kujtohet se marrëveshja ka qenë e kontraktuar për me ndërtuar tri (3) shtëpi, ndërtimi është paraparë në oborr të vetë (Ht) para shtëpisë tash ka pas meremetimin më doket më u be nuk e di për anej nuk e di më shumë. Objekti ka qenë para shtëpisë së tij i ndërtuar pjesërisht ndërsa dy objektet tjera me sa më kujtohen aty kanë qenë. Në pyetje të parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit H.P av.F. A. meqë u përmend një parashtrësë një titull marrëveshje lidhur me ndërtimin, më lejen gjykatës ia jepi në shiqim, titulli është marrëveshje mbi ndërtim tek rreshti i parë dhe i dytë “ palët kontraktuese janë pajtuar që ofruesi i shërbimeve, pranuesi i shërbimeve të ndërtimit të kryej punimet e ljerjes si brenda shtëpisë ashtu dhe jashtë shtëpisë “. Dëshmitari pas shiqimit të kontratës- marrëveshjes, lidhur me ndërtimin. I njëjti deklaroi se **qëllimi i kësaj marrëveshje ka qenë vetëm me i marr paret kredi**. I njëjti shton se ATK-së, i ka shpjeguar se këto pare nuk i kemi marrë ama ata thanë që gjoba duhet të paguhet. Me tej i njëjti thekson para se të nënshkruajnë marrëveshjen nuk i kanë shikuar shtëpitë, vetë ai dhe Jetoni me rroba pune janë shkuar te noteri dhe kanë nënshkruar kontratën. Në deklaratën e dhënë në polici i njëjti kishte theksuar “... jam mashtruar nuk e kam dit çka po nënshkruaj,..”, ndërsa në seancën ka deklaruar se gjithçka ka qenë fiktive, pasi që kur është nisur rrugës i ka thënë kqyr mos po del naj problem, tha për kredi diçka me marr keni me ardhur me nënshkruar diçka te noteri nuk keni me pas

problem. Ndërsa kur kanë shkuar te noteri e kanë pa deklaratën se çka po nënshkruajmë dhe e ka lexuar pak. Po ashtu në të njëjtin procesverbal në pyetjen e fundit ka deklaruar “ jam mashtruar nuk kam ditë çka po nënshkruaj “ në shqyrtim gjyqësor e ritheksoi se e vërteta është ajo çfarë kam deklaruar në polici që jam i mashtruar, ndërsa marrëveshjen që është bërë ka pas probleme për arsye të gjobës se në atë kohë ka punuar pa firmë. Lidhur me atë se mos realizimi i kontratës i kanë thanë se është dashur me shku te noteri për ta anuluar po nuk ka pasur njohuri, ndërsa për nënshkrim te kontratës të dyve na ka thirrë B.

Dëshmitarja L.K në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës .. ka deklaruar se, e njeh H.P pasi që i ka shitë shtëpinë, përafërsisht me dt ..., ajo shtëpi gjendet në rr. “A. B.”, shtëpia ka qenë me oborr, jo taman 2 ari tokë, çmimi ka qenë 40 mijë euro, ato pare i ka marr kesh në dorë, në tri këste më sa i kujtohet, dhe kjo ka zgjatë brenda 1 muaj e gjysë është përfunduar krejt pagesa.

Dëshmitari M.Ç në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës .. ka deklaruar se, ka punuar nuk ka pas punë të përcaktuar po ka bërë punë të ndryshme, ka fshi, pastru, mirëmbajte parkingun dhe ka mbajt rendin e klientëve, etj, e për të cilat punë nuk ka pas kontratë, pasi nuk ka punuar rregullisht. Me tej i njëjti ka theksuar se një herë i ka dhënë të holla për huazim e të cilat holla i ka pasur për ndërtim të shtëpisë she ia ka kërkuar për një kohë të shkurtër dhe ia ka dhënë diku 9 mijë euro, në atë kohë ka punuar me fasada, por për këto pare i ka ndihmuar motra e tij prej Z., prej dikujt tjetër nuk e di a ka marr B. Tutje shton se ka shkuar në bankë me E. sepse këstet mujore të cilat i ka pas për kredi H i ka paguar këstet. Huazimin të cilin ja ka dhënë B në vlerë prej 9 mijë euro, ia ka dhënë kesh në dorë e kjo ka ndodhur vetëm një herë, ndërsa shumën prej 9.000 euro, ka qenë pagesë e këstit mujor dhe ketë e ka bërë disa herë, pra ka bërë deponime edhe për këste për shtëpinë e blerë. Në pyetje të PSRK-së, atë ditë me .., që keni deponuar në bank të holla, Rr.9 mijë euro, I. Rr. 9 mijë, ti 9 mijë, E. B. 5 mijë e 500, I. R.9 mijë, I. R. prap 1 mijë të gjitha këto deponime të njëjtën ditë, a të kujtohet kjo? I njëjti është përgjigjur se me ta nuk ka qenë atë ditë, por ka mundur të jenë edhe ata që kanë bërë deponime arsyet e deponimit për shpie aty, sepse aty janë blerë shumë shpi, ato pare kanë qenë të H të cilat janë marr nga qerajat. Po ashtu i njëjti në pyetje të PSRK-së, Ti ke deponuar shumë pare, gati çdo muaj ke bërë deponime, p.sh. me dt..., ke pas 2 deponime në BK, një deponim 2.285 euro, e pastaj prapë të njëjtën ditë 3.430 euro, për çka janë bërë këto pagesa? I njëjti është përgjigjur se menjëherë janë bërë ajo pagesë por ka qenë e ndarë në këste, e të cilat sipas kësteve i ka paguar për kredi. I njëjti ka theksuar se shumat e dërguara në bankë ndonjëherë janë kanë 6 mijë, 7-8 mijë, të cilat janë paguar përnjëherë për kredi, ndërsa pse janë ndarë nuk ka njohuri. Po ashtu H.P ka dhënë faturat dhe mjetet. Në bankë kanë shkuar se bashku me kolegë arsyeja pse kanë shkuar sepse i kanë pas 3 fatura, dhe që të kryen më shpejt një e kam marr vetë ai, një faturë tjetri. I njëjti shton se paret B i ka marr prej restorantit që ka pas dhe ka pas lokale me qera, dhe prej një lokali që e ka pas me kamera me vëllain e tij. Në pyetje nga mbrojtësi i të akuzuarit av. D. O. Në të njëjtin procesverbal keni deklaruar se “detyrë e kam pas mbajtjen e rendit, shpërndarjen e numrave që kanë ardh me u vizituar” **a nënkupton se nuk keni informacione se a kanë paguar pacientët për vizitën?** I njëjti është përgjigjur në fillim kur ka hyrë është bë pagesa 10 euro, e më vonë është bërë 20 euro, por nuk ka qenë prezentë kur është bërë pagesa. Tutje i njëjti ka theksuar se, nuk e di prej bizneseve tjera se a ka marr pare, përveç punëve të cekura me lartë s’ka bërë punë tjera, numrat jashtë me rend vetë ai i’ka dhënë pacienteve të Martën dhe të Premten, ka qenë diku 10 deri 20 **numra për pacientë**. Përveç numrave i ka identifikuar klientët përmes letërnjoftimit, në pjesën para se me kaluar të H nuk kanë bërë pagesë. **Ata e kanë paguar vetëm vizitën e jo diçka tjetër.**

Dëshmitari D.H në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës ... ka deklaruar se, ka pasur marrëveshje për shitblerje të palujtshmerive me H.P të cilit ia ka shitë një lokal 260 metra katror. Lokali gjendet në P në lagjen O., rr.T., nuk i kujtohet data por është e noterizuar dhe dëshmohet përmes kontratës, pasi i njëjti ka bërë kërkesë me ble lokalin pa e ndërtuar, vetë ai ia ka dhënë një ofertë prej 350 mijë euro. Fillimisht H ia ka paguar 100 mijë euro, dhe i kam marr 100 metra katror, më pastaj edhe 250 mijë euro tjera, për 160 metra katror. Me tej i njëjti ka theksuar se sipas marrëveshjes se metri katror i lokalit ka qenë 2.600 euro, kjo ka qenë para kontratë me arsye që i njëjti të merr kredi në bankë, dhe e ka cek që kjo vlen vetëm për bankë pra për të gjitha këto janë kontratat, dhe pa u bërë kontratë s’ka mundur me u bart pronësia. Me tej i njëjti shton se nga Tetori i vitit 2012, ka marr shumat prej 10 mijë e 500 euro, se të gjitha pagesat që i ka marr në muaj, e ka pritë deri e ka marr kreditin e fundit në shumën prej 250 euro, dhe janë ardhë në konton time, dhe këto mjete kanë dalë për blerjen lokaleve, pastaj kur i kam marr mjetet ia kam kthyer

të gjitha për çdo muaj, edhe e kemi bërë barazimin prej 350 euro që i kanë kushtuar 260 metra katror. Ndërsa është bërë transferimi nga ndërmartja U, në xhirollogarin time në shumë prej 248.750 mijë euro, po ashtu kur është bërë transferimi, e ka nënshkruar një marrëveshje, që në momentin kur të kanë dal mjetet në llogari, i ka nxjerr mjetet dhe me kesh ja ka dhënë me u barazuar gjendja me Hn. Lidhur me deklaratën e dhënë të av. E. G. e ka dhënë se ka dashur me marr kredi H ketë deklaratë e ka dhënë vetëm për bankë, që me marr kredi më lehtë, për banka me ja vlerësuar ketë shumë dhe me shti në hipotek, dhe e kanë cekë aty që kjo vlen vetëm për bankë ndërsa kontratën te noteri e kanë nënshkruar 3 vite më vonë, se para 3-4 vite s'kanë mundur me bart pronësinë pa u legalizuar objekti kurse pranimit teknik është bërë pas 3-4 viteve, ka fundi i vitit 2017-18, pasi që kontrata te noteri është bërë në vitin 2017 me qëllim që të kalohet pronësia. Me tej i njëjti thekson se vlera që ka marrë nga B muaj për muaj ka qenë shuma prej 10 mijë e 500 euro.

Dëshmitari F.Sh në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës ... ka deklaruar se, familja e tij i ka shitur pronë H.P e cila pronë është e ngjitur me shtëpinë e H, të cilën pronë ia ka shitur babai i tij. Aty ka qenë oborri dhe një objekt, fillimisht e kanë shitë vetëm oborrin, pastaj ia kanë shitë edhe objektin, kanë qenë 5-6 ari oborr, vlera ka qenë herën e parë ia ka marr një kerr në vlerë prej 10 mijë euro, dhe 70 mijë euro pare, pastaj e ka marr edhe një kerr prej H të tipit B. 530 në vlerë prej 25 mijë euro, edhe 140 mijë euro për objektin, të gjitha këto i ka bërë prindi i tij. Ndërsa i njëjti ka dijeni se për pjesën e tokës që e ka shitë A. Sh., H, pak më larg është një parcelë mbrapa, e cila ka kushtuar 120 mijë euro, A.ka qenë i gjallë po ashtu edhe bashkëshortja e tij N. Sh.. Me tej i njëjti shton se vetë ai nuk ka mundur me qenë shitës sepse baba i tij ka qenë gjallë dhe toka ka qenë në emër të tij ndërsa vetë ka qenë në rolin e ndërmjetësuesit. Po ashtu i njëjti thekson se koha nuk i kujtohet por ka qenë prezent kur është bërë marrëveshja kur E. ia ka shitë token H se përveç tokës ka qenë edhe një servisë në objekt të vjetër, ndërsa pazar ka qenë një kerr audi Q7 në vlerë 50-60 mijë euro, dhe para 150 mijë euro, kurse nuk e din a është realizuar kjo shitblerje. Për pazarin e parë ka ndodhur 3-4 rata dikun, ndërsa pazarin e dytë e kanë marr një B. në vlerë prej 25 mijë euro, dhe shuma e parave në vlerë prej 140 mijë, është paguar në 5-6 rata, tani në atë vend janë objekt 2-3 katesh, punon një mobileri, objektin e ka ndërtuar H. Me tutje i njëjti ka shtuar se kur është shitur pjesa e parë ka qenë viti 2003-2004, ndërsa për pjesën e dytë në vitin 2007, pra kanë qenë pazare të ndara, fillimisht vetëm oborri, pas 2 vitesh edhe lokali, parat i kemi marr me rata kesh, jo përmes bankës, kjo është vetëm për familjen time, për axhën nuk e din se si janë bërë pagesat. Pronat janë bart te B me avokatë pasi që është përfunduar pazari, përafërsisht në vitin 2008 nuk e di saktë, vetë ai e di që e kanë bërë një kontratë te avokati dhe ashtu është bërë bartja e pronës. E si përfundim i njëjti ka theksuar se është e vertte që i kanë marrë 140 mijë euro, e për të cilat ndoshta kam nënshkruar najkun.

I akuzuari H.P në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt.**23.12.2022** ka deklaruar se, i ka kuptuar te drejtat dhe detyrimet që ia ka lexuar gjykata, ka theksuar se dëshiron të shfrytëzoj të drejtën e tij të mbrohet në heshtje.

I.

Pas procedimit të provave personale dhe materiale në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht me njëra-tjetrën, në kuptim të nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së, kjo gjykatë ka vërtetuar se ka prova se i akuzuari H.P ka kryer veprën penale ***Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.***

Gjykata në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vërtetuar se i akuzuari H.P nga data .. ka regjistruar biznesin e tij privat O "B", me aktivitet primar "aktivitetet tjera të shëndetit të njeriut" me seli në rrugën "J. e R", në P, dhe deri më datën ..., pa kualifikime profesionale dhe pa licencë përkatëse me pretendim se shëron sëmundje të rënda fizike dhe psikike si: *paraliza, distrofinia, epilepsia, gratë sterile etj dhe ndihmon në zgjidhjen e problemeve të ndryshme familjare*, në vazhdimësi ka kryer trajtime mjekësore, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Shëndetësi Ligji nr. 04/L-125 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin për shëndetësi nr. 08/L-043, në atë mënyrë që i njëjti ka reklamuar veprimtarin e

tije përmes shtypit ka shtypur vizitë- karta me adresë dhe telefonin e vet, në derën e hyrjes në zyrën e tij mban mbishkrimin ‘M.’ me pretendim se shëron të sëmurit me barna popullore, dhe udhëzon personat të ndryshëm, shtyp hajmali, ndez qirinjtë, merr qime të flokëve, lëngë të ngjashëm me ujën, dhe te varrezave, dhe letra me vizatime të pakuptueshme, edhe pse me vendimin e inspektoratit shëndetësor me nr..... i është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë për shkak të mos posedimit të licencës, duke i nxitur dhe duke kërkuar nga personat e ndryshëm të paguajnë shuma të ndryshme të parave dhe me këtë ka arritur që përmes këtij aktiviteti të kundërligjshëm të krijoj të hyra të jashtë ligjshme.

Gjykata faktet e lartëcekura i ka vërtetuar me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor e që sipas gjykatës të gjitha këto prova qoftë personale apo materiale kanë vërtetuar faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, pasi që në rastin konkret i akuzuari H.P në ARBK me dt. ..., ka regjistruar biznesin e tij O “.” ku si aktivitet primar të këtij biznesi ka qenë kodë ..-**aktivitet e tjera te shëndetit të njeriut**, ku si person i autorizuar dhe pronarë – aksionarë ka qenë H.P, **ky fakt vërtetohet përmes provës materiale të administruar në shqyrtimin gjyqësor dhe atë Certifikatës së biznesit me numër .., të dt: .., të azhornuar...**, provë të cilën nuk e konteston edhe vetë i akuzuari H.P. Trupi gjykues vlerëson se i akuzuari me këtë veprim e ka përmbushur detyrimin ligjor për të regjistruar biznesin e tij si institucion privat shëndetësor në organet shtetërore, përkatësisht në ministrinë e Tregtisë dhe industrisë - Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK).

Faktin se i njëjti përmes biznesit të tij ‘**O B.**’ **pa kualifikime profesionale dhe pa licencë përkatëse me pretendim se shëron sëmundje të rënda fizike dhe psikike si: paraliza, distrofinia, epilepsia, gratë sterile etj dhe ndihmon në zgjidhjen e problemeve të ndryshme familjare, në vazhdimësi ka kryer trajtime mjekësore**’ Këtë gjëndje faktike gjykata e vërtetoi me administrimin e provave personale siq është deklarua e të dëmtuarit - dëshmitarit **R.L** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës ..e cila deklarat gjenë përputhje edhe me de3klarimin e tij në procedur paraprake, i cili ka deklaruar se “ *në Sh. doli fjala se H.P shëron të sëmurit nga magjia dhe epilepsia, për të cilin ka dëgjuar prej njerëzve, Face Bookut dhe në emisionin Z.e L., të A.Ç., pasi që vetë është i sëmur me epilepsi nervore, kur ka ardh tek H me dt..., ka qenë i sëmurë i cili i ka thënë se ti do të mbash një dry me çelës, 3 copa vezë, dhe 4 ose 6 qirinjtë të bardhë. Ka shkuar direkt në P tek shtëpia ku e kishte, ka parë shumë njerëz duke pritur, edhe kishte badigardat e vetë, tutje i njëjti ka theksuar se B i ka pyetur për çfarë arsye keni ardhur, të njëjtit janë përgjigjur, se kanë shkuar për problemin e vëllait, për sëmundjen e epilepsisë nervore, dhe H ju ka thënë se unë do të shëroje edhe më ka shkruar terapinë, ia ka dhënë kartën që sa herë të shkoj te ai të shkoj me atë kartelë. Pastaj ka ardhur edhe 2 herë tjera, por ne momentin e parë që kam qenë me vëllain dhe motrën, i njëjtit vetë atij ia ka kërkuar 1000 euro, Ditën e parë kur ka shkuar vetëm ka dëgjuar çka ka thënë, sepse ka qenë i sëmurë, vetëm 5 minuta ka qenë brenda dhe ia ka shënuar te cekurat si me lartë dhe për 1 vite ose 2 vite i ka premtuar që këtë sëmundje do ta largoj, vetë ai prapë është në atë gjendje siç ka qenë, dhe nuk është shëruar’’ Po ashtu faktin se i akuzuari H. P **pa kualifikime profesionale dhe pa licencë përkatëse me pretendim se shëron sëmundje të rënda fizike dhe psikike si: paraliza, distrofinia, epilepsia, gratë sterile etj dhe ndihmon në zgjidhjen e problemeve të ndryshme familjare, në vazhdimësi ka kryer trajtime mjekësore**’ gjykata e vërtetoi edhe nga dëshmia e të dëmtuarës –dëshmitares **H.Sh** të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës .. e cila ka deklaruar se “*herën e parë kur kanë shkuar iu ka dhanë ujë, një qiri me dhez. E njëjta nuk e di çfarë uji ka qenë, qiriun e kemi lënë aty, ndërsa ujën ia ka dhënë me veti me marr, në atë ujë nuk e din se çfarë ka pas, i është dukur si i sahrat. Atë ujë e kanë pi, e ka qitë në gjellë, i kanë la sytë, ndërsa për shije ne ujit nuk din se ka kaluar kohë e gjate kurse kur e kanë qite ne gjellë nuk është vërejtur shija, kanë vepruar ashtu siç i ka udhëzuar B*”. Po ashtu nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit **M. B.** të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës ..vërtetohet fakti se ‘ *për shkak të gjendjes së tij shëndetësore për shkak të dhembjes së kokës ka qenë te B dhe ka shkuar me fëmijë te shpija e tij në P,**

ka menduar që i kanë bërë sehire. Tutje thekson se kur ka shkuar të B e ka stërpik me do ujëra. Aty kur është shkuar ia ka dhanë 300-400 euro, dhe ka qenë veç një herë, dhe nuk i ka ndihmuar kurrëgjë. Nga deshmija e dëshmitarit-dëmtuarit **F.S.** të dhënë në shqyrtim gjyqësor të datës .. vërtetohet fakti se ‘ i njëjti ka qenë te B në vitin 2017 dhe arsyeja pse ka shkuar ka qenë me kërkuar ndihmë, për shëndet, nuk i ka propozuar askush për te shkuar, mirëpo vet ai ka shkuar, e ka gjete në internet. Te H në P, është shkuar me një dhëndër, iu kanë dhanë numra me prit në rend, aty i ka paguar 20 euro në fillim, pastaj kanë hy brenda te B, ia ka bo një kontroll, me do ujë, me njëfarë flake, më ka premtuar që mundet me ndihmuar, dhe i ka thënë mos shko tjetër kund, masë një (1) jave ka shkuar e ka marr një Hajmali, e cila i ka kushtuar 300 euro. Pas një kohe prapë se ka ndi veten mirë, është shkuar prapë, i ka thënë se duhet një hajmali e madhe për krejt shtëpinë, ajo i ka kushtuar 1.200 euro. Tutje shton se ia ka dha do dryna, do ujë mu pastru, do vezë me i shti në zjermë, dhe do letra mi gju nëpër rrugëkryqe. I njëjti ka qenë prapë edhe 3-4 herë, dhe i ka thënë se nuk ka përmirësim, me pastaj ka vazhduar te mejku se gjendja i është keqësuar’ Nga deshmija e dëshmitarit-dëmtuarit **B.K.** të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë .., vërtetohet fakti se ‘ i njëjti ka shkuar te B sepse janë 7 vëllezër, 6 vëllezër i kishte në Gj.i, dhe vetë ai jeton në K., dëshire e tij ishte me dal jashtë shteti po ashtu kisha qejf me u feju, dhe me i hec biznesi mbarë. Ka shkuar te B në P, te shtëpia e tij, letërnjoftimin ia ka marrë punëtori i tij e ka njoftur se duhet me pritë në rend, ka qenë nr.22. Ka pritë në radhë deri në ora 2, ka shkuar në ora 11, ka hyrë brenda, i’a ka kërkuar 20 euro për vizitë, i ka thënë s’ka problem. Më pastaj hini me do flaka, do qikiqa, me qira dhe me thojke mos livrit, dhe ki të bame (MAXHI) prej grusë së axhës. E gruaja axhës që 22 vjet është e vranë në luftë. Vetë ai e ka njoftuar se nuk ka grue tjetër të axhës, jo tha ke më afër, i tregova e kam një plakë kojshike, më ka pyete se a po gjen vezë nëpër oborr, i ka thanë po se po bajnë pulat e kojshive. **I njëjti thekson se i ka thënë se je kopil, dhe nuk jeni vëllezër me ata në Gjermani, dhe baba t’ka marr tjetër kun, ndërsa i ka mbledhur vllazënin dhe i ka pyete se a është vërtet, pasi kjo i është bërë vesvese. B ia ka kërkuar 2.500 euro, me i hec biznesi mare, dhe fejesa me ju bo, i ka rekomanduar me shku me marr do dhe të varreve, qaj njeri që të vdes i pari në X.. Dhe vdiq në kry të javës njani dhe i tregova në telefon B. E mora dheun e varreve dhe 2.500 euro, 5 copa ka 500 euro dhe shkova te B, ma dha një dry të vogël me qel dhe me gju në ujë, tha dheun mbaje në firmë, derisa të vjen ëndrra, dhe andrra s’ka ardhë kurrë dhe vetë ai ka shkuar B dhe i ka tha se kjo punë s’po hecë hiq, i thash kthemi paret, ka thanë me zor nuk te kam shti me ardhë këtu. I njëjti ka shtuar se në vizitën e parë çmimi ka qenë 20 euro por vetë ai, ia ka dhanë 50 euro, me shpresë që po bahet mirë’ Nga deshmija e dëshmitarit **I.N** të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë .., vërtetohet fakti se ‘ se i njëjti i ka dergu 3-4 herë njerëz me veturën e tij njerëz nevojtar tek B, gjatë udhëtimit të shkuarjes dhe kthyerjes krejt ka qenë i informuar çka ka ndodhë, çka i ka marr, çka i ka thënë, edhe ato kanë tregu lloj lloj senesh, fjalësh, sa kanë qëndruar tek ai. P.sh një familje që e ka dërguar, ma përpara e kanë pas një vajzë gjëja për shërim edhe për fillim iu ka marr 20 euro për me i tregu qysh shkon, pastaj i ka thënë se duhet me ja bo një hajmali të vogël e cila kushtojkë 300 euro, shumë prej tyre 3-4 palëve që i ka dërguar, nuk kanë pas sukses me atë, dhe janë detyruar me i dha ka 1.200 euro, tjera për një hajmali më të madhe, që të kenë sukses, rasti që e ka e ka cekur është se ku është ajo vajza, e kanë gjetur me emër dhe numër, dhe e kanë kërcënuar pse nuk keni pru bakshish, dhe i ka tha se nëse nuk e bjen bakshishin ka me ta smu prapë çiken. Vetë ai personalisht ka qenë brenda te B kur jamë shkuar aty te B, në sallën ku presin edhe njerëz tjerë, i kanë dhënë letërnjoftimin dhe është regjistruar miku i tij, dhe ka hyrë brenda me të, pagesën e kanë bërë brenda te B. Të njëjtit i ka pyete kush jeni ju, çka ju mundon, çka punoni, ku jetoni, i ka shkruar do letra dhe ka tha duhet me ja bo një hajmali e cila kushton 300 euro. Të njëjtit i kanë thanë në rregull për puna mos ja prish djalit, se nashti shërohet, dhe ju ka thanë që kur të shkojmë tjetër herë, me i dërguar, vezë, drynin me çelës, qira. Ata ia kanë dërguar tjetër herë, ditët e punës i ka pas të Martën edhe të Premten ditë pune. Gjatë shkrimeve që i ka kryer ja ka dhanë edhe një shishe me ujë, dhe i ka tregu qysh me përdorë atë, por ka harru qysh i ka thënë me përdor. Ja ka maruar hajmalinë dhe këna shkuar prej shpie, drynin i ka thënë gjuajë me një rek. Pastaj janë kthyer në shtëpi, kanë pritë 10 ditë, dhe e kanë thirrë në telefon e kanë njoftuar se djali**

nuk ka sukses, për çka ju ka thanë B hajdeni se duhet tjetër sene me bo një hajmali më të madhe. Dhe ajo hajmali kushton 1.200 euro, ata si kanë pas ato pare, por djali dhe motra e tij kanë tha sa nashti bahet mirë, është deshtë me hy kredi për me i bo ato pare e të cilat ja kanë dërguar Bt, e për çka nuk ju ka lëshuar asnjë faturë, na ka pështjell hajmalinë dhe kemi shkuar në shpi. **B i kanë treguar se kanë qenë te doktori, por ai ka thënë se unë jam këtu që i kry këto punë.** Këta e ka tha edhe me një TV, që ka qenë me hoxhën Behar Mjekiqi, dhe me një doktor, i cili ka deklaruar se unë jam baba, se shkojnë pacientet te hoxha te mjeku, por masrami vinë te unë dhe i shëroj. Me tej i njëjti ka theksuar se Fatmiri i ka marrë paret kredi me ia dërguar Bt, i njëjti ka besuar në shërim përmes magjive e për këtë arsye ka insistu me shku' Nga deshmija e dëshmitarit **R. E.** të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë .., vërtetohet fakti se'' i njëjti ka punuar tek O.B si punëtor i thjeshtë ka mbajtur rendin, ka regjistruar pacientet, ka pastruar parkingun, vendin, në shpi oborrin etj... i njëjti nuk ka punuar rregullisht, ka punuar të Martën të Premten dhe ku ka pas nevojë. Gjatë atyre dy ditëve kanë qenë diku 15-20 paciente, deri në 50 pacient'' Nga deshmija e dëshmitarit **B.K** të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë .., vërtetohet fakti se'' ka pas kontakte një herë me H.Pn dhe ka qenë se bashku me shoqen e tij. Arsyja pse ka shkuar ka qenë se vëllai i tij ka një djalë me probleme shëndetësore-me të meta, dhe në pamundësi të ardhjes së tij, çdo 2-3 muaj me u lajmëruar. Një herë ka shkuar vetë vëllai një herë ka shkuar vetë ai. Aty ka qenë një pritore, që është dashur me shkuar në ora 6, ku ka paritë deri në ora 9-10, pastaj kanë hyrë brenda me nusen e tij, aty ka qenë një dhomë e errët vetëm ku kanë qenë 3-4 tv me video non stop duke dëgjuar raste të mëhershme, një mënyrë e mirë me na bind që po punon me i shëruar njerëzit, disa kartela të vogla ju ka dhanë me shkrim gjuhën që se kisha pa kurrë, dhe përmes prindërve i'a ka dërguar vëllait në Zvicër. Tutej thekson se vetë ai nuk ka paguar diçka por vëllai i tij herën e parë ka paguar 2.000 euro, pasi i ka premtuar se brenda 6 muajsh djali ka me ec dhe ka me fol, djali i tash i ka 12-13 vjet, dhe se është njëjtë pa asnjë ndryshim. Me tej shton se për emrin e Bt ka dëgjuar para 6-7 vite ku ka pasur një rast miku i tij i cili ka pasur djalin diçka me probleme më të vogla''. Nga analizimi i këtyre dëshmive të lartëcekura pamëdyshje gjykata vërteton faktin se i akuzuari H.P, në vazhdimësi ka kryer trajtime mjekësore tek persona të ndryshëm dhe të njëjtit i udhëzon, shtyp hajmali, ndez qirinjtë, merr qime të flokëve, lëngë të ngjashëm me ujin, dhe te varrezave, dhe letra me vizatime të pakuptueshme pa pasur kualifikime profesionale dhe pa licencë përkatëse duke vepruar në kundërshtim me Ligjin ka kryer trajtime mjekësore.

Faktin se i akuzuari ka kryer këtë vepër penale **Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Shëndetësi Ligji nr. 04/L-125 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin për shëndetësi nr. 08/L-043, duke reklamuar veprimtarin e tije përmes shtypit duke shtypur vizitë- karta me adresë dhe telefonin e vet, në derën e hyrjes në zyrën e tij mban mbishkrimin "M." me pretendim se shëron të sëmurit me barna popullore, dhe udhëzon personat të ndryshëm, shtyp hajmali, ndez qirinjtë, merr qime të flokëve, lëngë të ngjashëm me ujin, dhe te varrezave, dhe letra me vizatime të pakuptueshme, duke i nxitur dhe duke kërkuar nga personat e ndryshëm të paguajnë shumën të ndryshme të parave e vërtetoi edhe provat materiale siq janë **Vendimi i Ministris së Shëndetësisë, me nr. ... i dt...**, me të cilin vendim të njëjtit i është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë shëndetësore të institucionit privat shëndetësor O "B" për shkak se nuk posedon autorizim ligjor gjegjësisht licencë për ushtrimin e kësaj veprimtarie, duke vepruar në kundërshtim me nenin 42 të Ligjit për Shëndetësi Ligji nr. 04/L-125 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin për shëndetësi nr. 08/L-043, pasi që sipas këtij ligji për të ushtruar në mënyrë të ligjshme veprimtari shëndetësore, institucioni përkatës duhet të paiset me autorizim ligjor gjegjësisht licensë valide të lëshur nga Ministria e Shëndetësisë, po ashtu gjykata në bazë të **Raportit të inspektimit nga Inspektoriati Shëndetësor të Kosovës me nr. Ref ... të dt...si dhe Procesverbalit mbi inspektimin e bërë nga Inspektoriati Shëndetësor i Kosovës me nr... i dt; ..**, të shoqëruar së bashku me fotografi të vendit të ngjarjes në O. B nga e cila provë vërtetohet se i akuzuari ka reklamuar veprimtarin e tij përmes shtypit ka shtypur vizitë- karta me adresë dhe telefonin e vet, në derën**

e hyrjes në zyrën e tij mban mbishkrimin "M." me pretendim se shëron të sëmurit me barna popullore, dhe udhëzon personat të ndryshëm, shtyp hajmali, ndez qirinjtë, merr qime të flokëve, lëngë të ngjashëm me ujë, dhe te varrezave, dhe letra me vizatime të pakuptueshme, edhe pse me vendimin e inspektoratit shëndetësor me nr... i është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë për shkak të mos posedimit të licencës, nga fotoalbumi nga njësia e forenzikes, me nr. të dosjes .. i datës .. , në fotot 1,2 3, 4, janë evidentuar pamje të shtëpisë së të akuzuarit në të cilën gjendet edhe O.B ku shihet qartë pllaka e vendosur në hyrje të ordinancës në të cilën përcaktuar orari i punës, në ditë dhe orë, si dhe numri i telefonit për kontakte, po ashtu shihen qartë edhe mbishkrime te tjera në mur ku përcaktohen kushte qe duhen tju përmbahen pacientët qe kanë frekuentuar ordinancën në fjalë. Po ashtu në fotot nr. 5,6 ,23, 24, 25 dhe 35 janë të paraqitura mjetet e punës së të akuzuarit me të cilat i njëjti ka ndërmarrë veprimtarin e tij shëndetësore ndaj pacientëve, të tilla si vezë, qirinjë, shishe me lëngje në pamje si ujë dhe me mbishkrime të padeshifrueshme, markera ,kimika, gërshër, hajmalitë të shkruar në copa letrash, zhivë, qime flokësh, vula përkatës që e ka përdorur në veprimtarinë e tij, fotografi të pacienteve e po ashtu në shkresa të lëndës gjenden edhe fotografi të zyrës së të akuzuarit ku në hyrje, në derën e zyrës, gjendet nje pllakë me mbishkrimin "M" duke pretenduar se i njëjti ofron shërbime mjekësore.

Gjykata duke analizuar dispozitën e vepërs penale, Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 262 par.1 të KPRK-së, e cila përcakton se *'Kushdo që pa pasur kualifikimet profesionale apo autorizimet ligjore, kryen trajtime mjekësore, shërbime farmaceutike ose angazhohet në aktivitete tjera mjekësore për të cilat me ligj kërkohen kualifikime të posaçme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit'* sipas analizës të kësaj dispozite, trajtimin mjekësor ose angazhimin në aktivitete të tjera mjekësore nuk mund ta ofrojnë personat të cilët nuk posedojnë kualifikime profesionale apo autorizime ligjore ngase një veprimtari e tillë mund të jetë një formë e mashtrimit dhe atëherë ekziston rreziku real për shëndetin e njerëzve. Duhet pasur parasysh se veprimet me të cilat kryhet kjo vepër penale legjislacioni i parasheh në mënyrë alternative e më konkretisht kur kryerja e trajtimit mjekësor bëhet *pa pasur kualifikime profesionale apo autorizime ligjore; si dhe kur bëhet kryerja e aktiviteteve tjera mjekësore për të cilat me ligj kërkohet kualifikim i posaçëm.* Gjykata vlerëson faktin se me trajtim mjekësor nënkuptojmë ndërmarrjen e të gjitha atyre masave të cilat në shëndetësi i kryejnë personat të cilët kanë mbaruar fakultetin e mjekësisë që do të thotë, të njëjtët bëjnë caktimin e diagnozës dhe përshkrimin e terapisë. Kryerës i kësaj vepre penale nga neni 262 par. 1 të KPRK-së mund të jetë vetëm personi i cili nuk ka kualifikime profesionale apo autorizim ligjor për trajtim mjekësor apo për kryerje të aktiviteteve tjera mjekësore për të cilat kërkohet me ligj kualifikim i posaçëm dhe se kjo vepër penale do të konsiderohet e kryer edhe nëse është kryer qoftë edhe vetëm një trajtim mjekësor ose vetëm një angazhim tjetër mjekësor, nga personi i cili nuk posedon kualifikim profesional apo autorizim ligjor dhe se nuk është e rëndësishme për ekzistimin e veprës nëse trajtimi mjekësor ose angazhimi mjekësor është i suksesshëm ose i pa suksesshëm për shëndetin personit ndaj të cilët është bërë trajtimi apo angazhimi i kundërligjshëm pa marrë parasysh se a janë shkaktuar pasoja të dëmshme për shkak të mjekimit nga personat që nuk i kanë kualifikimet e duhura, për gjykatën është e rëndësishme që personi jokompetent të kentë ndërmarrë veprimin përkatës.

Duke ju referuar dispozitave te veçanta shëndetësore e përkatësisht Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin për shëndetësi nr. 08/L-043,' neni 42, parasheh se sa i përket licencimit të gjitha institucionet shëndetësore mund të fillojnë punën vetëm pas licencimit nga Ministria e Shëndetësisë (nga tani Ministria) ose nga organi i autorizuar prej saj, në pajtim me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria, që përcakton kushtet specifike për punë sa i përket: hapësirës, kuadrin profesional, dhe pajisjeve medicinale. Licencimi i institucioneve shëndetësore do të zbatohet në pajtim me planet, normativat, dhe standardet e përcaktuara nga Ministria. Me rastin e aplikimit për licencë, institucioni shëndetësor duhet të deponoj aktin e themelimit, për të cilin paraprakisht ka dhënë pëlqim Ministria. Në

rast të licencimit të institucioni atherë bëhet akreditimin e institucioneve të licencuara shëndetësore e bënë organi i autorizuar nga Ministria në pajtim me aktin përkatës nën-ligjor. Gjykata bën me dije se vepra penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 262 i KPRK-së kryhet vetëm me dashje. Sipas teorisë juridike dashja (dolus) konsiderohet forma më e rëndë, më tipike dhe forma më e shpeshtë e fajit me të cilën kryhen veprat penale. Vepra penale konsiderohet se është kryer me dashje kur kryesi ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vet dhe ka dashur që ta kryejë, apo kur ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të veprimit apo mosveprimit të tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar, por e ka pranuar, është dakorduar që të shkaktohet ajo pasojë. Dashja qoftë direkte apo eventuale karakterizohet nga dy elemente, përkatësisht *elementi i vetëdijes (elementi intelektual) dhe elementi i vullnetit (elementi i dëshirës)*. *Elementi i vetëdijes* (intelektual), në kuadrin e dashjes shprehet në rastet kur kryesi është i vetëdijshëm, e di, ka përfytyrim të qartë për veprën që e kryen dhe pasojat që do të shkaktohen nga ajo vepër dhe për lidhjen kauzale midis veprës dhe pasojës që do të shkaktohet. *Elementi volitiv* apo i dëshirës (i vullnetit) është komponent i dytë e dashjes. Ky element shprehet atëherë kur kryesi ka dashur, ka dëshiruar që me veprimin apo mosveprimin e vet të shkaktojë pasojën e caktuar. Konsiderohet se personi e ka dëshiruar kryerjen e veprës kur ndërmerr veprimin me qëllim që të shkaktojë pasojën, e cila është tipar i veprës penale të caktuar. Nga sa u tha me lart, në rastin konkret i akuzuari duke vepruar me dashje ka qenë i vetëdijshëm se me veprimet e tij ka qenë duke ushtruar veprimtari shëndetësore të kundërligjshme pasi që sic edhe u cek më lart i njëjti nuk ka poseduar license valide të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë për të ushtruar veprimtarinë e tij, po ashtu i njëjti ka qenë i vetëdijshëm se nuk i ka poseduar kualifikimet profesionale përkatëse për të ushtruar veprimtari mjekësore, megjithatë i akuzuari ka vepruar në kondërshtim me ligjin dhe pa kualifikime profesionale me pretendimin se shëron sëmundje të rënda fizike dhe psikike si paralizën, distrofinine, epilepsinë, gratë sterile si dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme familjare. Për më tepër i akuzuari ka konsumuar edhe elementin volitiv të dashjes pasi që pasoja e dëshiruar nga veprimtaria e tij ka qenë pikërisht përfitimi i dobisë pasurore në rastin konkret e fituar në mënyrë të kundërligjshme. Te veprat penale që kryhen me dashje, shpesh kërkohet që kryesi të ketë vepruar me qëllimin dhe motivin e caktuar. Qëllimi është përfytyrim mbi pasojën e veprës penale, apo mbi ndonjë rrethanë tjetër që është e rëndësishme për të drejtën penale. Me fjalë të tjera, qëllimi ekziston kur përfytyrimi mbi pasojën apo mbi ndonjë rrethanë tjetër, që është relevante për të drejtën penale, ka qenë motiv i vendimit, në bazë të të cilit është ndërmarrë veprimi i kryerjes. Çdo vepër penale që kryhet me dashje, supozohet se është kryer me qëllim të caktuar dhe se kryesi i veprës që vepron me dashje ka përfytyrim të qartë se me veprimin apo mosveprimin e tij do të arrijë qëllimin e caktuar. Gjykata vlerëson se i akuzuari ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme me qëllim të përfitimit të vlerave të ndryshme monetare të cilat i njëjti ju a ka kërkuar në mënyrë të drejtë për drejtë të dëmtuarve të cilët kanë frekuentuar dhe kanë kërkuar zgjidhje të problemeve shëndetësore fizike dhe psikike të tyre në ordinancën “B”. Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi nga deklaratat e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve të cilët përgjatë shqyrtimit gjyqësor kanë deklaruar si në vijim: dëshmitari-i dëmtuari **R.L** në shqyrtim gjyqësor të datës .. ka deklaruar se “ *H ia ka kërkuar 1000 euro, dhe për 1 vite ose 2 vite i ka premtuar që këtë sëmundje do ta largoj*”, e dëmtuara –dëshmitarja **Z.M** në shqyrtimin gjyqësor të datës .. ka deklaruar se “ *i ka thënë se kur e ka qelë dosjen kjo kushton shtrejtë por puna ka me u rregullu, duke i thënë pse ju të jashtit që vini prej Z. është marre me ardh pa 20 mijë euro këtu, i ka thënë se duhet me i paguar 2.000 euro, nëse don që djali dhe nusja me qenë bashke gjithmonë*”, i dëmtuar-dëshmitari **D.Z** në shqyrtim gjyqësor të datës .. ka deklaruar se ‘ *gjënë e parë që ju ka kërkuar ka qenë pagesa prej 1.000 euro, ka vazhduar me ritet e tij, na ka thanë që ta blejmë një dry që të hedhim në ujë, edhe me i dhezë qira për me u lutë për ata persona që të bashkohen, kjo pagesa prej 1.000 euro ka qenë e përbashkët mes neve dhe familjes së vajzës*” ndërsa ‘ *pasi që ka qenë 7 herë, çdo vizitë i kanë paguar 20 euro, për familje, 40 euro i kemi paguar bashke me familjen e vajzës*’, e dëmtuara –dëshmitarja **H.Sh** në shqyrtimin gjyqësor të datës .. ka deklaruar se “ *fillimisht 20 euro, i ka dhanë të ata djemtë jashtë, kurse shumë e madhe ia ka dhan brenda B*”, “ *Për motrën i ka caktuar shumë 1000 euro, kinse e*

shëndoshi djalin, dhe për herën e dytë i njëjti i ka kërkuar 1000 euro, e njëjta ia ka dërguar këto pare, motra e ka shit arin për t'ia dërguar H. Ndërsa për vetë atë ia ka caktuar shumën 500 euro, herën e dytë ia ka kërkuar 500 euro”, i dëmtuari -dëshmitari **M.B** në shqyrtim gjyqësor të datës .. ka pohuar se ‘kur ka shkuar të B e ka stërpik me do ujëra ia ka dhanë 300-400 euro’, i dëmtuari-dëshmitari **F. S.** në shqyrtim gjyqësor të datës .. ka deklaruar se “te H, është shkuar me një dhëndër, iu kanë dhanë numra me prit në rend, aty i ka paguar 20 euro në fillim, pastaj kanë hy brenda, ia ka bo një kontroll, me do ujë, me njëfarë flake, më ka premtuar që mundet me ndihmuar, dhe i ka thënë mos shko tjetër kund, masë një (1) jave ka shkuar e ka marr një Hajmali, e cila i ka kushtuar 300 euro. Pas një kohe prapë se ka ndi veten mirë, është shkuar prapë, i ka thënë se duhet një hajmali e madhe për krejt shtëpinë, ajo i ka kushtuar 1.200 euro”, i dëmtuari-dëshmitari **B.K.**, në shqyrtimin gjyqësor të datës ... ka deklaruar se ” ka hyrë brenda, i'a ka kërkuar 20 euro për vizitë, ndërsa B ia ka kërkuar 2.500 euro, me i hec biznesi mare, dhe fejesa me ju bo”, dëshmitari **I.N** në shqyrtim gjyqësor të datës .. ka dëshmuar se “ një familje që e ka dërguar, ma përpara e kanë pas një vajzë gjëja për shërim edhe për fillim iu ka marr 20 euro për me i tregu qysh shkon, pastaj i ka thënë se duhet me ja bo një hajmali të vogël e cila kushtonë 300 euro, shumë prej tyre 3-4 palëve që i ka dërguar, nuk kanë pas sukses me atë, dhe janë detyruar me i dha ka 1.200 euro, tjera për një hajmali më të madhe, që të kenë sukses,..i njëjti ka shtuar se edhe një rast e di kur një familje ka pas me martu djalin për me vazhdu me shku puna e mirë, dhe mos me ju bo kurgjo, aty i kanë paguar 1.000 euro”, “ fillimisht ja ka marr 20 euro për vizitë. Kur janë shkuar aty te B, në sallën ku presin edhe njerëz tjerë, i kanë dhënë letërnjoftimin dhe është regjistruar miku i tij, dhe ka hyrë brenda me të, pagesën e kanë bërë brenda te B. Të njëjtit i ka pyete kush jeni ju, çka ju mundon, çka punoni, ku jetoni, i ka shkruar do letra dhe ka tha duhet me ja bo një hajmali e cila kushton 300 euro”, ndërsa në rastin vijës “Pastaj janë kthyer në shtëpi, kanë pritë 10 ditë, dhe e kanë thirre në telefon e kanë njoftuar se djali nuk ka sukses, për çka ju ka thanë B hajdeni se duhet tjetër sene me bo një hajmali më të madhe. Dhe ajo hajmali kushton 1.200 euro, ata si kanë pas ato pare, por djali dhe motra e tij kanë tha sa nashti bahet mirë, është deshtë me hy kredi për me i bo ato pare e të cilat ja kanë dërguar Bt”, si dhe nga dëshmia e dëshmitari **B.K i cili** në shqyrtim gjyqësor të datës .. ka dëshmuar se “ se vetë ai nuk ka paguar diçka por vëllai i tij herën e parë ka paguar 2.000 euro, pasi i ka premtuar se brenda 6 muajsh djali ka me ec dhe ka me fol, djali”. Gjykata vlerëson se të gjithë këta dëshmitar vërtetoin bindshëm faktin se se për trajtimin e tyre në ordinancën B, kanë paguar shumën në vlera të ndryshme sic u cekën edhe me lart ngase këto deklarata nuk kanë kundërthënie në mes vete, përkundër kësaj të gjithë të dëmtuarit dhe dëshmitarët kanë deklaruar bindshëm.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha provat e proceduara, faktet dhe rethanat e vërtetura në shqyrtim gjyqësor, dëshmitë e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve të cilët bindshëm vërtetojnë se i akuzuari H.P me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, me dashje ka vepruar pa kualifikime profesionale dhe pa licencë përkatëse me pretendim se shëron sëmundje të rënda fizike dhe psikike, po ashtu në vazhdimësi ka kryer trajtime mjekësor në ordinancën B, në derën e hyrjes në zyrën e tij ka vendosur mbishkrimin “Mjeku” me pretendim se shëron të sëmurit me barna popullore, dhe udhëzon personat të ndryshëm, shtyp hajmali, ndez qirinjtë, merr qime të flokëve, lëngë të ngjashëm me ujin, dhe te varrezave, dhe letra me vizatime të pakuptueshme, edhe pse me vendimin e inspektoratit shëndetësor i është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë për shkak të mos posedimit të licencës, duke i nxitur dhe duke kërkuar nga personat e ndryshëm të paguajnë shumën të ndryshme të parave dhe me këtë ka arritur që përmes këtij aktiviteti të kundërligjshëm të krijoj të hyra të jashtë ligjshme, duke konsumuar të gjithë elementët e veprës penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike nga neni 262 par 1 të KPRK-së, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke i analizuar provat personale dhe materiale të cilat i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor i ka vlerësuar si prova të pranueshme andaj i ka administruar si të tilla, të cilëve kjo gjykatë u kushtoi

besim të plotë, e të cilat qojnë gjykatën në konkludim se besueshmëria në to dhe shkalla e arsyesh mërisë me rrethanat e konkrete të rastit, në mënyrë të padyshtimtë vërtetojnë që i akuzuari ke kryer veprën penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, për të cilën akuzohet.

Gjykata deklarimeve të të dëmtuarve-dëshmitarëve të dhënë në shqyrtimin gjyqësor si dhe deklarimeve të tyre të dhëna në procedurën paraprake, për këto rrethana të ngjarjes të cekura si më lartë, këtyre provave ua ka falur besimin e plotë. Që të gjithë këta të dëmtuar- dëshmitar për sa i përket këtyre fakteve relevante rreth kësaj pjese të zhvillimit të ngjarjes nuk kanë në vetvete shpërpushje të mëdha për faktet vendimtare, që do ta bënin gjykatën për ta ulur besueshmërinë ndaj këtyre dëshmitarëve, nga ana tjetër të gjithë këta dëshmitar kanë qenë objektiv në deklaratimet e tyre, ku objektiviteti i tyre shifet si në procedurën paraprake ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor sa i përket kësaj pike të aktakuzës, ka konstatuar se pretendimi është dhënë në drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale, kjo pasi që është në kundërshtim të plotë me provat materiale dhe personale të cilat i ka bashkangjitur prokuroria në aktakuzë e të cilat gjykata i dha besim të plotë, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit dhe të akuzuarit se kinëse “ *H.P në certifikatën e biznesit O.Bnr... ka pasur te regjistruar aktivitetet biznesor në lëmin e shëndetit. Mirëpo qëllimi i këtij regjistrimi të këtij aktiviteti nuk ka qenë venja në lajthim te personave dhe as qëllimi për ushtrimin e aktivitetit mjekësor. Tuje kanë theksuar se të gjithë dëshmitarët e lartcekur një nder arsyet e shkuarjes tek H.Pi kanë pasur problemet e ndryshme mjekësore apo sociale si dhe mungese se fatit ne jete dhe te gjithë pa dallim kane deklaruar se H.P nuk ju ka dhëne barna, këshilla mjekësore dhe dietike, trajtime kirurgjike apo trajtime te cilat konsiderohen si veprimtari mjekësore sipas ligjit, palët e dëmtuara dhe dëshmitaret qe kane dëshmuar për problemet familjare, sociale apo te fatit te keq te gjithë po ashtu pa dallim nuk ka vërtetuar faktin se H.Pju ka bere trajtime mjekësore. Tutje kanë shtuar se arsyeja e regjistrimit te biznesit “**B”me fjalën O nuk ka qen me qellim te ushtrimit te veprimtarise mjekesore, ashtu sic definohet sipas ligjit per shendetesi, por, qe besimi fetar i H.P qe perfshine dhe sherimin shpirtesor alternativ dhe qe e njej Ligji i Shndetesise sipas nenit 3.1.41, sipas nenit 3 paragrafi 1 nenparagrafi 1.41 te LSH eshte percaktuar se Trajtimi para-mjekësor dhe alternativ - metodat e trajtimit që janë të regjistruara nga shoqatat profesionale; dhe që duke qenë se nuk janë në pajtim me doktrinën aktuale mjekësore nuk përfshihen në shërbimet zyrtare shëndetësore, ne kete drejtim H.P ne vitin .., i eshte drejtuar Ministrise se Shendetesise perms kerkese nr. 05 -4631, te zgjerimit te numeklatures se veprimtarise se mjekesise popullore alternative me qellim qe te ushtroj veprimtarin time, i njejti ne kete shkres te vjeter me shume se 12 vite me tej ka shrkuar, citoj “..... veprimtarine tani e kame te regjistruar nen shifren .. si veprimtari te tjera te mjekesise sociale si dhe shifren .. te veprimtarise time se sherbimeve sociale te organizmave drejtues qe merren me shendetin, arsimin, kulturen etj... mirepo, edhe pse e kam te regjistruar biznesin tim ne shifrat e permendura te veprimtarise theksoj se shifrat e lartshenuara nuk I pergjigjen veprimtarise time te cilen e ushtroj, perkatesisht, nuk i pergjigjen mjekesise popullore alternative..”, me tej i njejti ne kete shkres ka theksuar,citoj “..... kerkea e parashtrroj me qellim qe veprimtaria mjekesise popullore alternative te kete kodin e vecante te veprimtarise per licencimnn e saj ne menyre qe veprimtaria ime te mos perzihet me ate te mjekesise se rregulte shendetesore, por, vetem mjekesise popullore alternative shpireterre....”, me tej i njejti ka shkruar, citoj” Njerezit shpirtorisht I kame sheruar ”. Pra ne baze te provave te lartcekura pa dyshim vërtetohet fakti se H.P nuk ka ushtruar veprimtari mjekesore, ne menyre te vecante ne drejtim te palëve deshmitare dhe te dëmtuara, regjistrimin e biznesit O B. nuk e ka bere me qellim te ushtrimit te veprimtaris mjekesore apo per te i ngatrruar personat e trete per veprimtarinë e tij, ka kërkuar qe veprimtaria e tij e lejuar sipas ligjit te rregullohet ne menyre me specifike qe te regjistroj veprimtarinë ekonomike qe i pergjigjet aktivitetit te tij, mirëpo, ne baze te fakteve te***

*lartcekura ne asnjë formë nuk vërtetohet se i mbrojturi im ka kryer ndonjë element te figurës se veprës penale Ushtrim i Kunderligjshem i Veprimtarise Mjekesore sipas nenit 262 par 1 te KPK -së. i hodhi poshtë si të pa besueshme, për faktin se i akuzuari H.P, në rastin konkret ka qenë i vetëdijshëm se me veprimet e tij ka ushtruar veprimtari shëndetësore të kundërligjshme pasi që i njëjti nuk ka poseduar **license valide të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë për të ushtruar veprimtarinë e tij**, po ashtu i njëjti ka qenë i vetëdijshëm se **nuk i ka poseduar kualifikimet profesionale përkatëse për të ushtruar veprimtari mjekësore**, megjithatë i akuzuari ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe pa kualifikime profesionale me pretendimin se shëron sëmundje të rënda fizike dhe psikike si paralizën, distrofinine, epilepsinë, gratë sterile si dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme familjare. Për më tepër i akuzuari ka konsumuar edhe elementin volutiv të dashjes pasi që pasoja e dëshiruar nga veprimtaria e tij ka qenë pikërisht përfitimi i dobisë pasurore në rastin konkret e fituar në mënyrë të kundërligjshme.*

Gjykata vlerëson se i akuzuari ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme me qëllim të përfitimit të vlerave të ndryshme monetare të cilat i njëjti ju a ka kërkuar në mënyrë të drejtë për drejtë të dëmtuarve të cilët kanë frekuentuar dhe kanë kërkuar zgjidhje të problemeve shëndetësore fizike dhe psikike të tyre në ordinancën “B” dhe ky fakt është vërtetuar nga dëshmit e të dëmtuarëve-dëshmitarëve dhe provave materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësorë e të cilave dëshmi gjykat ju a fali besimine plotë ngase këto deklarata të këtyre dëshmitarëve nuk kanë kundërthënie në mes vete, përkundër kësaj të gjithë të dëmtuarit dhe dëshmitarët kanë deklaruar bindshëm se për trajtimin e tyre në ordinancën B, kanë paguar shuma në vlera të ndryshme sic u cekën edhe me lart.

II.

Gjyakta pas procedimit të provave të provave materiale dhe dëgjimit të dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht me njëra-tjetrën, në kuptim të nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së, kjo gjykatë ka vërtetuar se ka prova se i akuzuari H.Pka kryer veprën penale **Mashtrimit në vazhdimësi nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vërtetua se i akuzuari H.Pnë kohë dhe vendin e cekur si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi me qëllim të përfitimit të pasurisë në mënyrë të kundërligjshme me anë të paraqitjes së rreme të fakteve se kinse posedon aftësi të jashtëzakonshme ashtu që shëron edhe sëmundjet më të rënda fizike dhe psikike, në vazhdimësi ka vënë në lajthim të dëmtuarit të cilët kanë kërkuar ndihmë prej tij mes tyre edhe Z.M, H.Sh,F.S,B.K,B,M.B,B.K,dhe R.Lduke i nxitur dhe kërkuar që për shërbimet e tij ti paguajnë shumat të ndryshme të parave nga 20 euro e deri në shumën prej 3000 euro, duke përfituar shumën e parave në vlerë të përgjithshme prej mbi 10.000 euro.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha provat e procedurara, faktet dhe rrethanat e vërtetuara në shqyrtim gjyqësor si dhe analizimit të provave personale dhe materiale gjeti se i akuzuari me anë të paraqitjes së rreme të fakteve se kinse posedon aftësi të jashtëzakonshme ashtu që shëron edhe sëmundjet më të rënda fizike dhe psikike, në vazhdimësi ka vënë në lajthim të dëmtuarit duke ju premtuar qe shëron sëmundjet e rënda fizike dhe psikike. Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi me deklarinimin e të dëmtuarit-dëshmitarit **R. L.**të dhënë në shqyrtim gjyqësor ku i njëjti ka theksuar se “ *B i ka pyetur për çfarë arsye keni ardhur, të njëjtit janë përgjigjur, se kanë shkuar për problemin e vëllait, për sëmundjen e epilepsisë nervore, dhe H ju ka thënë se unë do të shëroje edhe më ka shkruar terapinë, ia ka dhënë kartën që sa herë të shkoj te ai të shkoj me atë kartën”* si dhe “*për 1 vite ose 2 vite i ka premtuar që këtë sëmundje do ta largoj, vetë ai prapë është në atë gjendje siç ka qenë, dhe nuk është shëruar”*. Këtë fakt gjykata e vërtetoi edhe nga deklarata e të dëmtuarës dëshmitares **Z.M** e cila ka pohuar se “*Kur ka hyrë brenda H e ka pyetur për çka keni ardhë, ia ka treguar hallin pse është shkuar, duhet me i paguar 2.000 euro, nëse don që djali dhe nusja me qenë bashke gjithmonë, dhe tash një vite do të vin me bebe të tyre pas një viti edhe pse e njejeta me vete kishte marr vetëm 100 euro, H i ka thënë se qoftëse s’ke pare me veti ka banka ku mundesh me i nxjerr, para se me dal te burri përjashta më i ka thënë ktheve te do televizione të*

vogla me kqyrë ato gjërat, dhe pas atij momenti edhe me mijra franga me pas ja kisha dhanë se ashtu jam ndërë. Ne ato ekrane ka pa njerëz si unë që kanë shkuar me kërkuar ndihmë dhe arsyeja ka qenë se vetë nuk e di pse është ndërë ashtu, që me pas pare krejt ja kisha dhon, në ato ekrane kam parë një vajzë të sëmur me të meta, dhe njerëz tjerë, nuk është koncentruar shumë me këqyr sepse ka humbur në ato momente''. Po ashtu këtë fakt gjykata vërtetoi edhe nga dëshmia e të dëmtuarës –dëshmitares **H.Sh** të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, e cila ka pohuar se '' ka menduar që po shkon tek një person fetar, i cili përmes hajmalive të shëron, dhe ky ka qenë një mashtrim shumë i madhe. Kur kanë hy te B i njëjti ju ka premtuar se do të ju ndihmoj dhe do të bëhet mirë për ty dhe motrën, dhe ato kanë shpresuar që po i ndihmon, që djali ka me u shëruar dhe punët kanë mu ndreq. E gjitha kjo ka ndodhë duke besuar që me n'dojë maxhi do ti ndihmon, nuk e kanë ditë se a është mjek apo çka është, por nuk është mirë me i mashtruar njerëzit, dhe ndjehet e mashtruar''. I dëmtuari dëshmitari **M.B** në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar '' H nuk i ka ndihmuar kurrëgjë, për këtë e ka lajmëruar rastin në Prokurori, ndërsa lidhur me vesveset i ka thënë qe e ki prej sehireve''Gjykata vërtetoi faktin edhe nga dëshmia e dëshmitarit-dëmtuarit **F. S.** të dhënë në shqyrtim gjyqësor i cili ka deklaruar se '' H, i ka premtuar që mundet me ndihmuar, dhe i ka thënë mos shko tjetër kund, ka menduar qe ka me ndihmu shumë, pasi qe përmes ritualeve ka më e shëruar kështu ka besuar''. Po ashtu këtë fakt gjykata e vërtetoi edhe me dëshminë e të dëmtuarit- dëshmitarit **B.K.**, të dhënë në shqyrtim gjyqësor me i cili ka pohuar se '' H hini me do flaka, do qikiqa, me qira dhe me thojke mos livrit, dhe ki të bame prej grusë së axhës...i ka thënë se je kopil, dhe nuk jeni vëllezër me ata në Gjermani, dhe baba t'ka marr tjetër kun, ndërsa i ka mbledhur vllazënin dhe i ka pyete se a është vërtet, pasi kjo i është bërë vesvese. Për ti hec biznesi mare, dhe fejesa me ju bo, i ka rekomanduar me shku me marr do dhe të varreve, qaj njeri që të vdes i pari në Xërxe. Dhe vdiq në kry të javës njani dhe i tregova në telefon B. E mora dheun e varreve dhe shkova te B, ma dha një dry të vogël me qel dhe me gju në ujë, tha dheun mbaje në firmë, derisa të vjen ëndrra, dhe andrra s'ka ardhë kurrë dhe vetë ai ka shkuar B dhe i ka tha se kjo punë s'po hecë hiq.. po ashtu në ditën e parë i ka tha se jam kopil, dhe unë e kam pyetur nënën, me fjalët e tij ka pasur problem me vëllain, më ka thënë se qysh të mashtroj ky njeri, qe brenda 30 dite keni me marr vajzën me letra, me pasuri të pafundme. Gjykata vërtetoi faktin edhe nga dëshmia e dëshmitarit **D.Z** të dhënë në shqyrtim gjyqësor i cili ka theksuar se '' në hyrje të objektit ku B punojkë ka qenë një vend me pritë në radhë, ka qenë një TV gjatë gjithë kohës ka pas video, incizimet të tij me çdo lloj njeri e ka pa aty, u përsëritshin disa herë, ka parë gjera duke i ndihmuar, tu u bashku persona, për persona që kanë qenë në depresion, e i cili i ka shëruar ata, aty kanë qenë të paraqitura sukseset e tij..në bazë të premtimeve që ky ju ka jep,pra me premtimet e tij i ka bindë, që ky problem do të zgjidhet, por sot e asaj dite nuk ndodhi ajo që ata kanë dashtë, andaj arsyeja pse kanë shkuar te B se kanë besuar dhe premtimi ka qenë se do të rregullohet kjo punë, si orator i suksesshëm me premtimet dhe bindjet e tij gjithmonë i ka bindë që do të bëhet mirë, i njëjti ju ka thënë se kam x raste të tilla që kam pas sukses, në momentin kur janë zhgënjyer ka qenë kur ne kemi vepruar në bazë të udhëzimeve të tij dhe pas atyre muajve nuk po shkon kurrëgjë ska përmirësimi, dhe ata dy persona nuk janë bashkuar kurrë, premtimin e dhënë nuk e ka realizuar''. Nga këto dëshmit e lartëcekura pamëdyshje gjykata vërteton faktin se i akuzuari H.P të njëjtit i ka mashtruar duke ju premtuar- garantuar se do ti shëron nga sëmundjet të rënda fizike dhe psikike, duke qenë i vetëdijëshëm se nuk posedon kualifikimet profesionale për të arritur një rezultat të tillë.

Faktin se i akuzuari ka kryer vepën penale Mashtrimin në vazhdimësi nga neni 335 par.2 të KPRK-së, ashtu siç pretendon prokurori në aktakuzë, vërtetohet edhe nga provat materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat janë pjesë e lëndës, siç janë **Transkriptet e përgjimeve**: nga kjo provë vërtetohet fakti se i akuzuari gjatë bisedave përmes telefonit me pesona të ndyshem i ka venë në lajthim kinse posedon aftësi të jashtëzakonshme duke i nxitur se duhet të shkojnë për vizitë te i njëjti, vërtetohet fakti se me datë .. '' personi qe e ka telefonuar H i tregon qe eshte të piceria Fita dhe i kërkon qe te shkon te piceria që marr dhe i njëjti i është përgjigjur se ai është doktor dhe se duhet te shkojë të klinika e tij'', ketë fakte gjykata e vetetoi nga transkripti i përgjimeve të datës .., ne te cilën është theksuar se '' se para një vit e gjysëm tezja e saj kishte qenë të B dhe nuk ka pasur efekt e njëjta ka kërkuar qe ti kthej të hollat në shumë prej 2.000 euro, i njëjti ka kembgulur se i ka kryer punë dhe ka insistuar qe tezja e saj te shkoj prap të ai'' Po ashtu nga traskripti i datës .. '' gjatë bisedës me një djalë i cili e pyet nëse fryn për fate dhe pasuri H i thot se fryn por duhet te marrë me vetë nënën ose motrën dhe se vizita kushon 20 euro, po duhet të shkoj te ai 3 herë qe ta ndimoj të njëjtin'' nga përgjimi i datës .. ''H. jam N. nga F. lajmërohu more burr gjasht mijë euro mi more, me pate grantu qe e kryen punën kthehet toka qe tri vjetë e gjysë

kurgja hiq” nga transkripti i datës ...’ gjatë bisedës me një person i cili i thot se ka qenë të dyshuari me 26 prill dhe se ka një senacë me 10 korrik e pyet se amund të vijë nesër dhe se a duhet të paguaj për kontrollën, H përgjigjet vetëm me shku me pa duhet mi lanë 20 euro, personi në fjalë i përgjigjet e dinë se 1.000 euro i kam dhënë për këtë punë, H pergjigjet se ato nuk janë asgjë se shqiptaret po japin dhe nuk i permendin”, nga transkripti i datës .. ‘ H e telefonon një mashkull nga Gj. dhe i tregon se gruaja dhe fëmijët i janë larguar nga shtëpia, i njëjti i përgjigjet se pikërisht për këto probleme është ai dhe se duhet ti dërgoj foto në viber dhe të shikoj si është situata”. Po ashtu nga traskripti i dt. .. ‘ gjatë bisedesme ne femr nga F... e cila i thotë se vajza është ndarë nga burri, i njëjti i thotë që ta marrë vjzën me vetë dhe ta dergojë të ai pasi që duhet të shkojë tri herë po ashtu t’ia në viber të dhënat dhe foto dhe mund të shkojnë të martën dhe të premtën”’.

Faktin se i akuzuari i ka vënë në lajthim të dëmtuarit se kinse posedon aftësi të jashtëzakonshme që shëron edhe sëmundjet të rënda fizike dhe psikike vërtetohet edhe nga foto dokumentacioni qe janë pjesë e shkresave të lëndës, me te cilat vërtetohet se i akuzuari ka vendosur një pllakë në hyrje të ordinancës në të cilën përcaktuar orari i punës, në ditë dhe orë, si dhe numri i telefonit për kontakte, ka vendosur mbishkrime te tjera në mur ku përcaktohen kushte qe duhen tju përmbahen pacientët qe kanë frekuentuar ordinancën në fjalë etj.. Po ashtu në fotot janë të paraqitura mjetet e punës së të akuzuarit me të cilat i njëjti i ka përdorur për shërimin kinse të pacientëve, të tilla si vezë, qirinjë, shishe me lëngje në pamje si ujë, gërshër, hajmalitë të shkruar në copa letrash, zhivë, qime flokësh, vula përkatëse si dhe dheu i varrezave, fotografi të pacienteve. Po ashtu gjykata vërteton faktin ka vënë në lajthim të demtuarit se kinse shëron sëmundje të rënda fizike dhe psikike vërtetohet edhe nga provat materiale e datës 23.10.98 **Euidemcija** ” e shkruar me shkronja te mdha te shtypit “ **JU SHEROJMË – Paralizën, Distrofijen, Epilepsinë, Gratë sterile të lindin fëmijë dh bashkim** ” kjo provë materiale gjenë mbështetje edhe me deshmin e dëmtuarit R.L të dhenë në shqyrtim gjyqësor “ për sëmundjen e epilepsisë nervore, H ju ka thënë se unë do të shëroje ”, si dhe me CD incizime të tjera qe janë pjesë e shkresa të lëndës, Nga këto dëshmi pamëdyshje gjykata vërteton faktin se i akuzuari H. P i ka mashtruar duke ju premtuar- garantuar se të njëjtit do ti shëron nga sëmundjet të rënda fizike dhe psikike, permes paraqitjes të fakteve të rreme se kinse posedon aftësi të jashtëzakonshme duke krijuar kushte iluzionare tek pacientat se po vinë të gjejnë shërim tek një mjek i mirëfilltë duke i udhëzuar qe duhet të shkojnë tri here për të pasur sukses dhe të gjejnë shërim për problemet që kanë.

Gjykata duke analizuar dispozitën e vepërs penale, Mashtrimin në vazhdimësi nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, e cila shprehimisht parasheh se ‘ Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore të kundërligjshme ose shkakton dëme në vlerë prej dhjetë mijë (10.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Sipas analizës të kësaj dispozite vepra penale e mashtrimit ndërmerret me qëllim që personi të sillet në lajthim dhe në atë mënyrë të shtyn që të veproj me qëllim të realizimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete a për tjetrin, duke pasur parasysh ekzistimin e kësaj vepre penale, kërkohet që dobia pasurore të jetë realizuar në mënyrë të kundërligjshme, përkatësisht që kryerësi të mos ketë bazë ligjore për këtë. Kryerës i kësaj vepre penale nga neni 335 par. 2 të KPRK-së mund të jetë personi i cili paraqet fakte të rrejshme për ekzistimin e ndonjë fakti që nuk ekziston, përkatësisht paraqitja e fakteve të ndryshme nga ajo që vërtet nuk ekziston, pra vepra penale e mashtrimit kryhet me veprim me të cilin personi i mashtruar shtyhet dhe me të cilin ai e dëmton pasurinë e tij.

Nga provat personale dhe materiale të administruara në shqyrtimin gjyqësor, është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit përfshihen elementet e natyrës, mbi bazën e së cilës ndërtohet figura e veprës penale: Mashtrim, të sanksionuar me nenin 335 par. 2 të KPRK-së, lidhur me nenin 81 të KPRK-së, si: qëllimi i përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin; qëllimi i të akuzuarve për të mashtruar viktimën; ndikimi në mënyrë thelbësore për të ndjekur një rrjedhë të caktuar veprimi nga ana e të dëmtuarit dhe dëmi i shkaktuar viktimave me anë të mashtrimit.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha provat e proceduara, faktet dhe rethanat e vërtetura në shqyrtim gjyqësor, dëshmitë e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve të cilët bindshëm vërtetojnë se i akuzuari H.Pme

qëllim të përfitimit në mënyrë të kundërligjshme me anë të paraqitjes së rreme të fakteve kinëse posedon aftësi të jashtëzakonshme *ka ndërmer veprim dhe ka venë në lajthim të dëmtuarit Z.M, H.Sh,F.S,B.K,B,M.B,B.K,dhe R. L , duke i nxitur dhe kërkuar që për shërbime e tij të paguajnë shuma të ndryshme të parave me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, duke realizu dobi pasurore në shuma të ndryshme të parave nga 20 euro deri në shumën prej 3.000 euro, dhe krejt kjo me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore, me pretendim se shëron sëmundje të rënda fizike dhe psikike.*

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor sa i përket kësaj pike të aktakuzës, ka konstatuar se pretendimet janë dhënë në drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale, kjo pasi që është në kundërshtim të plotë me provat materiale dhe personale të cilat i ka bashkangjitur prokuroria në aktakuzë e të cilat gjykata i dha besim të plotë, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit dhe të akuzuarit se kinëse *“ I njejt i shton se ne asnje nga rastet e supozuara penale, nuk eshte vërtetuar se H.P i vene ne lajthim ne fakte palet e demtuara, gjegjesisht, bisedat e zhvilluar ne P kane qenë te natyres spiritual, fetare te cilat nuk jane fakte ne te vertete, ky vertetohet ne baze te degjimit te deshmitareve, p.sh nga degjimi i deshmitarit I.N,me date .. pran gjykatës i njejt i pyetjen e mbrojtjes se a nenkupton se Fatmiri ka besu ne sherim permes magjieve fetare, i njejt eshte deklaruar, citon “.... U deklarova me lart, se ai ka besu, per kete shkak ka insist me shku....”, ngjashem ka deklaruar edhe deshmitarja H.Sh pran gjykatës me date .., e cila ne pyetjen e mbrojtjes se ne baze te ritualeve mund ti i zgjidhni problemet, e njejta eshte deklaruar, citon ”.... Po ne baze te asaj kemi besuar dhe kemi shkruar”. Ne baze te degjimi te deshmitarit M.B me date .. , I njejt ka deklaruar, citoj “.... Kam mendu se me kane ba serhire....”, vlen te shtohet se pavarsisht deshmise se tij, ky deshmitar nuk e ka identifikuar H.P ne sallen e gjykimit ne kete kuptim deshmi e tij nuk paraqet baze te besueshme qe te i falet besimi dhe te sherbej si prove fajesuese, ne kete drejtim i njejt ka deklaruar “..jo nuk e njoh kerkon...”. Andaj në baze te deshmi te lartcekurat behet e kjart se nuk qendron teza e akuzes se H.P i ka vene ne lajthim palet e demtuar ne fakte te caktuar, por, nderveprimi ka pasur te beje me rutale te natyres fetare, po ashtu, nuk qendron fakti se te njejtit kane besuar ne aftesint “mbinatyrore te mbrojturit im”, por, ne cilesit e caktuar te ritualeve dhe ndikimin e ketyre ritualve ne jeten sociale dhe gjendjen shpirtore te paleve.... i hodhi poshtë si të pa besueshme, për faktin se i akuzuari H.P, në rastin konkret ka qenë i vetëdijshëm se nuk i ka poseduar kualifikimet profesionale përkatëse për të shëruar sëmundje të rënda fizike dhe psikike si paralizën, distrofinine, epilepsinë, gratë sterile si dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme familjare. Për më tepër i akuzuari ka konsumuar edhe elementin volutiv të dashjes pasi që pasoja e dëshiruar nga veprimtaria e tij ka qenë pikërisht përfitimi i dobisë pasurore në rastin konkret e fituar në mënyrë të kundërligjshme. Gjykata vlerëson se i akuzuari ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme me qëllim të përfitimit të vlerave të ndryshme monetare të cilat i njëjt ju a ka kërkuar në mënyrë të drejtë për drejtë të dëmtuarve të cilët kanë frekuentuar dhe kanë kërkuar zgjidhje të problemeve shëndetësore fizike dhe psikike të tyre në ordinancën “B” dhe ky fakt është vërtetuar nga dëshmit e të dëmtuarëve-dëshmitarëve dhe provave materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësorë e të cilave dëshmi gjykat ju a fali besimine plotë ngase këto deklarata të këtyre dëshmitarëve nuk kanë kundërthënie në mes vete, përkundër kësaj të gjithë të dëmtuarit dhe dëshmitarët kanë deklaruar bindshëm se për trajtimin e tyre në ordinancën B, kanë paguar shuma në vlera të ndryshme sic u cekën edhe me lart.*

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha provat e proceduara, faktet dhe rethanat e vërtetura në shqyrtim gjyqësor, dëshmitë e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve si dhe të provat materiale të bashkangjitura aktakuzës, ka vërtetuar se i akuzuari H.P ka kryer veprën penal si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që i njëjt ka pasur qëllim ti vë në lajthim të dëmtuarit, të realizoi dobi pasurore të kundërligjshme, ashtu qe me veprimet e ndermarrura nga i akuzuari janë formësuar elementet objektiv dhe subjektivbe te kësaj vepre penale, në drejtim të dëmtuarve me paraqitje të rrejshme të fakteve se

posedon aftësi të jashtëzakonshme për të shëruar sëmundje të ndryshme fizike dhe psikike si dhe zhgjidhjen e problemve mendore dhe shpirtëore. Nga kjo shihet se i akuzuari ka konsumuar elementet e veprës penale të mashtrimit duke realizuar dobi pasurore të kundërligjshme pasi që i ka obliguar pacientet-klientet që fillimisht në terminin e parë të paguajnë shumë në lartësi prej 20 euro, e më pas i kushtëzuar që të prezantohen edhe në terminin e tjerë me kusht që të bëjnë pagesa të ndyshme e varësisht nga kërkesat e tyre sipas gjendjes ekonomike, këto pagesa kanë qenë në vlera të ndyshme monetare, varësisht prej rasti deri në 3.000 euro.

Gjykata vlerësoi me shumë kujdes të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se duhet t'iu falet besimi i plotë provave siç janë deklaratat e dëmtuarve dhe dëshmitarve të dhënë në shqyrtim gjyqësor pasi që deklarimet dëmtuarve dhe dëshmitarve të dhëna në procedurë paraprake dhe në shqyrtim gjyqësor vërtetojnë se i akuzuari i ka mashtruar duke ju premtuar- garantuar se të njëjtit do ti shëron nga sëmundjet të rënda fizike dhe psikike. Andaj, këto dëshmi i konsideron të besueshme dhe se këto dëshmi kanë mbështje edhe në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe të njëjtave j'uua fali besimin e plotë, prandaj gjykata gjen se provat e bashkangjitura aktakuzës në menyrë të padyshtimit vërtetojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale mashtrimit në vazhdimësi nga neni 335 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

III.

Gjykata pas procedimit të provave materiale dhe dëgjimit të dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht me njëra-tjetrën, në kuptim të nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së, kjo gjykatë ka vërtetuar se ka prova se i akuzuarit H.P ka kryer veprën penale ***mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK- së***

Gjykata në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vërtetua se i akuzuari H.P në shtëpinë e tije e cila gjendet në rrugën "J. e R." në P pa autorizim përkatës ka mbajtur në pronësi dhe posedim armët dhe atë një pistolet të tipit "G." të kalibrit 9mm me numër serik ..., me dy karikator si dhe 166 fishek të të njëjtit kalibër, si dhe një pushkë gjuetie të tipit "S.r C." me numër serik .. dhe 55 fishek në kundërshtim me ligjin për armët nr. 05/L -022 të cilat armë janë konfiskuar me rastin e kontrollit nga ana e policisë së Kosovës me dt;16 nëntor 2018.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha provat e proceduara, faktet dhe rrethanat e vërtetuara në shqyrtim gjyqësor si dhe analizimit të provave personale dhe materiale gjeti se i akuzuari pa autorizim ka mbajtur në posedim armët dhe atë një pistolet të tipit "G." të kalibrit 9 mm me numër serik ., me dy karikator si dhe 166 fishek të të njëjtit kalibër, si dhe një pushkë gjuetie të tipit "S. C." me numër serik.dhe 55 fishek në kundërshtim me ligjin për armët nr. 05/L -022 dhe se me këto veprime ka kryer veprën penale ***mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK- së***, ashtu siç pretendon prokurori në aktakuzë, dhe ky fakt vërtetohet edhe nga provat materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor e të cilat janë pjesë e lëndës, përkatësisht , *raporti i shpejtë me numër rastit .. të dt .. me të cilin raport vërtetohet fakti se në shtëpinë e të akuzuarit H.P janë gjetur një pistoletë dhe një pushke gjuetie me afat të skaduar të lejes për armë dhe municion, Raporti i këqyrjes se vendit të ngjarjes- njësia e forenzikes me numër dosjes .. të dt. .. të evidentuar armë – pistoletë e tipit "G." dhe pushkë gjuetie te tipit "S. C." si dhe foto albumi nga njësia e forenzikës me nr. të dosjes .. i datës . ku në dëshminë (D2) janë evidentuar armët, municionet si edhe lejet me afat të skaduar të gjetura në shtëpinë e të akuzuarit. Nga sa u tha më lart , nga provat e lartë cekura vërtetohet fakti se në shtëpinë e të akuzuarit janë gjetur armët dhe se i njëjti pa autorizim përkatës ka mbajtur në pronësi dhe posedim dhe atë: një pistoletë e tipit "G.", të kalibrit 9mm, me numër serik .. me dy karikator si dhe 166 fishek si dhe një pushkë gjuetie te tipit "S. C." me numër serik ... dhe 55 fishek, të cilat armë janë gjetur në shtëpinë e të akuzuarit.*

Nga këto dëshmi pa mëdyshje gjykata vërteton faktin se i akuzuari H.P ka **mbajt në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar armët e cekura si më lartë dhe në kundërshtim** me Ligjin për armët me nr. 05/L -022, si dhe duke i analizuar provat materiale të cilat i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor i ka vlerësuar si prova të pranueshme andaj i ka administruar si të tilla, të cilëve kjo gjykatë u kushtoi besim të plotë, e të cilat qojnë gjykatën në konkludim se besueshmëria në to dhe shkalla e arsyesh mërisë me rrethanat e konkrete të rastit, në mënyrë të padyshimtë vërtetojnë që i akuzuari ka kryer veprën penale **mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK- së.**

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit dhe të akuzuarit se kinëse **“se vepra penale armbajtës pa leje sipas nenit 374 par.1 të KPK-së, kryhet me dashje direkte, dhe se ne baze te nenit 21 te KPK –së, është përcaktuar se personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj, gjegjësisht, poseduesi i armës e din qe arma me leje dhe e posedon edhe me tutje si te tille, ne rastin konkret, dashje nuk është vërtetuar se ekziston, ngase, i mbrojturi im për te dy armët ka pasur leje nga organet kompetente, gjegjësisht, “leje te veçanta” për përdorimin e pistoletës, nr.. dhe leje për arme te shenjtarise nr..., këto dokumente lëshohen nga organet kompetente dhe janë lëshuar sipas ligjeve ne fuqi, ne anën tjetër posedimin e këtyre armeve i mbrojturi im e ka bere sipas te njëjtave dokumente, ne kuptim te nenit 21 dhe 22 te Ligjit për Armët”, e njëjta i hodhi poshtë si të pa besueshme dhe të pabazuara, për faktin se në rastin konkret është e vërtet se i akuzuari H.P për të dy armët ka pasur leje, të nxjerrë sipas procedurave të parapara nga organi kompetent bazuar në Ligjin Nr. 05/L -022 Për Armë, mirëpo lejet e armëve në momentin e gjetjes së tyre në banesën e të akuzuarit, nuk kanë pasur validitet të lejes së posedimit përkatësisht leja ka qenë me afat të skaduar e që sipas ligjit konsiderohen si armëmbajtje pa leje.**

Gjykata bën me dije se në kuptim të Ligjit Nr. 05/L -022 Për Armë, nenit 21 dhe 22 par. 5, leja për posedim të armës duhet rinovuar pas kalimit të afatit 5 vjeçar të validitetit, e në rastin konkret i akuzuari nuk e ka ndërmarrë një veprim të tillë për të rinovuar lejet në fjalë mirëpo ka vazhduar të mbajë në posedim armë të cilave validiteti i lejes ka skaduar prej vitit 2008. Në një situatë të tillë gjykata thekson se tek i akuzuari janë përmbushur dy elementët e **dashjes** përkatësisht **elementi inetelektual** pasi që i akuzuari ka qenë i vetëdijshëm se lejet e armëve që i posedon kanë qenë me afat të skaduar dhe se mbajtja e armëve pa leje valide është në kundërshtim me ligjin duke pasur kështu përfytyrim të qartë për veprën që e kryen dhe pasojat që do të shkaktohen, por se i njëjti me dëshirë i ka mbajtur armët me leje jo valide dhe është pajtuar me pasojat ligjore në rast të evidentimit nga organet e shtetit, duke përmbushur kështu edhe **elementin volitiv** të veprës penale **mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK- së.**

Andaj nga sa u tha më lart, gjykata duke pasur parasysh të gjitha provat e proceduara, faktet dhe rrethanat e vërtetuar në shqyrtim gjyqësor, ka vërtetuar se i akuzuari H.P ka kryer veprën penal si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që i njëjti ka konsumuar elementet e veprës penale **nenit 374 par.1 të KPK-së.**

Gjykata vlerësoi me shumë kujdes të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se duhet t’iu falet besimi i plotë provave materiale siç janë siç janë, **raporti i shpejtë me numër rastiit .. të dt ..** me të cilin raport vërtetohet fakti se në shtëpinë e të akuzuarit H.P janë gjetur një pistolet dhe një pushke gjuetie me afat të skaduar të lejes për armë dhe municion, **Raporti i këqyrjes se vendit të ngjarjes- njësia e forenzikes me numër dosjes .. të dt. .. të evidentuar armë – pistoletë e tipit “G.” dhe pushkë gjuetie te tipit “S. C.” si dhe foto albumi nga njësia e forenzikës me nr. të dosjes .. i datës ...** Andaj, këto dëshmi i konsideron të besueshme dhe të njëjtave j’ua fali besimin e plotë.

IV.

Gjyakta pas procedimit të provave materiale dhe dëgjimit të deshmitarëve, ekspertit në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht me njëra-tjetrën, në kuptim të nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së, kjo gjykatë ka vërtetuar se ka prova se i akuzuarit H.P ka kryer veprën penale **shpëlarja e parave nga neni 308 të KPRK-së lidhur me nenin 56 par.1 pika 1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.**

Gjykata pas analizimit të provave personale dhe materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vërtetua se i akuzuari H.P, duke e ditur se pasuria e fituar me anë të veprës penale Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike në vazhdimësi nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së e përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, U, nga data .., në vazhdimësi deri më datën .., parat e fituara nga ky aktivitet kriminal i ka futur në sistemin bankar përmes deponimit të të hollave të gatshme kryesisht me arsyetimin se ashtu i paguan këstet e kredis, e më pastaj e kryen shtresimin-fshehjen e origjinës së tyre përmes transfereve bankare, si dhe përmes pagesave në kesh për asetet e blera, duke i konvertuar në asete të luajtshme dhe të paluajtshme mjetet financiare të fituara përmes aktivitetit kriminal.

Gjykata duke analizuar dispozitën ligjore të veprës penale shpëlarja e parave nga neni 308 të KPRK-së, e cila parasheh se ‘ *Kushdo që kryen veprë penale të shpërlarjes së parave, dënohet sipas Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit*’. Duke ju referuar dispozitave të veçanta përkatësisht nenit 56 par.1 pika 1.1 të Ligjit nr.05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit në të cilën dispozitë është përcaktuar se ‘ *Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me veprë penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin IX të Kodit të procedurës penale të Kosovës, zhvillon veprimet e mëposhtme, kryen veprë penale të dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale*’ pika 1.1. **konvertion, transferon ose përpiqet të konvertoj ose të transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, bU,t, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë;**’ .

Gjykata vëlon se janë formësua elementet e vepërës penale të lartëcekur siç janë: **subjekti, veprimi, qëllimi dhe dënimja**. I akuzuari H.P si **subjekte** duke e ditur se pasuria e fituar është rrjedhojë e veprës penale ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike, i njëjti ka **vepruar** nga data .. e në vazhdimësi deri më dt: ..., ka ushtruar veprimtarinë e kundërligjshme si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe parat e fituara nga ky aktivitet kriminal i ka futur në sistem bankar përmes deponimit të hollave të gatshme, blenë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme me para në keshë, **me qëllim** të fshehjes paguan këstet e kredive duke kryer shtresimin- fshehjen e origjinës duke qenë në **dijeni** se parat e përfshira në transaksione dhe të deponuara janë me origjinë nga aktiviteti kriminal.

Gjykata këtë gjendje faktike e vërteton nga ekspertiza e datës .. e punuar nga eksperti R.F dhe të elaboruar në shqyrtim gjyqësor nga e cila ekspertizë rezulton se i akuzuari H.P në ARBK ka të regjistruar biznesin individual me numër .. që vepron me dy njësi, dhe ate njësi “O B” me numër .. e regjistruar me datë .. si dhe njësi DPH “U,” me numër NRB .. të regjistruar më datë ... Të dy këto njësi janë të inkorporuara në të njëjtin numër fiskal NF .. dhe se nuk mund të ndahen e të cilat bazohen në numrin e lëtërnjoftimit të akuzuarit. Në njësinë e parë të emërtuar “O B” i regjistruar në ARBK me dt. ..., si aktivitet primar ka qenë “**aktivitet te tjera te shëndetit të njeriut- kodi 8690**”, dhe i akuzuari në këtë biznes ka ushtruar veprimtarinë e tij mjekësore të kundërligjshme deri më datë ... Gjatë kësaj periudhe, nga data .. deri me datë .. me paratë e fituara nga ushtrimi i aktivitetit kriminal, i akuzuari H.P me qëllim të shtresimit-fshehjes së origjinës së parave ka lidhur kontratë me datë ... me S.(N.) K. në cilësinë e shitësit, për blerje

të paluajtshmërisë të evidentuar me numër Nr..., ngastra kadastrale A. ndërsa me datë .. ka lidhur kontratë me L.K në cilësi të shitëses për blerje të paluajtshmërisë dhe atë të ngastrës kadastrale me numër Nr... në vendin e quajtur “B.”.

Këtë fakt gjykata e vërteton edhe provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës përkatësisht kontrata e datës .. e lidhur mes S.K. në cilësi të shitësit dhe të akuzuarit H.P në cilësi të blerësit, si dhe kontrata e datës .. e lidhur ndërmjet L. (J.) K. në cilësi të shitëses dhe të akuzuarit H.P në cilësi të blerësit, këto dy kontrata të lidhura në zyrat e avokatëve, përmbajnë vetëm datën në të cilën janë lidhur si dhe nënshkrimet e plaëve kontraktuese por se të njëjtat nuk përmbajnë numër identifikues të kontratës apo numër protokoli, e as nuk janë të lëgalizuara në gjykatë.

Gjykata nga ekspertiza e datës .. ka vërtetuar se i akuzuari më datë .. krahas njësisë “O B” dhe me qëllim të mbulimit të aktivitetit kriminal të ushtruar në “O. B” se kinse ka fituar pasuri me aktivitet të ligjshëm, i njëjti e hap edhe njësinë “U,” në të njëjtin numër fiskal, përkatësisht është i njëjti biznes dhe nuk mund të ndahen, veprimtaria kryesore – primare nuk dallon, e kanë të njëjtin kod me njësinë “O B”- .. - **aktivitete të tjera të njeriut**, por njësia NPH “U,” ka edhe aktivitete të tjera sekondare të cilat i ka regjistruar si hoteleri, shitje, kafiteri etj.

.. me paratë e fituara nga aktiviteti kriminal i ushtruar në dy njësitë e lartëpërmendura, ka bërë bletje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Nga ekspertiza e datës .. gjykata vërteton se i akuzuari H.P, nga data .. deri me datë .. me qëllim të shtresimit-fshehjes së origjinës së vërtetë të parave me datë .. ka lidhur kontratë me A. Sh. (i përfaqësuar nga bashkëshortja N. Sh.) në cilësinë e shitëses për blerjen e paluajtshmërisë të evidentuar me numër të ngastrës .. – 0 ZK P.. Këtë fakt gjykata e vërteton edhe me provën materiale kontrata e datës .. e lidhur mes A. Sh. (i përfaqësuar nga bashkëshortja N.Sh.) në cilësinë e shitëses dhe H.P në cilësi të blerësit, kjo kontratë përmban vetëm datën në të cilën është lidhur si dhe nënshkrimet e palëve kontraktuese por se e njëjta nuk përmban numër identifikues të kontratës apo numër protokoli, e as nuk është e lëgalizuara në gjykatë. Me datën .. i akuzuari ka lidhur kontratë me E. K. në cilësinë e shitësit për blerjen e paluajtshmërisë të evidentuar me numër të njësisë kadastrale P-.. K. V. – D.. Këtë fakt gjykata e vërteton edhe me provën materiale kontrata e datës .. e lidhur mes E. K. në cilësinë e shitësit dhe H.P në cilësi të blerësit, kjo kontratë përmban datën në të cilën është lidhur, nënshkrimet e palëve kontraktuese dhe e lëgalizuar në gjykatën Komunale në P me numer Leg.nr .. më datë ... Me datën .. i akuzuari ka lidhur parakontratë me palët kontraktuese R. K., S. K.dhe Sh. K. në cilësinë e shitësve për blerjen e paluajtshmërisë të evidentuar me numër të njësisë kadastrale .. në sipërfaqe prej 263 m2 ZK P përkatësisht 153 m2 oborr dhe 104 m2 shtëpi. Këtë fakt gjykata e vërteton edhe me provën materiale kontrata e datës ...e lidhur mes palëve kontraktuese të lartë përmendur në cilësinë e shitësit dhe H.P në cilësi të blerësit, kjo parakontratë përmban datën në të cilën është lidhur, nënshkrimet e palëve kontraktuese por se e njëjta nuk përmban numër identifikues të kontratës apo numër protokoli, e as nuk është e lëgalizuara në gjykatë. Me datëni akuzuari ka themeluar kontratë mbi hipotekën në cilësi të hipotekëlënësit për ngasrën kadastrale me numër .. P., me certifikatë të pronës të datës 07.11.2014 me numër të lëndës ... që evidentohet në emër të të akuzuarit si pronar i vetëm 1/1 të pronësisë, këtë fakt gjykata e vërtetoi me provën materiale që gjendët në shkresat e lëndës , e administruar në shqyrtim gjyqësor, Aktin noterial , me numër rendor .. nr ref. Me datën ... i akuzuari ka lidhur kontratë me “L. BP” sh.p.k në cilësinë e shitësit për blerjen e paluajtshmërisë lokalet e biznesit “L” të evidentuar në ngastrën kadastrale ... në vendin e quajtur Atmejdan. Këtë fakt gjykata e vërteton edhe me provën materiale kontrata e datës ... e lidhur mes “L. BP” sh.p.k e përfaqësuar nga pronari D.H në cilësinë e shitësit dhe H.P në cilësi të blerësit, kjo kontratë përmban datën në të cilën është lidhur, nënshkrimet e plaëve kontraktuese dhe është noterizuar në zyrënoterit me numër LRP.nr... Ref.nr

Gjykata vërtetoi se i akuzuari pavarësisht se paluajtshmëritë i ka blerë në mënyrë të rregull, duke lidhur kontratat të vlefshme dhe ligjore, të njëjtat palajtshmëri i ka blerë duke qenë në dijeni se mjete financiare janë të fituara në mënyrë të kundërligjshme nga aktiviteti kriminal që ka ushtruar i akuzuari si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe krejt kjo më qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës së bU,t të ardhurave të fituara nga aktiviteti kriminal. Këtë gjëndje faktike gjykata e vërtetoi nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të cilat gjykata i ka administruar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në procedurën e administrimit të provave, dhe si të tilla jua a fali besimine plotë.

Gjykata nga ekspertiza e datës ... po ashtu vërtetoi se i akuzuari H.P, me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës së U, të ardhurave të fituara nga aktiviteti kriminal, përveç pasurisë së paluajtshme të sipërpërmendur, ka bërë blerje dhe ka marrë në posedim përmes autorizimit pasuri të luajtshme, përkatësisht i akuzuari ka pasur në posedim Veturën e tipit "M.", ngjyrë hiri me targa ..., me numër të shasisë ...,viti i prodhimit 2019 me autorizim të datës ... të përpiluar te noteri, me nr LRP nr... me të cilin autosalloni "P.." shpk autorizon H.P, U P dhe F. P që automjetin e tipit "M.", ngjyrë hiri me targa ta vozitin brenda dhe jashtë shtetit. Gjykata ka vërtetuar se autorizimi nuk është i nënshkruar nga palët në fjalë dhe nuk e përmban as nënshkrimin dhe vulën e noterit. Po ashtu gjykata nga ekspertiza e sipërpërmendur konstaton se autosalloni "Prishtina"shpk nuk ka të përfshira shërbime për dhënien e veturave më qëra. Këtë fakt gjykata e vërteton edhe nga provat materiale përkatësisht akti noterial të datës .. të përpiluar te noteri, me nr LRP nr... dhe provat e tjera që gjenden në shkresat e lëndës të administruara në shqyrtim gjyqësor të cilave gjykata i mori si të mirqëna dhe ju a fali besimin e plotë. Gjykata pas analizimit të provave materiale që gjenden në shkresat e lëndës, kontratatave të shitblerjes dhe autorizimeve për përdorim të automjeteve vërtetoi se i akuzuari H.P ka pasë në pronësi apo posedim përmes autorizimit të lëshuar nga autosallonet përkatëse veturat e tipit "S", me ngjyrë të zezë me targa ..., me numër të shasisë ..., viti i prodhimit 2014, vetura e tipit "W. G.", ngjyrë e zezë me targa ..., me numër të shasisë ..., viti i prodhimit 2015, Vetura e tipit "V. G.", ngjyrë e zezë metalike me targa ..., me numër shasisë ..viti i prodhimit 2009, vetura e tipit "V T.", ngjyrë e kaltër me targa ..., me numër të shasisë ..., viti i prodhimit 2016, vetura e tipit "A., ngjyrë e bardhë me targa ..., me numër të shasisë ..., viti i prodhimit 2018, vetura e tipit "L. R. ", me targa ..., ngjyrë të kaltër, me numër të shasisë, ..., viti i prodhimit 2018 dhe vetura e tipit "R. M.", ngjyrë të bardhë me targa .. me numër të shasisë ..., viti i prodhimit 2018.

Gjykata në bazë të ekspertizës financiare të datës .. e administruar dhe elaboruar në shqyrtim gjyqësor vërtetoi se të dhënat nga Agjencioni i Regjistrimit Civil - Drejtoriati për Regjistrim të automjeteve nr. ..., të datës ..., duke u bazuar në regjistrin elektronik të të akuzuarit H.P rreth automjeteve që i posedon, ka nxjerrë vlerat e tyre, dhe gjen se çmimi i automjeteve nga amortizimi sipas normave evropiane të shpenzimit të automjeteve sipas gjëndjes .. arrin një vlerë të konsiderueshme të mjeteve financiare deri në qinda mijëra euro. Gjykata vërtetoi faktin se i akuzuari qarkullueshmerinë e veturave e ka bërë me autorizime nga autosallonet e ndryshme, e që këto autosallone nuk kanë pasur aktivitet të tyre për dhënie me qëra të veturave në fjalë, mirëpo këtë veprim i akuzuari e ka ndërmarrë për të mundësuar që automjetet mos të figurojnë në pronësi të tij dhe në këtë mënyrë ka bërë vetëm autorizime për përdorim të automjeteve me qëllim të fshehjes të vlerës reale dhe U, të ardhurave financiare të fituara nga aktiviteti kriminal. Po ashtu sa i përket automjeteve të cilat janë në pronësi të të akuzuarit e që këtë të drejtë pronësore e ka të fituar përmes kontratatave të shitblerjes, gjykata bën me dije se këto automjete pavarësisht faktit se janë blerë në mënyrë të rregull, duke lidhur kontratat të vlefshme dhe ligjore, të njëjtat janë blerë më mjete financiare të fituara në mënyrë të kundërligjshme nga aktiviteti kriminal që ka ushtruar i akuzuari si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Këtë gjëndje faktike gjykata e vërtetoi nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të cilat gjykata i ka administruar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në procedurën e administrimit të provave, dhe si të tilla jua a fali besimine plotë.

Gjykata nga provat materiale dhe personale të administruara dhe elaboruara në shqyrtim gjyqësor vërtetoi faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale shpëlarja e parave si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ashtu që paratë e fituara nga aktiviteti kriminal ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku si rezultat i kësaj vepre penale i njëjti ka përfituar dobi pasurore në mënyrë të kunderligjme me qëllim të shtresimit-fshehjes së origjinës së vërtet të këtyre mjeteve, të njëjtat i ka futur në sistemin bankar përmes deponimit të të hollave të gatshme kryesisht me arsyetimin se paguan këstet e kredive, e të cilat holla i deponon në shuma të ndryshme në para kesh. Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi kryesisht nga ekspertiza e datës .. në bazë të cilës i akuzuari ka marrë kredi nga bankat afariste si dhe ka bërë pranime të konsiderueshme të të hollave, nga institucionet e tjera jo bankare si W. U. dhe M. G..

Gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka marrë kredi nëpër bankat te ndryshme afariste me qëllim të fshehjes së origjinës se vërtetë të mjeteve, e duke u arsyetuar se kreditë e marra i kanë shërbyer për të bërë blerje të paluajtshmërive ndërsa pronarëve-shitësve të këtyre paluajtshmërive vlerën monetare për çmimin përkatës ju a ka paguar në mënyrë KESH - në dorë kurse me institucionet bankare ka bërë marrëveshje kreditore se kinse kredia e marrë do të shërbejë për të paguar çmimin e paluajtshmërisë. Ndërkohë shitësit e paluajtshmërive, pasi që paraprakisht e kanë marrë pagesën nga i akuzuari për paluajtshmëritë e shitura, në dorë, në formën KESH, të njëjtët më pas kanë bërë tërheqjen e shumës së derdhur në gjirollogarinë e tyre nga gjirollogaria e të akuzuarit, dhe të njëjtën shume (kredine) e kanë kthyer përsëri tek i akuzuari H.P, duke bërë kështu fshehjen dhe maskimin e mjeteve të fituara nga aktiviteti kriminal e të cilat mjete më pas i akuzuari i ka deponuar në bankë në shuma të ndryshme duke filluar nga 1000 euro e deri në 8000 euro, e këto kredi dhe deponime, në total arrijnë vlera të konsiderueshme deri në qindra mijëra euro. Po ashtu gjykata vërtetoi se i akuzuari H.P të gjitha këto marrëveshje kreditore të sipër përmendura i ka lidhur me institucionet bankare personalisht në emër të tij ose përmes njërive të tij biznesore si “O B” dhe kryesisht përmes biznesit individual “U,”.

Gjykata vërteton se i akuzuari H.P, ka hapur llogari bankare në banka të ndryshme afariste përkatësisht ka hapur llogari në B.E., P. K.B., BKT, BpB B., dhe njëkohësisht ka qenë person i autorizuar për këto llogari bankare dhe se i njëjti ka marrë kredi në bankat e lartpërmendura nga data .. e deri me datë .., me qëllim të fshehjes të natyrës së U, dhe duke e ditur se pasuria e fituar është rrjedhojë e vepër penale ushtrimi i kundërligjshëm të njëjta i ka deponuar në sistemin bankar përmes deponimit të mjeteve të gatshme me arsyetimin se paguan këstet e kredive, duke autorizuar persona të tjerë për të deponuar mjete në shuma të ndryshme në bankat e lartë përmendura . Këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e datës .. e cila përmbanë të dhënat që institucioni mikrofinanciar F. ka venë në dispozicion të eksmerrit bazuar në kerkese të lidhur me të gjitha marrëveshjet e huas që i akuzuari i ka lidhur me këtë institucion në periudhën si me lartë dhe atë marrëveshje të huas, kjo provë materiale gjenë mbështetje edhe me dëshminë e dëshmitarit **Rr.E** të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë ..i cili ka theksuar se *“ka punuar te H.P punëtor i thjeshtë ka mbajtur rendin, ka regjistruar pacientet, dhe gjatë atyre ditëve kanë qenë diku 15-20 paciente, deri në 50 pacientë, nuk ka pasur kontakt me të holla përveç kur ka pasur ndonjë pagesë të kredive apo obligim, B ia ka dhënë të hollat kesh me shku me bërë pagesë e të cilat shuma kanë qenë 1.000 ose 2.000 euro, po ashtu përveç tij kanë shkuar edhe punëtore tjerë të bëjnë pagesa, si dhe ka deponuar mjete në bankë me qëllim të pagesës së një shtëpie”*.

Gjykata vërteton se i akuzuari H P. ka hapur llogari bankare në B. E. personalisht si pronar i llogarisë ndërsa i njëjti rezultoi të jetë edhe person i autorizuar për njësin D.P.H “U, ”, D. H., B. P dhe O B. Po ashtu vërtetohet se i akuzuari në cilësi të kredimarrësit ka lidhur marrëveshje me B. E. - si kredidhënëse. Këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e ekspertit financiar e dt.. e cila përmban të dhënat që i akuzuari nga data ... e deri me datë .. ka deponuar mjete të gatshme në B. E. në shuma të ndryshme përmes personave R.T.R. E.i, E.B. dhe U P , fakt i cili gjenë mbështetje edhe në prova personale të administruara në shqyrtim gjyqësor dhe atë nga dëshmia e dëshmitarit **E.Bi** i cili ka theksuar se *“ka shkuar në bankë me*

ia paguar këstin e kredisë, për afërsisht 4-5-6 herë, mund me qenë dhe 10 herë që ka shkaur me deponuar pare në bankë në shumë 4.500-5.000 euro.

Gjykata vërteton se i akuzuari H P. me ka hapur llogari bankare në P.C.B personalisht si pronar i llogarisë ndërsa i njëjti rezulton te jetë person i autorizuar edhe për njesin D.P.H ‘‘U, ’’. Po ashtu vërtetohet se i akuzuari në cilësi të kredimarrësit ka lidhur marrëveshje me P.C.B- si kredidhënëse. Këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e ekspertit financiar e dt... e cila përmban të dhënat se i akuzuari nga data .. e deri me datë ... ka deponuar mjete kesh në bankën P.C.B sh.a në shumë të ndryshme përmes personave Rr. E., A. E., R.T dhe nga vetë i akuzuari H P., fakt i cili gjen mbështetje edhe me dëshmin e dëshmitarit **R.T** të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë .. i cili theksuar se, ‘‘*Kam shtuar se B kur ka pas naj pagës me kry në bankë, naj kredi apo naj senë, kur i kemi vy na ka thirrë i njëjti deklaroi se H më ka dërguar në bankë që të bëjë pagës për kresin në emër të Bt, dhe çdoher kam shkaur me letërnjoftim të B, dhe kam deponuar shumë prej 2.000 -3.000 euro, dhe kjo ka ndodh 3-4-5 ndoshta edhe me tepër herë’’*

Gjykata vërteton se i akuzuari H .P ka hapur llogari bankare në B. K. T.Sh.a (BKT), personalisht si pronar i llogarisë ndërsa i njëjti rezulton te jetë person i autorizuar edhe për njesin D.P.H ‘‘U, ’’. Po ashtu vërtetohet se i akuzuari në cilësi të kredimarrësit ka lidhur marrëveshje me B. K. T. Sh.a (BKT) - si kredidhënëse. Këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e ekspertit financiar e dt.. e cila përmban të dhënat se i akuzuari nga data . e deri me datë të ka deponuar mjete në bankën B. K. T. Sh.a përmes personave M.Q.Rr.E, J.A, E.B,V. M. dhe R. T. fakt i cili gjen mbështetje edhe me dëshmin e dëshmitarit **M.Ç** të dhënë në shqyrtim gjyqësor i cili ka theksuar se ‘‘*Në pyetje të PSRK-së, atë ditë me .., që keni deponuar në bank të holla, Rr.E9 mijë euro, I. Rr.9 mijë, ti 9 mijë, E.B5 mijë e 500, I. Rr. 9 mijë, I.Rr.prap 1 mijë të gjitha këto deponime të njëjtën ditë, a të kujtohet kjo? I njëjti është përgjigjur se me ta nuk ka qenë atë ditë, por ka mundur të jenë edhe ata që kanë bërë deponime arsyet e deponimit për shtëpi sepse aty janë blerë shumë shtëpi, ato pare kanë qenë të H së të cilat janë marr nga qërajat. Në pyetje të PSRK-së, ti ke deponuar shumë pare, gati çdo muaj ke bërë deponime, p.sh. me dt..., ke pas 2 deponime në BK, një deponim 2.285 euro, e pastaj prapë të njëjtën ditë 3.430 euro, për çka janë bërë këto pagesa? I njëjti është përgjigjur se menjëherë është bërë ajo pagesë por ka qenë e ndarë në këste, e të cilat sipas kësteve i ka paguar për kredi. Shumat e dërguara në bankë ndonjëherë janë kanë 6 mijë, 7-8 mijë, të cilat janë paguar përnjëherë për kredi, pagesa H ia ka dhënë faturat dhe mjetet. Në bankë kanë shkaur se bashku me kolegë arsyeja pse kanë shkaur sepse i kanë pas nga 3 fatura, dhe që të kryen më shpejtë një e kam marr vetë ai, një faturë tjetri.*

Gjykata vërteton se i akuzuari H P ka hapur llogari bankare në B. për B. ‘‘BpB’’ Sh.a në emër të D.P.H ‘‘U, ’’ dhe ‘‘O B’’ dhe për të njëjtat është person i autorizuar. Po ashtu vërtetohet se i akuzuari në cilësi të kredimarrësit ka lidhur marrëveshje me Bankën për Biznes ‘‘BpB’’ Sh.a - si kredidhënëse. Këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e ekspertit financiar e dt.. e cila përmban të dhënat se i akuzuari nga data .. e deri me datë të .U,.. ka deponuar mjete në bankën B. për B. ‘‘BpB’’ Sh.a, përmes personave Rr.E., M.Q,U P E.B dhe V. M.fakt qe gjen mbështetje edhe në dëshmin e dëshmitarit **D.H** të dhënë në shqyrtim gjyqësor i cili ka theksuar se ‘‘*Fillimisht H ia ka paguar 100 mijë euro, dhe i kam marr 100 m², më pastaj edhe 250 mijë euro tjera, për 160 m². Sipas marrëveshjes se metri katror i lokalit ka qenë 2.600 euro, kjo ka qenë para kontratë me arsye që i njëjti të merr kredi në bankë, kjo vlen vetëm për bankë. Nga Tetori i vitit 2012, ka marr shumë prej 10 mijë e 500 euro, se të gjitha pagesat që i ka marr në muaj, e ka pritë deri e ka marr kreditin e fundit në shumën prej 250 euro, dhe janë ardhë në konton time, dhe këto mjete kanë dalë për blerjen lokaleve, pastaj kur i kam marr mjetet ia kam kthyer të gjitha, edhe e kemi bërë barazimin prej 350 euro, që i kanë kushtuar 260 m². Ndërsa është bërë transferimi nga ndërmarrja U, në xhirollogarin time në shumë prej 248.750 mijë euro, po ashtu kur është bërë transferimi, e ka nënshkruar një marrëveshje, që në momentin kur të kanë dal mjetet në llogari, i ka nxjerr mjetet dhe me kesh ja ka dhënë me u barazuar gjendja me Hn. Lidhur me deklaratën e dhënë të av. E. G.j e ka dhënë se ka dashur me marr kredi H këtë deklaratë e ka dhënë vetëm për bankë, që me marr kredi më lehtë’’.*

Gjykata ekspertizës së ekspertit R. F. të dorëzuar në gjykatë me datë .. e të njëtet të elaboruar në shqyrtim gjyqësor ia fali besimin e plotë pasi që e njëjta është në përputhshmëri me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor ato materiale si dhe ato personale e të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës përkatësisht marrëveshjet-**Shenimet me dorë në një fletore ku janë të shenuara shumat prej 10,500 euro të cilat ia ka paguar D.H .rregullisht, çdo ditë të parë të muajit, secila pagesë e vërtetuar me nënshkrimet e tyre, duke filluar nga dt. ..., deri me .., në të cilën Shenimi me dorë është evidentuar :** “sot me dt. .. D.H ka marrë përmes B. E. 100 mijë €, pastaj “sot me dt. .. janë marrë 10 mijë €, janë mbetë 31 mijë “ dhe në fund “ sot me ... 20 mijë €, janë mbetë edhe 11 mijë deri fund të 260 mijë “, si dhe nga deklarata e dt. ... e D.H., e dhënë të av. E. G., rreth marrëveshjes për kredi e dt.. në vlerë prej 250 mijë € (në dy pjesë, pjesa e parë vlera = 100,000.00 € dhe pjesa e dytë 150,000.00 € B. K. T.e, Ekstrakti nga B.K.T - Transaksioni i datës .. nga llogaria bankare e DPH “U,” është transferuar shuma prej 248,750.00 € në llogarinë bankare me nr. të D.H me përshkrimin “Bartja e mjeteve sipas deklaratës për shitblerje të datës .., Marrëveshje e shkruar me dorë , me dt. ..., “ në mes D.H. dhe H.P – sot pasi morrem kreditin në Bankën BKT, 248 mijë € dhe i morrem paret , i murr D.H, pas tërheqjes D.mi dha paret e pagesave qe kemi bo pagesat kesh fatura dhe paret i pranova krejt në rregull dhe jemi barazu me borxh, krejt jemi rregull me pagesë...”. Nga të gjitha këto veprime vërtetohet fakti se i akuzuari ka bërë pastrimin e parasë që rrjedhin nga veprimtaria e kundërligjshme ashtu që i njëjti ka marrë kredi nga Bankat Afariste dhe nga Institucionet jo bankare, dhe duke pasur për synim integritet e kësaj pasurije të njëjtën e ka integruar në sisteme të ligjshme financiare, vetëm me qëllim të shpërlarjes së parave pasi që njëkohësisht ka bërë deponimin e mjeteve të gatshme me arsyetimin se paguan këstet të kredive lidhur me vlerat e paluajtshmerive, ndërsa në të vertetë i akuzuari pronaret paraprak i ka paguar në fomë KESH paraprakisht me rastin e blerjes së paluajtshmerve, dhe me pas i është drejtuar insticionve bankare me kerkes për marrjen e kredive të cilat i janë mundësuar, duke bërë në këtë mënyrë qarkullimin e pasurisë të fituar nga aktivitetit i tij kriminal.

Gjykata vlerëson se edhe pse ka prova të pakontestueshme si i akuzuari ka pushtetin faktik mbi sendet e paluajtshme dhe sendet e luajtshme dhe se i njëjti nuk ka ndërmarr veprime qe ti kaloj këto pasuri në pushtetin e tij juridik, por të njëjtat pasuri i ka shfrytëzuar vetëm **me autorizime** me qëllim që pasuria të cilën e ka në posedim ta mbajë si të fshehur dhe të pamundësoj konfiskimin e saj. Gjykata thekson se bëhet fjalë për pasurit e sipërpërmendura të luajtshme dhe të paluajtshme dhe atë: *Vetura e tipit ‘M.’, ngjyrë hiri me targa .., me numër të shasisë W.., viti i prodhimit 2019, i regjistruar në emër të Auto S. P.. Vetura e tipit ‘S’, me ngjyrë të zezë me targa .. me numër të shasisë .., viti i prodhimit 2014, e regjistruara në emër të U P. Vetura e tipit ‘V. G.’, ngjyrë e zezë me targa .., me numër të shasisë ..., viti i prodhimit 2015 e regjistruar në emër të M. M.. Vetura e tipit ‘A., ngjyrë e bardhë me targa .., me numër të shasisë.., viti i prodhimit 2018, në pronësi të H.P. Vetura e tipit ‘L. R. ’, me targa .., ngjyrë të kaltër, me numër të shasisë, .., viti i prodhimit 2018 e regjistruar në emër të Fitim P. Vetura e tipit ‘R. M.’, ngjyrë të bardhë me targa .. me numër të shasisë ..., viti i prodhimit 2018 e regjistruar në emër të U P. Vetura e tipit ‘VW T.’, ngjyrë e kaltër me targa .., me numër të shasisë ..3, viti i prodhimit 2016 e regjistruar në emër të H.P. Vetura e tipit ‘V.G.’, ngjyrë e zezë metalike me targa .., me numër shasisë .. viti i prodhimit 2009, i regjistruar në emër të H.P, si dhe Ngastra kadastrale me numër .. me sipërfaqe të përgjithshme prej 530 m², në zonën kadastrale L. K. P, në të cilën janë ndërtuar objekte afariste me sipërfaqe prej 1072 m², të regjistruara në emër të H.P. Ngastra Kadastrale e evidentuar me numër të njësisë kadastrale . në sipërfaqe prej 263 m² ZK P përkatësisht 153 m² oborr dhe 104 m² shtëpi. Ngastrën kadastrale me nr.. me sipërfaqe të përgjithshme prej 95 m², në zonën kadastrale P. e regjistruar në emër të H.P. Ngastrën kadastrale me nr.. me sipërfaqe të përgjithshme prej 3256 m², e cila gjendet në zonën kadastrale P e regjistruar në emër të A. (B.) Sh.r. Dy lokale në ngastrën kadastrale .. në sipërfaqe prej 174 m², dhe 92 m², zona kadastrale në P në lagjen A. rruga T. tek ‘L. -BP’ të regjistruar në emër të H.P. Sa i përket pretendimeve të cilat nuk janë kontestuar nga mbrojtësit e të akuzuarit dhe as nga vetë i akuzuari apo edhe nga personat e tretë qe do të duhej të kishin interes juridik mbi sendet e lujsatshme dhe të paluajtshme, të njëjtët me asnjë prashtrësë nuk i janë drejtuar gjykatës lidhur me pretendimet e tyre mbi pasurit e lartëcekura. Përkatësisht lidhur me pasurit e luajtshme dhe atë autoveturat të cilat i akuzuari i ka mbajtur në posedim faktik përmes autorizimit për përdorim të leshuar nga autosallonet përkatëse, në kohe*

kur të njëjtit i janë sekuestruar këto atovetura në cilësi të pasuri së tij, autosollonet si palë e i interesuar që duhet të ishin, nuk kanë ndërmarr asnjë veprim juridik për të keruar moscenimin e drejtave pronësore për këto paluajtshmeri, duke bërë kështu që gjykata të krijoj bindjen dhe të kuptoj se një veprim i tillë nga ana e të akuzuarit, pra mos kalimi i pronësisë në emër të tij të këtyre automjeteve por mbajtja vetëm përmes autorizimit, është bërë me qëllim të fshehjes së gjendjes reale të pasurisë aktuale.

Faktin se i akuzuari H.P ka kryer veprën penale të lartëcekur gjykata e vërtetoi edhe nga provat personale si dëshmia e dëshmitarit **Rr.E** të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë .. i cili deklaroi se *“ka punuar te H.P punëtor i thjeshtë ka mbajtur rendin, ka regjistruar pacientet, dhe gjatë atyre ditëve kanë qenë diku 15-20 paciente, deri në 50 pacientë, nuk ka pasur kontakt me te holla përveç kur ka pasur ndonjë pagesë të kredive apo obligim, B ia ka dhënë të hollat kesh me shku me bërë pagesë e të cilat shuma kanë qenë 1.000 ose 2.000 euro, po ashtu përveç tij kanë shkuar edhe punëtore tjerë të bëjnë pagesa, si dhe ka deponuar mjete në bankë me qëllim të pagesës së një shtëpie. Po ashtu këtë fakt gjykata e vërtetoi edhe nga dëshmia e dëshmitarit **E.B** të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë .. i cili ka theksuar se *“ka shkuar në bankë me ia paguar këstin e kredisë, përafërsisht 4-5-6 herë, mund me qenë dhe 10 herë që ka shkaur me deponuar pare në bankë në shumë 4.500-5.000 euro. Në bankë ka hy aty e ka bo pagesën dhe fletëpagesën ja ka kthye B. për pagesat ia ka dhënë letërnjoftimin dhe një letër banks që e paguan çdo muaj. Po ashtu këtë fakt gjykata e vërtetoi edhe nga dëshmia e dëshmitarit **R.T** të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë .. i cili ka deklaruar se, *“të H ka punuar në restorant prej vitit 2017 kamarjer, shankist me kontratë në afat prej 3 muaj, ndërsa mandej ka punuar veç Martë-Premte kur ka pas nevojë, për palët që vishin për me u shëruar tek B, për ta mbajtur rendin në ordinancë te B dhe kur kanë ardhur klient i ka drejtuar te B. Po ashtu ka shtuar se B kur ka pas naj pagës me kry në bankë, naj kredi apo naj senë, kur i kemi vy na ka thirre i njëjti deklaroi se H më ka dërguar në bankë që të bëjë pagës për kresin në emër të bt, dhe qdoher kam shkuar me letërnjoftim të Bt, dhe kam deponuar shuma prej 2.000 -3.000 euro, dhe kjo ka ndodh 3-4-5 ndoshta edhe me tepër herë. Po ashtu këtë fakt gjykata e vërtetoi edhe nga dëshmia e dëshmitarit **Sh.Ltë dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës .. ka deklaruar se,** *“ishim duke punuar me J.M të H, i cili iu ka thanë se me marr një kredi me arsyen se nëse banka më pyet se për çka po të duhet kjo kredi me i thanë që kam me i paguar mjeshtërit. Kanë shkuar tek noteri me bërë kontratën, dhe prej noteri në bankë me i nxjerr kartelat, dhe me rastin e bastisjes së Ht, kanë gjetur letrën e noterit që firma jo e deklaruar dhe paret jo të deklaruar dhe kamatat tjera kanë hyp. Gjoha nga ATK ka qenë 3.180 euro, për mua, kurse B mi ka dhënë 2.500 euro, me shlye këtë borxh ia kam lyp ato tjerat mirëpo tha që nuk kam, u detyrova me i pagua dhe me i lyp neper miqësi dhe gjobën tjetër 680 euro. Marrëveshja ka qenë fiktive për arsyeje të bankës, që me nxjerr një kredi prej bankës B, qëllimi nuk u kanë për me u ndërtuar diçka vetëm për me i marr paret, me qëllimi vetëm të i nxjerri këto pare prej banke.Pra qëllimi i kësaj marrëveshje ka qenë vetëm me i marr paret kredi. Para se të nënshkruajmë marrëveshjen nuk i kanë shikuar shtëpitë, vetë ai dhe Jetoni me rroba pune janë shkuar te noteri dhe kanë nënshkruar kontratën. Në deklaratën e dhënë në polici i njëjti kishte theksuar *“... jam mashtruar nuk e kam dit çka po nënshkruaj,..”*, ndërsa në seancën ka deklaruar se gjithçka ka qenë fiktive, pasi që kur është nisur rrugës i ka thënë kqyr mos po del naj problem, H tha për kredi diçka me marr, keni me ardhur me nënshkruar diçka te noteri nuk keni me pas problem. Po ashtu këtë fakt gjykata e vërtetoi edhe me dëshminë e të dëshmitarit **M.Ç** të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë .. i cili ka theksuar se *“një herë Ht i ka dhënë të holla në huazim e të cilat holla i ka pasur për ndërtim të shtëpisë i cili ia ka kërkuar për një kohë të shkurt në shumë prej 9 mijë euro, si dhe për këto pare i ka ndihmuar motra e tij prej Z.... Huazimin të cilin ja ka dhënë B. në vlerë prej 9 mijë euro, ia ka dhënë kesh në dorë e kjo ka ndodhur vetëm një herë. Në bankë ka shkuar me E. sepse këstet mujore të cilat i ka pas për kredi H i ka paguar në shumë prej 9.000 euro, i cili ka qenë pagesë e këstit mujor dhe ketë e ka bërë disa herë, pra ka bërë deponime edhe për këste për shtëpinë e blerë. Në pyetje të PSRK-së, atë ditë me 22.07.2015, që keni deponuar në bank të holla, Rr.E9 mijë euro, I.I Rr. 9 mijë, ti 9 mijë, E.B5 mijë e 500, I.Rr. 9 mijë, I.Rr. prap 1 mijë të gjitha këto deponime të njëjtën ditë, a të kujtohet kjo? I njëjti është përgjigjur se me ta nuk ka qenë atë ditë, por ka mundur të jenë edhe ata që kanë bërë deponime arsyet e deponimit për shtëpi sepse aty janë blerë shumë shtëpi, ato pare kanë qenë të H së të cilat janë marr nga qërajat. Në pyetje të PSRK-së, ti ke deponuar shumë pare, gati çdo muaj ke bërë deponime, p.sh. me dt.04.08.2016, ke pas 2*****

deponime në BK, një deponim 2.285 euro, e pastaj prapë të njëjtën ditë 3.430 euro, për çka janë bërë këto pagesa? I njëjti është përgjigjur se menjëherë është bërë ajo pagesë por ka qenë e ndarë në këste, e të cilat sipas kësteve i ka paguar për kredi. Shumat e dërguara në bankë ndonjëherë janë kanë 6 mijë, 7-8 mijë, të cilat janë paguar përnjëherë për kredi, pagesa H ia ka dhënë faturat dhe mjetet. Në bankë kanë shkuar se bashku me kolegë arsyeja pse kanë shkuar sepse i kanë pas nga 3 fatura, dhe që të kryen më shpejtë një e kam marr vetë ai, një faturë tjetri. Parët B i ka marr prej restorantit që ka pas dhe ka pas lokale me qera, dhe prej një lokali që e ka pas me kamera me vëllain e tij. Po ashtu këtë fakt gjykata e vërtetoi edhe nga dëshmia e dëshmitarit **D.H** të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë .. i cili ka deklaruar se, “ka pasur marrëveshje për shitblerje të palujtshmerive me H.P n të cilit ia ka shitë një lokal 260 m², i cili lokal është noterizuar dhe dëshmohet përmes kontratës. **Fillimisht H ia ka paguar 100 mijë euro**, dhe i kam marr 100 m², më pastaj edhe 250 mijë euro tjera, për 160 m². Sipas marrëveshjes se metri katror i lokalit ka qenë 2.600 euro, kjo ka qenë para kontratë me arsye që i njëjti të merr kredi në bankë, **kjo vlen vetëm për bankë**. Nga Tetori i vitit 2012, ka marr shumat prej 10 mijë e 500 euro, se të gjitha pagesat që i ka marr në muaj, e ka pritë deri e ka marr kreditin e fundit në shumën prej 250 euro, dhe janë ardhë në konton time, dhe këto mjete kanë dalë për blerjen lokaleve, pastaj kur **i kam marr mjetet ia kam kthyer të gjitha**, edhe e kemi bërë barazimin prej 350 euro, që i kanë kushtuar 260 m². Ndërsa është bërë transferimi nga ndërmarrja U, në xhirollogarin time në shumë prej 248.750 mijë euro, po ashtu kur është bërë transferimi, e ka nënshkruar një marrëveshje, që në momentin kur të kanë dal mjetet në llogari, **i ka nxjerr mjetet dhe me kesh ja ka dhënë me u barazuar gjendja me Hn**. Lidhur me deklaratën e dhënë të av. E.G.e ka dhënë se ka dashur me marr kredi H **ketë deklaratë e ka dhënë vetëm për bankë**, që me marr kredi më lehtë, banka me ja vlerësuar këtë shumë dhe me shti në hipotek. Vlera qe ka marrë nga B muaj për muaj ka qenë shuma prej 10 mijë e 500 euro. Po ashtu këtë fakt gjykata e vërtetoi edhe me dëshminë e të dëshmitarit **F.Sh** të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë . i cili ka theksuar se “familja e tij i ka shitur pronë H.P e cila pronë është e ngjitur me shtëpinë e H. Aty ka qenë oborri dhe një objekt, fillimisht e kanë shitë vetëm oborrin, pastaj ia kanë shitë edhe objektin, kanë qenë 5-6 ari oborr, herën e parë ia ka marr një kerr në vlerë prej 10 mijë euro, dhe 70 mijë euro pare, pastaj e ka marr edhe një kerr të tipit BMW në vlerë prej 25 mijë euro, edhe 140 mijë euro për objektin. Shuma e parave në vlerë prej 140 mijë, është paguar në 5-6 rata, parat i kemi marr me rata kesh, jo përmes bankës, kjo është vetëm për familjen time, vetë ai nuk ka mundur me qenë shitës sepse baba i tij ka qenë gjallë dhe toka ka qenë në emër të tij ndërsa vetë ka qenë në rolin e ndërmjetësuesit. Në atë vend janë objekt 2-3 katesh, punon një mobileri, objektin e ka ndërtuar H. Ndërsa i njëjti ka dijani se për pjesën e tokës që e ka shitë A. Sh., H, pak më larg është një parcelë mbrapa, e cila ka kushtuar 120 mijë euro, Aqifi ka qenë i gjallë po ashtu edhe bashkëshortja e tij N. Sh.. Prezent ka qenë kur është bërë marrëveshja me E. i cili ia ka shitë token H se përveç tokës ka qenë edhe një servisë në objekt të vjetër, ndërsa pazar ka qenë një kerr audi Q7 në vlerë 50-60 mijë euro, dhe para 150 mijë euro, kurse nuk e din a është realizuar kjo shitblerje. Nga deponimi i dëshmisë së këtyre dëshmitarëve gjykata vërtetoi faktin se mjete financiare të fituara në mënyrë të kundërligjshme i akuzuari H.P ka investuar në blerje të aseteve të ndryshme të përshkruara në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me dijani është bërë konvertimi i këtyre mjeteve financiare të fituara në mënyrë të kundërligjshme në blerjen e aseteve me qëllim të maskimit apo krijimit të imazhit se janë fituar në mënyrë të ligjshme, e që një veprim i këtillë përkon me pastrimin e parasë. Pra të gjitha këto deponimet të bëra në shuma të ndryshme dhe atë duke filluar 2.285 euro, 3.430 euro, 6 mijë, 7 mijë euro, 8 mijë euro, të cilat janë paguar për kredi në llogari bankare personale të H.P të gjitha këto tregojnë se këto mjete financiare janë mjete të fituara në mënyrë të kundërligjshme të cilat mjete ishin fituar me anë të ushtrimit të veprimtarisë së kundërligjshme, pra me këtë aktivitet të kundërligjshëm ka krijura të hyra të jashtëligjshme. Këto mjete më pastaj janë konvertuar nga i akuzuari H.P, në asete të lujatshme dhe të palujatshme me qëllim e vetëm të pastrimit të identitetit kriminal nga pasuria e kundërligjshme në pasuri kinse të fituar ligjshëm.

Gjykata të gjitha provat e administruar në shqyrtim gjyqësor i ka vlerësuar si prova të pranueshme andaj i ka administruar si të tilla, të cilave kjo gjykatë u kushtoj besim të plotë, prandaj gjykata gjen se aktakuza ka prova qe në mënyrë të padyshimt vërtetojnë se i akuzuari ka kryer vepër penale si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor sa i përket kësaj pike të aktakuzës, ka konstatuar se mbrojtja e dhënë është në drejtim të shmangies nga përgjegjësia penale, kjo pasi që është në kundërshtim të plotë me provat materiale dhe personale të cilat i ka bashkangjitur prokuroria në aktakuzë e të cilat gjykata i dha besim të plotë, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit dhe të akuzuarit se kinëse “*nuk është vërtetuar, në mënyrë thelbësore se nga cila “veprimtari e kundërligjshme apo vepër penale” janë rrjedhe dhe përfitim i veprës penale, shuma prej 1,000,000.00 euro, e cila është e deponuar nga H.P, përkundrazi pasurin e pershkruar ne atakuze e ka fituar me punën e tij te ligjshme, përmes vjeljes se frutave te pasurisë se tij si qirat, aktivitete e tjera shërbyese, si shitjen e mishit, picerit, restorantet dhe shitjen e kamerave dhe pjesëve te kamerave. Pra organi i akuzës nuk ka vërtetuar fazat e kryerjes se veprës penale shpëlarje te parave atë te **depozitimit, transferimi dhe integrimi me parat e pastra** (elemente te tjera përveç përfitimit nga vepra penale), ne rastin konkret qartazi vërehet se edhe sipas përshkrimit te veprës penale nuk përfshinë këto elemente pa te cilat nuk ka vepër penale te shpëlarjes se parave, te përcaktuar nga neni 32 i Ligjit për shpëlarjen e parave. Paragrafi 2.6 i nenit 32 te Ligjit për parandalimin e shpëlarjes se ka përcaktuar se kushdo qe fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, ne rastin konkret, deponimi i parave nuk paraqet veprim qe fsheh natyrën e vërtet, për tu konsideruar qe janë kryer elementet e tërësishme te kësaj vepre penale, duhet te vërtetohet se këto para pas deponimit janë transferuar ne një llogari tjetër bankare si rezultat i një pune juridike fiktive dhe pasuria e blere paraqet shtresimin e pasurisë e cila vërtete e fsheh origjinën fillestare te parave te deponuara, për me tepër ne rastin konkret nuk është vërtetuar se këto para/ pasuri jenë rezultat i përfitimit te një vepër penale tjetër, ne menyre te veçante supozimi i prokurorisë se këto para ne lartësi prej 1,000.000.00 € është rezultat i veprës penale Mashtrimi dhe Ushtrim i Kunderligjshem i Veprimtarise Mjekesore, ky pretendim është paragjykues, i pa bazuar. Edhe nëse gjykata e vlerëson se i mbrojturi im ka kryer veprëne penale Mshtrimi dhe Ushtrim i Kunderligjshem i Veprimtarise Mjekesore, ne rastet e paraqitura para gjykatës, madje, nëse llogaritet rastet qe jane parashkruar, vlera e supozuar e perfimit nuk arrin shumen prej 10,640.00 €, p.sh sipas deshmise se paleve te dëmtuar te dhena me seancen e dates, te njëjtit kane deklaruar se kane paguar keto shuma, M.B20 €, F. S. 1500.00€, B.K,2550.00 €, R.L1,000.00 €, Z.M 2020.00€, D.Z1,000.00 €. Ne rastin konkret, Prokuroria nuk ka vërtetuar se ekziston dyshimi i bazuar mirë se i mbrojturi P ka kryer veprën penale pastrim i parave, nuk ka vërtetuar te gjitha elementet e veprës penale te pastrimit te parave, siç janë : vërtetimi i faktit se parat janë rezultat i një vepre penale ne mënyre te artikuluar, me sakt e gjithë shuma prej 1,000.000.00 €, se ka ndodhur transferimi dhe shtresimi i pasurisë, gjegjësisht, fshehja e **origjinës se vërtet te parave**. Po ashtu organi i akuzës konsiston ne faktin se kinse i mbrojturi im ka përmes pagese se kësteve te kredisë dhe deponimit te parave nga punonjësit e H Peqnait është fshehur natyre e vërtet e parave, kjo pjese e vërtetimit është tërësish, e pa vërtetuar, e pa bazuar dhe bazohet ne supozimet dhe paragjykime, ne menyre te vecant nëse analizohen provat materaile, p.sh dëshmitari Mrsad Qollaku ka deklaruar pran gjykatës me date .., ne faqen 6 rreshti i fundit i cili ka deklaruar se ka qenë kjo, por në atë kohë ka qenë i kërcënuar, “i referohet H.P” dhe nuk ka pas arsye tjera për mos me shku me bo pagesë, kjo pjese e deshmise vertetohet ne baze te **Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në P me nr.P.nr.2005/16 të dt..., ne baze te ketyre provave vertetohet fakti se nga viti 2013-2017 H.P ka bere pagesa permes punetoreve te vete, per shkak te angazhimeve te tjera te tij, per shkak se ka qen pale e dëmtuar nga viti 2013 deri ne vitin 2018 si dhe pagesa nga punetoret e tij jane bere per pagesen e kesit te kredis, Se keto deponime jane bere per pagesen e kesit te kredis vertetohet edhe ne baze te deshmitarit Rr.E ne deshmime e tij te dhene me date .. pran gjykatës I njejt ka deklaruar, citoj “... po per kest te kredise....”, ndersa, ne pyetjen se pse pagesat nuk i ka bere H.P, I njejt ka deklaruar, citoj ”.... Ndonjehere nuk ka pas khe, çdo here ka pas aryeje.....’.Ndërsa sipas sqarimeve te bëra nga dëshmia e dëshmuarit D.H. gjykatës me date ., i njëjt, ka deklaruar se, citoj “... a është e vërtete me date . është bere transferimi nga ndërmarrja U, ne llogarinë tuaj ne larësi prej 248,750.00 euro, i njëjt ka deklaruar, me qellim qe te behet regjistrimi i pronës, sepse, pa kalim te mjeteve ne llogari nuk ka qene e mundur te behet regjistrimi i pasurisë se blere....”. E si përfundim ka theksuar se duke marr parasysh te lartcekurat dhe provat qe i ka dorëzuar mbrojtja sa i përket biznesve te tjera qe H.P ka zhvilluar ne jetën e tij, vërtetohet fakti se parat per blerjen e pasurisë jane fituar ne menyre te ligjshme, përmes qirave, me biznese te ndryshme, ne anën tjeter pretendimi i prokurorisë se këto para jane fituar përmes mashtrimit jane tërësish te pa bazuar. I njejt i ka propozuar gjykates sa i përket pikës IV te aktakuzës te nxjerr Aktgjykim Lirues. Tutje ka theksuar, se propkurori ka propozuar **Konfiskimin e Perhershem te Sendeve te pershkruar si në*****

dispozitivi te Aktakuzes, Pasuria sipas aktakuzës paraqet cenim te rende te sigurise juridik edhe eshte i pa drejt... dhe të njëjtat pretendime i mbështet në provat e propozuara nga mbrojtësit dhe të administruara në shqyrtimin gjyqësor’’ i hodhi poshtë si të pa besueshme, për faktin se i akuzuari H.P, në rastin konkret ka qenë i vetëdijshëm se pasuria buron nga aktiviteti kriminal dhe më qëllim të fshahjes së origjinës këto mjete të kundërligjshme ka financuar blerjet e aseteve të cilat janë konfiskuar. Të gjitha këto pasuri, janë të blera gjatë kohës për të cilën është vërtetuar se i akuzuari H.P ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, për këtë kohë ai nuk ka mundur me asnjë dëshmi ta vërtetoj se ka pasur të hyra të cilat do ta mbulonin blerjen e këtyre pasurive, ndërsa në anën tjetër është vërtetuar se me këtë veprimtari kriminale ai ka fituar një shumë konsiderueshëm të madhe parash.

Gjykata nga provat materiale dhe personale të administruara dhe elaboruara në shqyrtim gjyqësor vërtetoi faktin se ngsatrsan kadastrale me nr., me sipërfaqe të përgjithshme prej 3256 m2 në vendin e quajtur A. ZK P e regjistruar në emër të tij me pronësi prej 5/8, ndërsa në emër të B. (B.) Sh. me pjesë të pronësisë prej 3/8, pra ngastra kadastrale e lartëpermenur është objekt i aktakuzës. Ketë fakt gjykata e vertoi me administrimin e provës materiale si është kontrata për shitëblerejn e paluajtshmërisë në mes të H.P në cilësi të blerësit dhe E. Sh.në cilësi të shitësit e cila kontratë mbanë datën .. dhe ka fakt veteohet se kjo pasuri është blerë jashtë periudhës kohore për të cilën pretendon prokuroria në aktakuzë. Andaj mbi këtë bazë gjykata gjykta vendosi si në dipozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke i analizuar provat personale dhe materiale të propozuara nga ana Prokurorisë Speciale e të cilat i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor i ka vlerësuar si prova të pranueshme andaj i ka administruar si të tilla, të cilëve kjo gjykatë u kushtoi besim të plotë, e të cilat qojnë gjykatën në konkludim se besueshmëria në to dhe shkalla e arsyeshërisë me rrethanat e konkrete të rastit, në mënyrë të padyshimtë vërtetojnë që i akuzuari ke kryer veprën penale si në pikën IV të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke i analizuar provat materiale të propozuara nga ana mbrojtësve e të cilat i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor i ka vlerësuar si prova të pranueshme andaj i ka administruar si të tilla, të cilëve kjo gjykatë nuk ju fali besimin pasi që të njëjtat ishin në kundërshtim të plotë me provat personale dhe materiale të propozuara nga Prokuroria Speciale.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata i pati parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprat penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor, pastaj pati parasysh edhe qëllimin e dënimit dhe të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga neni 74 të KPRK-së, që ndikojnë në ashpërsimin ose zbutjen e dënimit

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për ashpërsimin e dënimit për të akuzuarin ka gjetur, **Shkallen e përgjegjësisë penale** pasi që gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë vepër penale, i aftë për t’i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, **Motivin për kryerjen e veprave penale** i njëjti me dashje dhe me vetëdije ka vepruar me qëllimin të caktuar për përfitim të vlerave të ndryshme monetare të cilat i njëjti j’ua ka kërkuar në mënyrë të drejtë për drejtë të dëmtuarve, **Intensiteti i rrezikimit apo i dëmtimit të së mirës së mbrojtur** gjykata ka marrë parasysh se i njëjti me veprimtarin e tije dhe me metodat të cilat i ka përdorur ka rrezikuar shëndetin dhe jetën e shum personave si dhe ka krijuar problem familjare, **rrethanat në të cilat është kryer vepra penale**, i njejti një kohë të gjatë ka ushtruar veprimtari të kunderligjshme, duke e paraqitur veten se ka aftësi të jashtëzakonëshme dhe duke e shfrytëzuar gjendjen psikike dhe emocionale të të dëmtuarëve i ka vënë në lajthim dhe nxitur që të paguajnë shuma të ndryshme të parave, **shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale**, pasi që i njëjti me veprimet e tij thellësisht i ka kontribuar kryerjes së kësaj veprë penale dhe se veprat penale i ka konsideruar si të vet.

Gjykata duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, për të akuzuarin ka gjetur; Sjelljet e mira dhe korrekte te këtij te akuzuari, ne raport me gjykatën dhe palët tjera, mosha e të akuzuarit pasi që njëjti është moshës relativisht të shtyrë.

Andaj, gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të akuzuarit i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tijë, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi konfiskimin e armëve dhe atë një pistolet të tipit "G." të kalibrit 9mm me numër serik ., me dy karikator si dhe 166 fishek të të njëjtit kalibër, si dhe një pushkë gjuetie të tipit "S. C." me numër serik 111238 dhe 55 fishek, gjykata e mori konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par 1 dhe 2 nën par 2.1 dhe 2.6 si dhe nenit 454, të KPPK.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 363, 364, 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
- Departamenti Special-
PS.nr.36/2020, me datën 10.01.2023

Kryetari i trupit gjykues
Lutfi SHALA

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.

Numri i lëndës: 2020:049797
Datë: 06.04.2023
Numri i dokumentit: 04168745